



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
BASHKINË KUÇOVË

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I RI-AUDITIMIT
MBI
(Auditimin Financiar dhe Përputhshmërisë)

“BASHKIA KUÇOVË”

Tiranë, Shtator 2021

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6-10
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	6
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	7
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	10
II.	HYRJA	13-18
1.	Objekti i auditimit	13
2.	Qëllimi i auditimit	13
3.	Identifikimi i çështes	13
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	14
5.	Përgjegjësitë e audituesve	14
6.	Kriteret e vlerësimit	15
7.	Standardet e auditimit	16
8.	Metodat e auditimit	16
9.	Dokumentimi i auditimit	18
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	19-114
1.	Informacion i përgjithshëm	19
2.	Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	20
3.	Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrolli i brendshëm	20-23
	- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, Infimimi dhe komonikimi si dhe monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon. - Organizimi dhe funksionimi i Njesisë së Auditit të Brendshëm Publik. - Planifikimi dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve, realizimi i programit vjetor të auditimit nga ana sasiore dhe analiza sipas llojeve dhe gjetjeve si dhe kapacitetet audituesve të sektorit të auditimit. - Ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga Njësia e Auditit të Brendshëm Publik të Bashkisë.	
4.	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 nëPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016, ligjin nr. 130/2016, datë 17.12.2016 nëPër buxhetin e shtetit të vitit 2017ò, dhe ligjin nr. 109/2017, datë 30.11.2017 nëPër buxhetin e shtetit të vitit 2018ò, me ndryshimet.	23-36
	- Programimi i PBA dhe i buxhetit vjetor 2018-2021 dhe programimi i buxhetit vjetor 2018-2020. - Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura; - Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. -Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli i realizimit të të ardhurave; (Faturat e palikuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi et, sipas raportimit në MF). -Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR etj, saktësia e	

	raportimit buxhetor të tyre. - Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.	
5.	Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2018 dhe 2019, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, të bashkisë.	36-45
	- Verësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës inanciare dhe fluksit të parasë të Bashkisë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht në, udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006 ñPër përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj; udhëzimin e MF nr. 26, datë 27.12.2007, për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006, dhe udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 ñPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme, et.. - Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjes ekonomike. - Vlerësimi i arsyeshëm e i bazuar (në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme); -Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të nën njësisë.	
6.	Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 ñPër Prokurimin Publikò i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjensisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 24.04.2017 ñPër procedurën e prokurimit me vlerë të vogëlò.....	45-100
	- Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve ... -Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara. - Auditimi mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit). - Auditim për zbatimin e punimeve, deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimi i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve; - Opinion mbi prokurimin e fondeve në nivel institucional shoqëror me një tabelë në procedurat e prokurimit publik, objekti i prokuruar, lloji i procedurës, fondi limit, data dhe vlera e kontratës, shtesat e kontratës, diferenca nga fondi limit, operatori ekonomik fitues dhe cila procedurë prokurimi është audituar nga grupi/audituesi i KLSH në vlerë dhe në përqindje (Në Projektraport dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit, prokurimet të paraqiten në formë tabelore, sipas pasqyrës tip);	
7.	Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme .	100-114

	- Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve - Realizimi programit (Plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.... - Statusi i rekomandimeve të lëna në Auditimin e mëparshëm ...	
8.	Të ndryshme	114
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	115-128
V.	Lista e dokumenteve.....	129
VI.	Anekse	131-161

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave të Ndërtimeve Informale.
ASHK IT	Agjencia Shtetërore e Kadastrës Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.
AK	Autoriteti Kontraktor.
SHA	Shoqëri Anonimë.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.
KShaA	Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtësri i Projektit të Ri-Auditimit.

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 nëPër Organizimin dhe Funksionimin e KLSHò, në zbatim të Projektit dhe Programit të Ri-Auditimit nr. 98/1, datë 19.01.2021, ndryshuar me nr. 98/2 prot, datë 02.03.2021; ndryshuar me nr. 98/3 prot, datë 25.03.2021 të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi nga data 08.02.2021 deri në datën 16.04.2021, për periudhën nga 01.01.2018 deri më 31.12.2020 në subjektin: Bashkia Kuçovë, u krye auditimi nëMbi Ri-Auditimin Financiar dhe Përputhshmërië nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. Skënder **Muçaj**, *Përgjegjës Grupi*
2. Miranda **Berdo**, *Auditues*
3. Shkëlzen **Hoxha**, *Auditues*
4. Enea **Caushaj**, *Auditues*

Auditimi u krye me zgjedhje, mbi bazën e riskut dhe materialitetit.

Fushat mbi të cilat është shtrirë auditimi, sipas programit të auditimit, janë pasqyrat financiare, për të cilat u auditua rregjistrimi i të dhënave dhe mbajtjen e kontabilitetit, saktësia e pasqyrave financiare, aplikimin e parimeve kontabël si dhe nëse transaksionet janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe parimet për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të institucionit, ngritja dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, vlerësimin e njësisë së auditit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, planifikimi për të ardhurat dhe masat e marra për arkëtimin e tyre, zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik dhe zbatimin e kontratave për punë publike, shërbime dhe mallra, zbatimi i rekomandimeve të lëna në Auditimin e mëparshëm.

Për këto u analizuan evidencat e marra nga subjekti i audituar, si dhe u përdorën testet e nevojshme si pjesë e procedurës së auditimit.

Për pasqyrat financiare, auditimi u krye për pasqyrat e vitit 2018/2019/2020.

Për gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit janë mbajtur 16 akte konstatimi dhe 5 akt verifikime, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit Bashkia Kuçovë, brenda afatit të periudhës së auditimit.

Nga grupi i auditimit janë shqyrtuar observacionet e bëra nga subjekti i audituar, mbi aktet e konstatimit dhe projektraportin dhe janë marrë në konsideratë ato kundërshti të cilat janë të mbështetura nga ana ligjore, apo është paraqitur dokumentacion shtesë, ndërsa për rastet e tjera të cilat nuk gjejnë argumentim, mangësitë gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i dërgohet subjektit për njohje dhe marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes.

Mbështetur në punën audituesve në terren, në evidencat e marra të cilat sipas mendimit tonë kanë qenë të përshtatshme, të mjaftueshme dhe të besueshme për punën audituesve, mbështetur në Projektraportin e auditimit, komentet e subjektit të audituar, qëndrimin e grupit të auditimit ndaj komenteve të subjektit, rezultatet kryesore të punës audituesve përfshihen në këtë përmbledhje ekzekutive të Raportit Përfundimtar të Auditimit si më poshtë.

2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	Në auditimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, janë konstatuar copëzime të fondeve, praktikë kjo në kundërshtim me kuadrin rregullator. Për vitin 2018 janë 11 urdhra prokurimi të së njëjtës natyrë me objekt <i>“Materiale për funksionimin e zyrës”</i> , me vlerë 1,650 mijë lekë, si dhe 15 urdhra prokurimi me objekt <i>“Blerje pjesë këmbimi bateri etj”</i> me vlerë 1,711 mijë lekë. Për vitin 2019 janë 5 urdhra prokurimi të së njëjtës natyrë me objekt <i>“Materiale për funksionimin e zyrës”</i> , me vlerë 1,203 mijë lekë, si dhe 8 urdhra prokurimi me objekt <i>“Blerje pjesë këmbimi bateri etj”</i> me vlerë 1,308 mijë lekë. Për vitin 2020 janë 6 urdhra prokurimi të së njëjtës natyrë me objekt <i>“Materiale për funksionimin e zyrës”</i> , me vlerë 1,125 mijë lekë, si dhe 4 urdhra prokurimi me objekt <i>“Blerje pjesë këmbimi bateri etj”</i> me vlerë 1,144 mijë lekë.			Titullari i AK, të ngrejë grupe pune me specialistë të fushës për hartimin e fondit limit mbi bazën e kërkesave të Drejtorive/Sektorëve, duke bërë grumbullimin e tyre sipas grup mallrave, dhe përcaktimin e saktë të nevojave të institucionit dhe procedurës që do zhvillohet, duke respektuar kufijtë monetarë dhe llojin e procedurës.
2	Nga auditimi ka rezultuar se, nga objektet inventari të pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 819,522,655 lekë, objektet nuk janë pajisur me titull pronësie, konkretisht sipas llogarive paraqiten si më poshtë: -llog. 211 nëPyje plantacione, paraqiten në vlerën 0 lekë, ku në fakt janë 412 njësi të transferuara sipas vkm nr. 433 datë 08.06.2016 nëPër transferimin e në pronësi të pyjeve dhe kullotave. -llog. 212 nëNdërtesa e konstruksione, 54 objekte me kosto historike 307,983,562 lekë. -llog. 213 nëRrugë, rrjete, vepra ujore, 20 objekte në vlerën 517,753,292 lekë. Për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor). Pavarësisht evidentimit të tyre në inventarin e aktiveve, dukumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë.	37-38	I mesëm	Bashkia Kuçovë duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.
3	Nga auditimi i dokumentacionit shoqërues në urdhër shpenzimet në ditarët e bankës, u verifikua se sipas kontratës së lidhur ndërmjet AK dhe nëBò SHPK për investimin me objekt nëRikualifikim urban i lagjes 1 Majò nënshkruar në datën 16.01.2019 me nr. 149, për vlerën 105,619,032 lekë, edhe pse janë bërë punimet dhe është marrë në dorëzim asetit nëpërmjet aktit të marrjes në dorëzim në datën 10.12.2019, ky aset nuk është kontabilizuar. Kjo ka bërë të mundur nënvlerësimin e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” me 105,619,032 lekë .	37-38	I mesëm	Nga Bashkia Kuçovë, Drejtoria e financës dhe Buxhetit, të bëhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë 213 Rrugë, rrjete, vepra ujore për shumën 105,619,032 lekë për vitin 2019, me mbylljen e bilancit kontabël të vitit të ardhshëm, nëse kjo vlerë vazhdon të jetë e pa kapitalizuar edhe gjatë këtij vitit ushtrimor.
4	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratave për punë publike, rezultuan në objekte diferenca në volume pune të zërave të punimeve në krahasim me volumet e situacionuara në vlerën 1,272,428 lekë respektivisht: 1. Vlera 132,297 lekë në objektin nëRikonstruksioni i ish-godinës së riparimit të mjeteve të rënda dhe magazinës së rikuperove pranë parkut të naftës me BOE nëAò SHPK &	86-101	I lartë	Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,272,428 lekë pa TVSH nga sipërmarrësit të punimeve të trajtuara në gjetjen, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera

	ñBò SHPK. 2. Vlera 450,358 lekë në objektin <i>ñNdërtim shtesë kati Biblioteka Kuçovë</i> me OE ñZò SHPK. 3. Vlera 26,940 lekë në objektin <i>ñRikonstruksion i sheshit shkollës 9-vjeçare 18 Tetori</i> me OE ñFò SHPK. 4. Vlera 128,120 lekë në objektin <i>ñRikonstruksion i kopshtit nr. 1</i> me BOE ñDhò SHPK & ñTò SHPK. 5. Vlera 157,669 lekë në objektin <i>ñRikonstruksion i rrugës ñE. B.ò Fshati Rreth Tapi Njësia Administrative Perondi</i>, në <i>Bashkinë Kuçovë</i> me BOE ñFò SHPK & ñSh-07ò SHPK. 6. Vlera 377,044 lekë në objektin <i>ñNdërtim i shkollës 9 vjeçare 18 Tetori</i> me BOE ñEd K.ò SHPK & ñAò SHPK.			sipas volumeve të situacionuara.
5	Nga auditimi i 15 procedurave me vlerë 546,376 mijë lekë pa SHPK, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP, 11 procedura me vlerë kontrate 358,448 lekë ose 72.8 % e fondit të prokuruar, në të cilat ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën 358,448 mijë lekë pa SHPK, respektivisht: 1. Vlera 29,461 mijë lekë në prokurimin me objekt <i>ñRikonstruksion i Rrugës “E. B.”, fshati Rreth Tapi, Njësia Administrative Perondi</i>, me FL 30,688 mijë lekë, me fitues BOE ñFò SHPK & ñSh-07ò SHPK. 2. Vlera 42,664 mijë lekë në prokurimin me objekt <i>ñRikonstruksion i shkollës së mesme 5 Tetori</i>, me FL 43,528 mijë lekë, me fitues BOE ñAò SHPK & ñBò SHPK. 3. Vlera 12,145 mijë lekë në prokurimin me objekt <i>ñRikonstruksion i objekteve të komunitetit Rom dhe Egjiptiane Kuçovë dhe banues në zona rurale</i>, me fond limit 12,319 mijë lekë, me fitues OE ñZò SHPK. 4. Vlera 88,015 mijë lekë në prokurimin me objekt <i>“Rikualifikim i lagjes 1 Maj”</i>, me fond limit 90,747 mijë lekë, me fitues BOE ñAò SHPK & ñBò SHPK. 5. Vlera 7,869 mijë lekë në prokurimin me objekt <i>“Shërbim i dekorit në Bashkinë Kuçovë”</i>, me fond limit 7,870 mijë lekë, me fitues OE ñA. D.ò p.f. 6. Vlera 62,150 mijë lekë në prokurimin me objekt <i>ñNdërtim i shkollës 9 vjeçare 18 Tetori</i>, me fond limit 64,093 mijë lekë, me fitues BOE ñEd K.ò SHPK & ñAò SHPK. 7. Vlera 14,899 mijë lekë në prokurimin me objekt <i>ñDevijim i përroit Gegë për zgjerimin e varrezave publike</i> me fond limit 15,182 mijë lekë, me fitues OE ñFò SHPK. 8. Vlera 36,936 mijë lekë në prokurimin me objekt <i>ñRikonstruksion i rrugës Murat Daulle</i>, me fond limit 37,650 mijë lekë, me fitues BOE ñFò SHPK & ñSh-07ò SHPK & ñColoseoò SHPK. 9. Vlera 64,303 mijë lekë në prokurimin me objekt <i>“Rikualifikim urban i lagjes Llukan Prifti</i>, me fond limit 65,621 mijë lekë, me fitues BOE ñFò SHPK & ñSh-07ò SHPK.	51-92	I lartë	Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën 358,448 mijë lekë pa SHPK. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësive publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.
6	Në auditimin e dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e të Ardhurave, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej debitorë 338 subjekte për vlerën 12,391,597 lekë dhe debitorë për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa shërbimi, 4431 familje për	33-34	I Lartë	Bashkia Kuçovë, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kuçovë të marrë masat e duhura, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, për arkëtimin detyrimeve të pa

	vlerën gjithsej 63,032,000 lekë. Nga Drejtoria e të Ardhurave për subjektet debitorë përveç se janë dërguar bankave urdhër bllokime dhe barrë siguruese në drejtorinë e transporteve dhe hipotekë, në asnjë rast nuk kemi ndjekje të plotë të procedurave të arkëtimit të debitorëve, deri në nxjerrjen e Urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve.			arkëtuara të subjekteve fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pambledhura për vlerën gjithsej 75,423,597 lekë, gjithsej 338 subjekte në vlerën 12,391,597 lekë dhe 4431 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej 63,032,000 lekë konkretisht: - Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë, urdhër bllokime të llogarive bankare të subjekteve; - Të dërgohet Drejtorisë Rajonale të Transportit kërkesa për vendosje barrë siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme); - Në funksion mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhojë strukturat e tij, për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar; Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet e krijuara në vite, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sektori Juridik, të marrë masa administrative, apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të RSH, neni 181 në Mospagimi i taksave dhe tatimeve.
7	Drejtorja e të Ardhurave, Bashkia Kuçovë për periudhën objekt auditimi nuk ka arkëtuar detyrimet e kontratave dhe kamatvonesat nga 155 fermerë në vlerën 13,527,645 lekë, që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë, (detyrim kontrate viti 2017 e para në vlerën 642,188 lekë, viti 2018 në vlerën 960,488 lekë dhe viti 2019 në vlerën 981,906 lekë dhe kamatvonesa në vlerën 10,943,063 lekë).	29-30	I Lartë	Bashkia Kuçovë duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore, sipas të dhënave të Sektorit të Bujqësisë, për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore, në shumën prej 13,527,645 lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Kuçovë.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.

Për periudhën e auditimit 2018-2020, janë konstatuar problematikat si vijon:

- Në **12** raste, kriteret e vendosura nga NJP nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumet e punës.
- Në **9** raste nga auditimi i **23** procedurave të prokuruar, vlerësimi i kryer nga KVO, nuk është në përputhje me rregullat e prokurimit publik, pasi ka kualifikuar operatorët ekonomikë të cilët nuk përmbushin kriteret e vendosura në DST, duke kryer shpenzime në paligjshmëri të fondeve publike në vlerën **358,448 mijë lekë**.
- Në auditimin e dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e të Ardhurave, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej debitorë 338 subjekte për vlerën **12,391,597** lekë dhe debitorë për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa shërbimi, 4431 familje për vlerën gjithsej **63,032 mijë lekë**.
- Në **6** raste nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratave për punë publike, u konstatuan punime të pakryera në volumet e situacionuara dhe të paguara nga Bashkia Kuçovë në shumën **1,272,428 lekë**.
- Drejtoria e të Ardhurave, në Bashkinë Kuçovë nuk ka arkëtuar detyrimet e kontratave dhe kamatvonesat nga 155 fermerë në vlerën **13,527 mijë lekë**, që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë.

OPINIONI I AUDITIMIT

a. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare.

Për drejtimin e Bashkisë Kuçovë.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Kuçovë, për vitin ushtrimor 2018 dhe 2019, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i modifikuar, i kundërt¹:

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të kundërt për llogaritë vjetore të subjektit, Bashkia Kuçovë duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2019.

Baza për opinionin e modifikuar, të kundërt:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Kuçovë, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISA 700).

¹ **Opinion i kundërt.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kundërt: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale të përhapura.

Në planifikim ne kemi llogaritur vlerën e materialitetit, bazuar në ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke marrë parasysh riskun e lartë të auditimit, ndaj të cilit për të marrë një siguri të arsyeshme, audituesi duhet të tolerojë një normë më të ulët të gabimit material. Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 është 1,726,039 lekë. Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2019, u evidentuan gabime materiale të cilat individualisht dhe si shumë, janë mbi nivelin e materialitetit të përcaktuar për vitin financiar të mbyllur në 2019 (materialiteti 1,726,039 lekë), dhe janë gabime materiale të përhapura në llogaritë vjetore të subjektit, fakt ky që përbën bazën e opinionit të kundërt (ISA-705; ISSAI-1705). Për këto arsye kemi dhënë opinion të kundërt, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Përshkrimi i çështjeve:

Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2019 paraqitet në si më poshtë:

- Llogaria 213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreò është pasqyruar më pak për vlerën 105,619,032 lekë;
- Llogaria 214 *Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune*" është pasqyruar më shumën për vlerën 13.639.196 lekë.
- Llogaria 215 Mjete transporti është pasqyruar më pak për vlerën 13.639.196 lekë.
- Llogaria 26 ñPjesëmarrje në kapitalin e vetò është pasqyruar më pak për vlerën 3,500,000 lekë;
- Llogaria 467 ñKreditorë të ndryshëmò është pasqyruar më pak për vlerën 121,911,940 lekë;

b-Nga auditimi mbi përputhshmërinë.

Opinion i kualifikuar për prokurimet publike

Ne kemi audituar planifikimin e nevojave për investime, përputhshmërinë ligjore për zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin në teren të kontratave të punimeve të lidhura midis autoritetit kontraktor dhe operatorëve të shpallur fitues. Në opinionin tonë, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Bashkia Kuçovë të kuadrit rregullator për fushën e prokurimeve publike, referuar kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 ñPër Prokurimin Publikò i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, duke përjashtuar disa anomali materiale, në disa raste të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar për fushën e zhvillimit të procedurave. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë, si më poshtë:

- Nga auditimi i **23** procedurave, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP, **9** procedura, në të cilat ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **358,448 mijë lekë** pa SHPK.
- Në **12** raste, kriteret e vendosura nga NJP nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumet e punës.
- Në auditimin e dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e të Ardhurave, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej debitorë 338 subjekte për vlerën **12,391,597 lekë** dhe debitorë për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa shërbimi, 4431 familje për vlerën gjithsej **63,032 mijë lekë**.
- Në **6** raste, u konstatuan punime të pakryera dhe të paguara në shumën **1,272,428 lekë**.

- Drejtoria e të Ardhurave, në Bashkinë Kuçovë nuk ka arkëtuar detyrimet e kontratave dhe kamatvonesat nga 155 fermerë në vlerën **13,527,645 lekë**, që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin *“Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e Pasqyrave Financiare”* të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga subjekti, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Kuçovë.

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 08, datë 09.03.2018 *“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”*, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe këto çështje i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun, ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

I. HYRJA

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

- Objekti i auditimit synon:

Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

- Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

-Marrja e garancive nëse procedurat e prokurimit publik janë zhvilluar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, mbi përputhshmërinë e zbatimit të kuadrit rregullator në fuqi në mbledhjen e të ardhurave dhe ekzekutimin e buxhetit.

2. Qëllimi i auditimit.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare. Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

Për fushën e prokurimeve qëllimi i auditimit është të kuptohet se deri në çfarë shkalle subjekti zbaton kuadrin rregullator në fuqi, zbulimi i shkallës së devijimeve nga standardet e pranura dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së ligjshmërisë, me qëllim që për rastet individuale të identifikuarat personat përgjegjës të ngarkohen me përgjegjësi, si dhe të merren masa për parandalimin e shkeljeve në të ardhmen.

3. Identifikimi i çështjes.

Projektraporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësitë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Kuçovë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndajë komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Identifikimi i çështjes:

A. Kontrolli i brendshëm

B.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.

B.2. Burimi i krijimit të të ardhurave dhe vlerësimi i mbledhjes së tyre, borxhi tatimor

C. Vlerësimi i Raportimit Financiar (Pasqyrat financiare për vitin 2018-2019-2020).

D.1. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike.

D.2. Hartimi dhe zbatimi i kontratave të punimeve.

E. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Titullarët e njësive publike, përgjigjen për vendosjen dhe përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet, sigurimin, nëpërmjet akteve të brendshme administrative, të zbatimit të rregullave për Kontrollin e Brendshëm.

Kryetari i Bashkisë Kuçovë (*Nëpunësi autorizues*) z. K.H. dhe Drejtori i Financës (*Nëpunësi zbatues*) Znj. J. P., janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi. Sipas përcaktimeve të pikës 6 e neni 34, neni 65- *Administrata e njësive administrative* dhe pika 1 në Njësitet administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori dhe neni 91, të ligjit nr. 139/15, dt. 17.12.15 në Për vetëqeverisjen vendore.

5. Përgjegjësitë e Audituesve.

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin e grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;

c) nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji Organik i Buxhetit apo Ligji i Prokurimit Publik, etj.

b) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;

c) Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, etj.)

e) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320, dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në Bashkinë Kuçovë, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit.

Gjatë kryerjes së auditimit, në mënyrë që të jepet një gjykim sa më profesional, objektiv dhe i pavarur, audituesit e grupit kanë zbatuar parimet e mëposhtme me karakter etik: Parimin e integritetit; Parimin e pavarësisë ; Parimin e objektivitetit dhe parimin e shmangies së konfliktit të interesit.

Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë në lidhje me pasqyrat financiare, procedurat e prokurimit publik.

6. Kriteret e vlerësimit.

Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

-Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 *ëmbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, me ndryshime;

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *ëmbi* organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

-Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 *ëmbi* *Për vetëqeverisjen vendore*.

-Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *ëmbi* *financat e vetëqeverisjes Vendore*”.

-Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *ëmbi* *menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*; i ndryshuar.

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *ëmbi* *menaxhimin financiar dhe kontrollin*, i ndryshuar.

-Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *ëmbi* *prokurimin publik*, i ndryshuar.

-Ligji nr. 10450, datë 24.03.2011 *ëmbi* kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve, me ndryshime;

- Ligji nr. 68/2017 *ëmbi* financat e vetëqeverisjes vendore;

- Ligji nr. 114/2015 *ëmbi* Auditimin e brendshëm në sektorin publik;

-VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *ëmbi* *miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017 Udhëzimi i APP nr. 2, datë 24.04.2017 *ëmbi* *procedurën e prokurimit me vlerë të vogël*”.

- VKM nr. 717, datë 23.06.2009 *ëmbi* pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore i ndryshuar.

VKM nr. 510, datë 10.06.2015 *ëmbi* inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të palujtshme dhe të luajtshme, etj.

- VKM nr. 545, datë 23.06.2009 *ëmbi* pagat e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, Institucionet në varësi të ministrive të linjës dhe Administratën e Prefektit, i ndryshuar;

-UMF nr. 30, datë 27.12.2011, *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*, i ndryshuar.

-Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 *ëmbi* *miratimin e manualit të MFK*.

-Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 *ëmbi* *procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*

- Udhëzimi MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 *ëmbi* përgatitjen e buxhetit vendor, etj.

- UMFnr. 22, datë 30.07.2018 *ëmbi* procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

- rregulloren e Brendshme *ëmbi* organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH-së, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015, e ndryshuar;

- Rregullore *ëmbi* procedurat e auditimit në KLSH, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së e ndryshuar.

- Rregullore e brendshme *ëmbi* organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Kuçovë, etj.

7. Standardet e auditimit të aplikuar në kryerjen e punës.

Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:

- ISSAI 100 *Parimet themelore të auditimit të sektorit publik* që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 1000-2999 *Udhëzues të Auditimit Financiar*;
- ISSAI 1300 *Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*;
- INTOSAI GOV 9100 *Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik* si dhe INTOSAI GOV 9110 *Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshme*;
- ISSAI 400 *Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë* që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 *Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë".
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH me ndryshime;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.

8. Metodat e auditimit.

Teknikat audituese:

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 në mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë të sektorit publik, me ndryshime.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për tōu nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna nëjashtë normales, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

Metodat audituese:

-Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me **ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450**, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për tōu audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet. Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve.

Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

-Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit.

Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH aplikon².

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të **Riskut të Auditimit prej 5 %**, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (**ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.

-Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike si dhe në *kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra si dhe çështje të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura për përgatitjen e Raporti Përfundimtar të Auditimit.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe përgatitjen më pas, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

² Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

Evidencat mbështetëse si dhe dokumentacioni i përgatitur nga Grupi i Auditimit, janë pjesë e Raporti Përfundimtar të Auditimit dhe më pas për Raportin Përfundimtar të Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve të kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Bashkia Kuçovë, është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 nëpër Vetëqeverisjen Vendore dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 nëpër financat e vetëqeverisjes Vendore, Rregullorja mbi Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë Kuçovë, etj. Aktet ligjore dhe nënligjore të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Kuçovë.

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik:

Kuçova ndodhet në pjesën veriore të Shqipërisë së Jugut përgjatë lumenjve Osum dhe Devoll, vetëm 81.8 km nga kryeqyteti i Tiranës. Zona ka një riliev kodrinor-fushor, klimë mesdhetare me verë të nxehtë e të thatë dhe dimër të ftohtë. Me një sipërfaqje prej 160.22 km² dhe një popullsi 55,695 banorë, territori i Kuçovës përfshin katër njesitë Administrative, NJA Kuçovë, Lumas, Perondi dhe Kozare. E pasur me naftë dhe gaz natyror, Kuçova është ende një nga qendrat më produktive në Shqipëri. Pavarësisht prejardhjes së saj industriale, Kuçova aktualisht është e orientuar drejt zhvillimit të industrisë së lehtë, prodhimit dhe agroturizmit. Gjithashtu është e njohur për rezervat e saj të naftës dhe gazit dhe industrinë mbështetëse për nxjerrjen dhe përpunimin e tyre. Njesitë administrative Kozare, Perondi dhe Lumas kanë tokë pjellore bujqësore dhe kultivojnë sasi të mëdha të perimeve, drithërave, frutave, ullinjve, rrushit dhe arrave. Kuçova ka Aeroportin e vetëm Ushtarak në Shqipëri dhe së shpejti do të bëhet Baza e parë e NATO-s në Ballkanin Perëndimor. Ka një territor të pasur me burime natyrore të vendosura midis lumenjve Osum dhe Devoll. Shumë monumente historike dhe ndërtesa gjenden këtu si Kisha Ungjillore e ndërtuar në shekullin XIII dhe Kisha e Shën. Nikolas ndërtuar në shekullin XII. Parku natyror i Sinec ofron burim natyror të ujit dhe ujëvara mes kanioneve gëlqerorë dhe shpellave të shumta si Shpella Karstike e Xhixhile, Shpella e Eremites e vendosur 400-600 m larg kanioneve, Gropave të Nexhip dhe Gurit të Kuq.

Kuçova ka qenë një qytet industrial dhe së fundmi është futur në bujqësi. Ka 31 fshatra, 120 ha tokë shumë pjellore dhe një shkallë punësimi prej 57.2% të popullsisë së përgjithshme. Për shkak të natyrës kodrinore të territorit të saj, toka bujqësore përdoret më së shumti për kultivimin e frutave, ullinjve, rrushit dhe agrumeve. Prodhimi në terren është gjithashtu i konsiderueshëm dhe përfshin drithëra, perime, gjelbërim etj.

Qytetarët e Kuçovës kanë 3 fe kryesore: Myslimanët 70%, Ortodoksët 25% dhe Katolikët 5%. Traditat dhe zakonet e vjetra kulturore kanë formuar karakteristikën kryesore të komunitetit si tolerancën, mikpritjen, admirimin për artet e bukura dhe përfaqimin e ideve inovative.

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

Përmbajtja e punës së kryer. Gjetjet dhe rekomandimet mbi Auditimin.

3. Auditim mbi menaxhimi financiar dhe kontrolli brendshëm.

- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

Mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi/komunikimi, si dhe monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

- Organizimi dhe funksionimi i NjAB Publik.

- Planifikimi dhe miratimi i programeve vjetoretë auditimit nga ana sasiore dhe analiza sipas llojeve dhe gjetjeve si dhe kapacitetet audituesve të sektorit të auditimit.

- ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga Njësia e Auditit të Brendshëm Publik të Bashkisë.

U auditua funksionimi i pesë elementëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informimi dhe komunikimi, monitorimi. Në përfundim të auditimit arrihet në konkluzionin se Bashkia Kuçovë funksionon pa patur rregullore të brendshme si dhe në mungesë të një paketë të plotë rregullash të tjera të shkruara për të siguruar një funksionim të mirë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit, si elementi bazë dhe kryesor i kontrollit të brendshëm, nuk është në nivelin e duhur, punonjësit kanë mangësi në njohjen e kërkesave të ligjit 10296, datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk janë hartuar programe për të siguruar ruajtjen dhe zhvillimin profesional të stafit. Nuk janë hartuar dokumente si strategjia e menaxhimit të riskut, gjurma e auditimit, harta e proceseve etj.

► **Titulli i Gjetjes nr. 1:** Mungesa e një kuadri të plotë rregullash të shkruara për funksionimin e institucionit, mos ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik, Mungesa e strategjisë për menaxhimin e riskut, Mungesa e rregullores, Mungesa e Kodit të Etikës Profesionale si dhe mangësitë në kontrollin financiar dhe rekrutimin e punonjësve.

Situata: 1. Në Bashkinë Kuçovë nuk është ngritur një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si dhe ka mangësi të plotë të rregullave të shkruara për funksionimin e institucionit.

2. Institucioni për vitet 2018-2020 ka operuar pa rregullore për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë së Kuçovës.

3. Bashkia Kuçovë për vitet 2018-2020 ka vepruar pa patur të hartuar dhe miratuar Kodin e Etikës Profesionale.

4. Për vitin 2020 në Bashkia Kuçovë nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik edhe pse në Ministrinë e Financave në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit është raportuar nëpërmjet pyetësorit të plotësuar, ekzistenca e një GMS të ngritur me urdhër nga titullari.

5. Për periudhën 2018-2020 GSM i Bashkisë Kuçovë nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjikë institucionale me afat jo më pak se sa 5 vjet.

6. Nga ana e titullarit nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut për vitin 2018, 2019 dhe 2020, manuali dhe harta e proceseve të punës, gjurma e auditimit e cila duhet të përfshinte të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë.

7. Gjatë viteve 2018, 2019 dhe 2020, ndryshimet në strukturën organizative, dorëzimi i detyrës si dhe marrja e saj nga persona të tjerë, nuk është bërë me akte dorëzimi dhe inventarizim përkatës.

8. Për periudhën 2018-2020 Bashkia Kuçovë në funksion të kontrollit dhe menaxhimit të veprimtarisë financiare si dhe vjeljes së të ardhurave për tatim taksat lokale, nuk ka aplikuar asnjë program elektronik.

9. Bashkia Kuçovë përveç periudhë 23.04-01.08.2019, për periudhën objekt auditimi 2018-2020 nuk ka emëruar koordinatorin e riskut, megjithëse janë hartuar regjistrat e riskut përkatës.

10. Nga ana e nëpunësit autorizues, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut dhe dokumentimin e tij, ndërkohë për minimizimin e riskut, mashtrimit dhe parregullsive, nga nëpunësi autorizues nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e këtyre fenomeneve.

11. Nga ana e nëpunësit autorizues nuk janë përcaktuar rregulla me shkrim mbi veprimtaritë e kontrollit dhe ndarja e detyrave në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 nëPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò neni 8 pika 8/b nëPërgjegjshmëria menaxheriale e Titullaritò, neni 21 pika 2 nëMenaxhimi i riskutò, neni 22 pika 1 nëVeprimtaritë e kontrollitò; Ligji nr. 139/2015 nëPër vetëqeverisjen vendoreò, neni 9 pika 1.1/b dhe neni 64 germa (a) dhe (j); Ligjit nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 32 dhe UMF Plotësues nr 8 dt. 29.3.2012 nëProcedura e përgatitjes të Buxhetit afatmesëmò, Kap. V.; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 nëKodi i Punës i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 21; Ligji nr. 152/2013 nëPër nëpunësin civilò, i ndryshuar, nenet 2 dhe 19; VKM nr. 124, datë 17.02.2016 nëPër pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civilò Kreu III, pika 27; VKM nr. 171, datë 26.03.2014 nëPër transferimin e përkohshëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civilò, Kreu VII, pika 49, 52, 52; VKM nr. 142, datë 12.03.2014 nëPër përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucioneve të pavaruraò, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos identifikimi dhe menaxhimi i risqeve, mos plotësimi i strukturës me personelin e duhur, ndikojnë në arritjen e objektivave të institucionit. Mosfunksionim i sistemit të kontrollit të brendshëm, sjell risk të lartë për institucionin.

Shkaku: Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.10 nëPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, si dhe nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, duke reflektuar kështu nivel të lartë të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandime:- Kryetari i Bashkisë Kuçovë në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues dhe Kryetarit të GMS-së, si dhe Sekretari i Përgjithshëm duhet të marrin masa të menjëhershme në funksion:

- Të hartojë një kuadër të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshkrimit të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësive dhe të drejtave të punonjësve të njësisë.
- Të merren masa për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik, emërimin e koordinatorit të riskut, të hartohet Strategjia e menaxhimit të riskut, regjistri i riskut, planet e zhvillimit strategjik institucional si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.
- Bashkia Kuçovë, të hartojë Rregulloren për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë së Kuçovëò dhe Kodin e Etikës Profesionale.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë z. S.K. për periudhën nga fillimi i detyrës deri më shtator 2019 dhe në vazhdim z.

K.H., në cilësinë e Titullarit të institucionit. Sekretar i Përgjithshëm **Znj. M.F.** për periudhën e në vazhdim.

3.3. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm, vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

3 Titulli i Gjetjes nr. 2: Mbi krijimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditit të Brendshëm Publik.

Situata: 1. Bashkia Kuçovë, ka miratuar në strukturën organike të saj me VKB nr. 74 prot., datë 15.12.2017, në strukturën organike me VKB nr. 89 prot., datë 19.12.2018, në strukturën organike me VKB nr. 53 prot., datë 19.12.2019, të miratuara nga Kryetari i Bashkisë, ku është përcaktuar me emërtesën përgjegjës sektori të Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe 2 specialistë.

2. Për periudhën e auditimit 2018-2020 Drejtuesit e njësisë së Auditit të Brendshëm nuk kanë hartuar Kartën e Auditimit.

3. Planifikimi vjetor i auditimeve për vitin 2019, është dërguar jashtë afatit në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

4. Raportimi vjetor për vitin 2018 nuk është përgatitur dhe dërguar në DHAB.

5. Përgjegjësit dhe specialistët e NJAB në Bashkinë Kuçovë janë emëruar duke qenë të pa pajisur me certifikatën e audituesit.

6. Në Bashkinë Kuçovë për periudhën 2018-2020 nuk janë çelur as manualisht as elektronikisht dosjet e përhershme të auditimit.

7. NJAB në Bashkinë Kuçovë nuk ka planifikuar auditim të prokurimeve publike që janë zhvilluar në Bashkinë Kuçovë referuar nivelit të riskut dhe materialitetit.

Kriteri: Ligji nr. 114/2015 nëPër auditin e brendshëm në sektorin publikò, neni 10 germa (a), (c); nenin 4, pika 12; neni 11, pika 2, shkronja (b), (c), (ç).

VKM nr. 83, datë 03.02.2016 nëPër miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publikò, neni 6 germa (a).

Urdhërin nr.100 datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave.

Ndikimi/Efekti: Sistem jo funksional i kontrollit të brendshëm, duke mos dhënë siguri titullarit për aktivitetet kryesore të veprimtarisë së institucionit.

Shkaku: Mosnjohje e ligjit nr. 114/2015 nëPër auditin e brendshëm në sektorin publik. Mosnjohje e Urdhërin nr.100 datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave mbi Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: - Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të marrë masa për organizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, në një nga format e përshtatshme që përcakton kuadri ligjor.

- Drejtuesi i Njësisë së Auditit të Brendshëm, të marrë masa për hartimin e Kartës së Auditit.

- NJAB, të marrë masa për hartimin në kohë të Planifikimi vjetor dhe Raportimin vjetor të auditimeve dh dërgimin në afat në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

- NJAB në Bashkinë Kuçovë të planifikojë auditimet të prokurimeve publike që janë zhvillohen në Bashkinë Kuçovë, referuar nivelit të riskut dhe materialitetit.

- Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të marrë masa për të emëruar në NJAB punonjës të certifikuar në AB si dhe të fillojë proceduat për certifikimin e punonjësve aktuale të NJAB.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë z. **S.K.** për periudhën deri me datë 01.09.2019 dhe në vazhdim z. **K.H.**, në cilësinë e Titullarit të institucionit dhe Nëpunësit Autorizues. Drejtuesi i NJAB për periudhën Th.N. dhe në vazhdim z. L.Z., Specialisët e NJAB të Bashkisë Kuçovë z. Sh.G., z. E.M., znj. J.S..

4. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016, ligjin nr. 130/2016, datë 17.12.2016 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2017”, dhe ligjin nr. 109/2017, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2018”, me ndryshimet.

- Programimi i PBA 2018-2021 dhe programimi i buxhetit vjetor 2018 - 2020;
- Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;
- Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit;
- Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli i realizimit të ardhurave; (Faturat e palikuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF);
- Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;
- Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat logjore dhe borxhi tatimor.

► **Titulli i gjetjes nr. 1:** Në Bashkinë Kuçovë u konstatua se, ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave dhe shpenzimeve të veta.

Situata: - Nga auditimi u konstatua se, buxheti i viteve 2018, 2019 dhe 2020 është miratuar sipas procedurave dhe kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 nëpër menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, nëpër menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 nëpër sistemin e taksave vendore dhe i ndryshuar.

- Buxheti vjetor 2018 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr.70, datë 22.12.2017 i konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat, me shkresën nr. 2080/1 prot, datë 27.12.2017.
- Buxheti vjetor 2019, është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr.102, datë 22.12.2018 i konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat, me shkresën nr. 2831/1 prot, datë 27.12.2018.
- Buxheti vjetor 2020, është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr. 49, datë 24.12.2019 i konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat, me shkresën nr.1569/1. prot, datë 10.01.2020.

Tabela 2.1.1. Realizimi i shpenzimeve dhe të ardhurave të veta.

Viti	Të ardhura të veta-000/lekë				Shpenzimet buxhetore-000/lekë			
	Plan	Fakt	Diferenca	%	Plan	Fakt	Diferenca	%
2018	174,305	127,088	47,217	72	894,887	782,568	112,319	87
2019	213,183	136,512	77,018	64	804,115	689,082	115,033	86
2020	212,297	112,751	99,546	53	865,164	722,571	142,593	84

Nga të dhënat e Drejtorisë së Financës, për vitin 2018, shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 894,887 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 782,568 mijë lekë ose në masën 87%, sipas artikujve: paga në masën 97%, sigurime në masën 98 %, shpenzime operative në

masën 70 %, dhe investime në masën 83 %, për vitin 2019, shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 804,116 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 689,082 mijë lekë ose në masën 86%, sipas artikujve: paga në masën 94%, sigurime në masën 96 %, shpenzime operative në masën 71 %, dhe investime në masën 74 % dhe për vitin 2020, shpenzimet buxhetore janë planifikuar në vlerën 865,164 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 722,571 mijë lekë ose në masën 84%, sipas artikujve: paga në masën 93%, sigurime në masën 94 %, shpenzime operative në masën 72 %, transferta tek institucione në masën 33%, transferta tek individë 99% dhe investime në masën 70 %.

Referuar të dhënave të mësipërme, rezulton se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, për sa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre, gjë e cila ka ndikuar në mosrealizim të shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të Bashkisë.

Kriteri: -Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 nëPër menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe i ndryshuar, ligji nr.10296, datë 08.07.2010 nëPër menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, ligji nr.9632, datë 30.10.2006 nëPër sistemin e taksave vendore dhe i ndryshuar, ligji nr. 68/2017 nëPër Financat e Vetëqeverisjes Vendore, ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 nëPër vetëqeverisjen vendore, UMF nr.10, datë 28.02.2017, nëPër përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020, si dhe UMF nr.10/1, datë 28 02 2017 nëPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor, Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016 nëPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

Impakti: Planifikimi i të ardhurave të veta, zërave të shpenzimeve e investimeve dhe mos realizimi i tyre kryesisht për shkak të mosrealizimit të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve. Gjithashtu, krijohen premisa për marrjen e angazhimeve buxhetore, pa patur burime financimi reale.

Shkaku: Analizat e punës për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetet paraardhëse nuk janë bërë të plota, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve gjatë viteve të audituara.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, në cilësinë e Titullarit dhe të Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, duhet të marrin masa, që gjatë procesit të planifikimit të PBA-ve dhe buxheteve vjetore, të mbështeten në analiza të hollësishme mbi kapacitetet ekonomike, financiare dhe resurset e territorit nën administrim, për një planifikim sa më objektiv dhe real të të ardhurave, me qëllim mos krijimin e diferencave të dukshme midis planifikimit dhe realizimit të buxhetit, gjë e cila shoqërohet me marrje angazhimesh për kryerje shpenzimesh, si dhe mos likuidim të tyre për shkak të mungesës së likuiditetit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

1. Z. S.K., ish Kryetar i Bashkisë Kuçovë si Nëpunës Autorizues;
2. Z. K.H., Kryetar i Bashkisë Kuçovë si Nëpunës Autorizues;
3. Znj. H.SH., Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit;
4. Z. A.Ç., Drejtor i të ardhurave lokale.

► **Titulli i gjetjes nr. 2:** Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

Situata: Tabela “Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitet 2018, 2019 dhe 2020”

Vitet	Programimi dhe realizimi i të Ardhurave	Diferenca	Planifikimi dhe përdorimi i të ardhurave në Buxhet	Diferenca
-------	---	-----------	--	-----------

	Plani	Fakti i vitit		Plani fillim Buxhetit , plan i perditës uar	Fakti në thesar sipas realizimit dhe i trashëguar.	
Viti 2018	155,679	129,231	26,448	174,305	140,157	34,148
Viti 2019	201,072	135,514	66,058	213,183	146,626	65,558
Viti 2020	201,417	115,747	71,795	212,297	126,627	85,970

Sa më sipër, për vitin 2018, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore gjithsej, nga 155,679 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 129,231 mijë lekë ose 83 %, me një mosrealizim në vlerën 26,448 mijë lekë.

Për vitin 2019, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore gjithsej, nga 201,072 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 135,514 mijë lekë ose 67 %, me një mosrealizim në vlerën 66,058 mijë lekë.

Për vitin 2020, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore gjithsej, nga 212,417 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 115,747 mijë lekë ose 57.46 %, e ardhura e trashëguar është 13,875 lekë për vitin 2021, me një mosrealizim në vlerën 71,795 mijë lekë.

Kriteri: - Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore;

- Ligji nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Impakti: Në hartimin dhe zbatimin e buxheteve vjetore, treguesve kryesorë të buxhetit, të ardhurat dhe shpenzimet.

Shkaku: Mos zbatimi i legjislacionit në fuqi, i udhëzimeve për hartimin e buxheteve vjetore, shkelje e disiplinës financiare mbi detyrimet e prapambetura dhe vendimeve gjyqësore

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, në bashkëpunim me strukturën e të ardhurave lokale duhet të marrë masa të menjëhershme, për koordinimin e punës midis sektorëve, bashkëpunimin me struktura të tjera si QKB, Drejtoria e Tatimeve Rajonale, Zyrat e Gjendjes Civile, DRSHTRR, etj, me qëllim:

1. Marrjen e masave për evidentimin e resurseve, analizimin dhe planifikimin e të ardhurave nga taksat kombëtare;

2. Marrjen e masave për kryerjen e rakordimeve me Zyrën e Gjendjes Civile nga ana e Sektorit të Tatim Taksave Vendore, për të nxjerrë numrin real të familjeve në Bashkinë Kuçovë, si dhe marrjen e masave për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të Njoftimit Vlerësimit, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

1.Z. S.K., ish Kryetar i Bashkisë Kuçovë si Nëpunës Autorizues;

2.Z. K.H., Kryetar i Bashkisë Kuçovë si Nëpunës Autorizues;

3.Znj. H.SH., Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit;

4.Z. A.Ç., Drejtor i të ardhurave lokale.

► **Titulli i gjetjes nr. 3:** Programimi dhe zbatimi i buxhetit për vitet 2018, 2019 dhe 2020, programimi i pagesave për detyrimet e prapambetura, vendimet gjyqësore.

Situata: - Nga auditimi u konstatua se detyrimet për fatura dhe vendime gjyqësore më datë 31.12.2020, për Bashkinë Kuçovë dhe dy njësitë shpenzuese Qendra Ekonomike e Arsimit dhe Ndërmarrja Komunale janë gjithsej në vlerën 163,934,913 lekë (vlera 110,064,497 lekë i përkasin detyrimeve 2019 e para dhe vlera 53,870,416 lekë janë detyrime që i përkasin vitit 2020).

- Drejtoria Financës, Bashkia Kuçovë dhe dy njësitë shpenzuese deri më datë 31.12.2020, nuk kanë likujduar detyrime në vlerën gjithsej 163,934,913 lekë, për fatura dhe vendime gjykate të cilët i përkasin vitit 2019 e para (për mallra e shërbime, etj. në vlerën 163,461,599 lekë dhe shpenzime për Vendime Gjykate në vlerën 473,314lekë),

Kriteri: - Ligji nr. 9936 nëPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar neni 52.

- Ligji nr. 9928, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar neni 9 dhe neni 10

- UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar me UMF nr.5/1, datë 21.05.2014;

- Udhëzimi plotësues i MF nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 – Detyrimet e prapambetura të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore.

-Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 nëPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, pika 101 ku cilësohet: “Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim”. Pika 102 ku cilësohet: “Njësitë e qeverisjes vendore, zbatojnë edhe detyrimet financiare që rrjedhin nga vendime gjyqësore e formës së prerë në ngarkim të tyre”.

-Udhëzimi nr. 29, datë 20.03.2018 nëPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, pika nr. 37 ku citohet: nëTitullari është kreu i organit qendror të njësisë së qeverisjes së përgjithshme dhe është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave që duhet të ndiqen në procesin e zbatimit të buxhetit në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.” Pika nr. 38 ku citohet: “Titullari monitoron zbatimin e buxhetit nëpërmjet kërkesës së llogarisë ndaj nëpunësit autorizues, duke vendosur mënyrën e raportimit mbi bazë performance si dhe frekuencën e raportimit.” Neni nr.39 ku citohet: “Titullari merr pjesë aktive në vendimet strategjike të menaxhimit nëpërmjet kryesimit të mbledhjeve periodike të Grupit të Menaxhimit Strategjik të njësisë së qeverisjes së përgjithshme”.

Impakti: Në hartimin dhe zbatimin e buxheteve vjetore, treguesve kryesorë të buxhetit, të ardhurat dhe shpenzimet.

Shkaku: Mos zbatimi i legjislacionit në fuqi, i udhëzimeve për hartimin e buxheteve vjetore, shkelje e disiplinës financiare mbi detyrimet e prapambetura dhe vendimeve gjyqësore

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, në cilësinë e Titullarit të Institucionit dhe Nëpunësit Autorizues, si dhe Nëpunësi Zbatues, duhet të marrin masa që gjatë procesit të planifikimit të buxheteve vjetore, të planifikojë mbulimin me buxhet, së pari për detyrimet e papaguara dhe detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore.

Gjatë zbatimit të buxheteve vjetore, për investimet që financohen nga të ardhurat e veta të merret paraprakisht miratimi në Këshillin Bashkiak, të zbatohen të gjitha procedurat ligjore bazuar në udhëzimet vjetore dhe standarde të planifikimit dhe zbatimit të buxheteve vjetore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

1. Z. S.K., ish Kryetar i Bashkisë Kuçovë si Nëpunës Autorizues;
2. Z. K.H., Kryetar i Bashkisë Kuçovë si Nëpunës Autorizues;
3. Znj. H.SH., Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit;
4. Z. A.Ç., Drejtor i të ardhurave lokale.

4.6 Burimi i krijimit të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore në fuqi dhe borxhi tatimor.

Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Për periudhën objekt auditimi, sipas strukturës organizative, për mbledhjen e të ardhurave ka funksionuar Drejtoria e të Ardhurave, me 2 Sektorë: Sektori i Kontabilitetit dhe Rakordimit; Sektori i Kontrollit dhe Masave shtrënguese, me 12 nëpunës, nga të cilët 1 Drejtor Drejtorie, 2 Përgjegjës sektorësh dhe 10 inspektorë.

Paketat fiskale për periudhën objekt auditimi janë miratuar me VKB nr. 56, datë 04.10.2017 për miratimin e taksave dhe tarifave për vitin 2018, VKB nr. 93, datë 23.11.2018 për miratimin e taksave dhe tarifave për vitin 2019 dhe VKB nr. 41, datë 21.11.2019 për miratimin e taksave dhe tarifave për vitin 2020.

Për auditimin e burimit të krijimit të ardhurave dhe përdorimit të tyre u auditua dokumentacioni i paraqitur nga sektori i taksave dhe tarifave vendore si:

- evidencat analitike të llogarive debitorë për taksat dhe tarifatat vendore;
- akt rakordimi me degën e thesarit për realizimin e të ardhurave nga tatim taksat vendore;
- evidencat mbi gjendjen e debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore për subjektet dhe për detyrimet familjare, regjistrat e bizneseve;
- administrimi i aseteve;
- procedura e lëshimit të licencave dhe autorizimeve;
- dokumente mbi procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore.

► Titulli i gjetjes nr. 4: Gjendja e subjekteve për taksat dhe tarifatat vendore

Situata: -Drejtorja e të Ardhurave, Bashkia Kuçovë për periudhën objekt auditimi realizimin e të ardhurave e ka në nivel të ulët kjo tregon për punë të pamjaftueshme në zbatim të kërkesave ligjore rezulton se: mosrealizimin më të madh në totalin e të ardhurave e kanë të ardhurat nga taksat vendore të cilat për vitin 2018, nga 44,036 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 24,134 mijë lekë ose 55 %, me një mosrealizim në vlerën **19,902 mijë** lekë më pak, ku ndikim ka mosrealizimi taksës së ndërtesave të banimit dhe biznesit, taksa e tokës bujqësore dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë, për vitin 2019, nga 103,226 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 36,678 mijë lekë ose 35 %, me një mosrealizim në vlerën **64,548** mijë lekë më pak, ku ndikim ka mosrealizimi taksës së ndërtesave të banimit dhe biznesit, taksa e tokës bujqësore, taksa e truallit dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe për 6/mujorin e vitit 2020, mosrealizimin më të madh në totalin e të ardhurave e kanë të ardhurat nga taksat vendore të cilat, nga 69,900 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 7,041 mijë lekë ose 10 %, me një mosrealizim në vlerën **62,859** mijë lekë më pak, ku ndikim ka mosrealizimi taksës së ndërtesave të banimit dhe biznesit, taksa e tokës bujqësore, taksa e truallit dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë.

-Në auditimin e dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e të Ardhurave, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej debitorë 344 subjekte për vlerën 11,109,199 lekë. Nga Drejtoria e të Ardhurave për subjektet debitorë përveç se janë dërguar bankave urdhër bllokime dhe barrë siguruese në drejtorinë e transporteve dhe hipotekë, por në asnjë rast nuk kemi ndjekje të plotë të procedurave të arkëtimin të debitorëve, deri në nxjerrjen e Urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve, në kundërshtim me kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet.

-Në verifikimin e listave të subjekteve debitorë në vite, konstatohen subjekte aktiv dhe me detyrime. Kështu sipas të dhënave nga 344 subjekte debitorë në vlerën 11,109,199 lekë, janë aktiv 289 subjekte ose 84 % e totalit të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa, në vlerën 9,866,559 lekë ose 89 % e vlerës së debitorëve, gjë e cila tregon punën e pamjaftueshme dhe

këmbgule të Drejtorisë e të Ardhurave në arkëtimin e detyrimeve debitorë, në mos zbatim të *Kreut XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet; ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.*

-Nga auditimi në lidhje me debitorët familjarë u konstatua se në fund të periudhës datë 31.12.2019, janë debitorë për taksë toke taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa shërbimi, 4431 familje për vlerën gjithsej 52,875,000 lekë.

-Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Kuçovë për periudhën objekt auditimi nuk ka arkëtuar detyrime kontratave dhe kamatvonesat nga 155 fermerë në vlerën 13,527,645 lekë, që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë, (detyrim kontrate viti 2017 e para në vlerën 642,188 lekë, viti 2018 në vlerën 960,488 lekë dhe viti 2019 në vlerën 981,906 lekë dhe kamatvonesa në vlerën 10,943,063 lekë).

Tabela nr. 2.3.2 “Gjendja e subjekteve të regjistruara”

Lloji	Viti 2018				Viti 2019				2020			
	Gj.fillim	Regjis	Çregjis	Gj. fund	Gj.fillim	Regjis.	Çregjis	Gj. fund	Gj.fillim	Regjis	Çregjis	Gj. fund
B.vogel	732	79	7	804	804	84	23	865	865	58	17	906
B.madh	74	3	0	77	77	3	0	80	80	2	1	81
Insti	23	0	0	23	23	0	0	23	23	0	0	23
Totali	829	82	7	904	904	87	23	968	968	60	18	1010

Kriteri: Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 nëPër sistemin e taksave vendore, neni 4 ku cilësohet: *“Zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë”, pika 7 Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar. Neni 16 ku cilësohet: “Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë, është i detyruar që, deri më 10 shkurt të vitit që pason periudhën tatimore, të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat, gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, tatimi për t’u paguar, si dhe çdo hollësi tjetër e kërkuar nga Ministri i Financave në udhëzimin për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore. Deklarata dorëzohet në bankat, me të cilat administrata tatimore ka marrëveshje për pranimin e deklaratave dhe të pagesave dhe ajo shoqërohet me çdo kërkesë për rimbursim apo me çdo shumë për t’u paguar -Udhëzimi nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.*

-Ligji nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar nëPër procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, neni 41 ku cilësohet: *“Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar” 1. Kur administrata tatimore identifikon persona, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomiko tregtare pa u regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, vendos masën e bllokimit të mallrave dhe detyron personin të regjistrohet menjëherë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si tatimpagues i tatimit mbi vlerën e shtuar. Masa e bllokimit hiqet pas kryerjes së regjistrimit për veprimtarinë ekonomike, duke aplikuar masat dhe dënimin, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 121, të këtij ligji. 2. Në rast se një person ushtron veprimtari në fushën e shërbimeve, i pajisur me leje/licencë/autorizim profesional, por nuk e ka regjistruar veprimtarinë në QKB, përveç sa është parashikuar në pikën 1, të këtij neni, për mallrat që disponon, administrata tatimore u propozon strukturave kompetente pezullimin e lejes/licencës/autorizimit për ushtrim veprimtarie për një periudhë gjashtëmuajore.*

Impakti: Mungesa e kontrollit të territorit nga strukturat e zyrës së tatim taksave për evidentimin e subjekteve aktive dhe të ardhurat që realizojnë.

Shkaku: Mos zbatimi i legjislacionit në fuqi, dhe mos veprim i zyrës së taksave

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Kuçovë duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore, sipas të dhënave të Sektorit të Bujqësisë, për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore, në shumën prej **13,527,645 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Kuçovë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

1. Z. S.K., ish Kryetar i Bashkisë Kuçovë si Nëpunës Autorizues;
2. Z. K.H., Kryetar i Bashkisë Kuçovë si Nëpunës Autorizues;
3. Znj. H.SH., Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit;
4. Z. A.Ç., Drejtor i të ardhurave lokale.

► **Titulli i gjetjes nr. 5:** Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

Situata: Nga të dhënat e pasqyrës së mëposhtme në Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitet 2018, 2019 dhe 2020 rezulton se, për vitin 2018, të ardhurat në total, nga 155,679 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 129,231 mijë lekë ose 83 %, me një mosrealizim në vlerën 26,448 mijë lekë më pak .

Mosrealizimin më të madh në totalin e të ardhurave e kanë të ardhurat nga taksat vendore të cilat për vitin 2018, nga 44,036 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 24,134 mijë lekë ose 55 %, me një mosrealizim në vlerën 19,902 mijë lekë më pak, ku ndikim ka mosrealizimi taksës së ndërtesave të banimit , taksa e tokës bujqësore dhe taksa e ndikimit në infrastrukture.

Për vitin 2019, të ardhurat në total, nga 201,072 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 135,514 mijë lekë ose 67 %, me një mosrealizim në vlerën 66,058 mijë lekë.

Edhe për këtë vit mosrealizimin më të madh në totalin e të ardhurave e kanë të ardhurat nga taksat vendore të cilat për vitin 2019, nga 103,226 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 36,678 mijë lekë ose 35 %, me një mosrealizim në vlerën 66,548 mijë lekë më pak, ku ndikim ka mosrealizimi taksës së ndërtesave të banimit dhe biznesit, taksa e tokës bujqësore, taksa e truallit dhe taksa e ndikimit në infrastrukture.

Për vitin 2020, të ardhurat nga taksat e tarifat vendore gjithsej, nga 196,753 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 115,747 mijë lekë ose 59 %, me një mos realizim në vlerën 81 006 mijë lekë.

Edhe për vitin 2020 mosrealizimin më të madh në totalin e të ardhurave e kanë të ardhurat nga taksat vendore të cilat, nga 97,614 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 22,154 mijë lekë ose 22.7 %, me një mosrealizim në vlerën 75,460 mijë lekë më pak, ku ndikim ka mosrealizimi taksës së ndërtesave të banimit te cilat faturohen e arketohen nga Agjenti Fiskal Ujesjelles-Kanalizime sh.a; taksa e tokës bujqësore, ne vecanti taksa e truallit dhe taksa e ndikimit në infrastrukture specifikisht nga Legalizimet (të cilat janë në zero).

-Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, është planifikuar duke mos patur një databazë të saktë për numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllen dhe regjistrohen, nuk ka bazë të dhënash për subjektet të cilët në bazë të xhiros do paguajnë tatimin e fitimit. Taksa e mjeteve të përdorura është planifikuar sipas të dhënave historike pra nuk ka një databazë të saktë për numrin e mjeteve të përdorura që ka Bashkia Kuçovë. Taksa e kalimit e të drejtës në pronësi është planifikuar sipas të dhënave të realizimit të një viti më parë. Drejtoria e të Ardhurave, duke mos patur një bazë të dhënash nuk ka bërë rakordime me Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat (DRTB), Agjensinë Shtetërore të Kadastrës Kuçovë (ASHKK) dhe Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Berat (DSHTRB).

Taksë e tokës, taksë ndërtese, tarifë pastrimi, ndriçimi dhe gjelbërimi, për abonentët familjarë Bashkia Kuçovë e realizon nëpërmjet agjentit tatimor që në rastin konkret është UK Kuçovë,

sipas kushteve të akt-marveshjes nr.07, datë 07.01.2014, në të cilën sanksionohet të përfshijë në faturën e ujit për kategorinë abonentë në Familjarë detyrimet për Taksa e tarifa si më sipër. Drejtoria e të ardhurave për familjet që nuk kanë një kontratë me UK Berat nuk ka dërguar njoftim detyrimi për këto familje, baza e të dhënave për familjet që nuk kanë kontratë me ujësjellësin përditësohet vetëm për rastet kur familjarët paraqiten pranë zyrave të bashkisë për të marrë shërbime të ndryshme. Akt rakordimet me agjentët tatimorë nuk janë mbajtur sipas formatit të përcaktuar me Udhëzim të posaçëm nga Ministria e Financave. Rakordimet janë bërë në formë proces-verbalesh, duke marrë informacion vetëm për sasinë e arkëtimeve, por nuk mund të konsiderohen rakordime pasi nuk ka asnjë të dhënë statistikore në bazë të së cilës të bëhen llogaritjet dhe të vlerësohet niveli i mbledhjes së të ardhurave, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 në *Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar, Neni 117 në *Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave*, ku përcaktohet se: *Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifën e mbledhura, apo i shmanget mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së pambledhura apo të shmanguar*, UMF Nr. 26, datë 4.9.2008 në *Për Taksat Kombëtare*, i ndryshuar, Formularët e akt-rakordimeve.

“Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitet 2018, 2019 dhe 2020”

Nr	Emërtimi	Viti 2018		Viti 2019		Viti 2020	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
I	TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	44,036	24,134	103,226	38,678	97,614	22,154
1	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për Biz. e vogël	1,000	2,230	1,500	519	1,000	1,265
2	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	0	177	0	17	0	0
3	Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	12,690	5,317	10,965	8,477	11,448	8,895
a	<i>Ndërtesa banimi</i>	3,967	546	6,750	2,353	7,130	4,740
b	<i>Ndërtesa të tjera</i>	8,723	4,771	4,215	6,124	4,318	4,155
4	Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	13,056	6,425	13,056	6,579	13,056	5,967
5	Të ardhura nga taksa mbi truallin	4,430	4,274	64,605	19,041	64,492	473
6	Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	300	477	450	131	200	166
7	Taksa e ndikimit në infr. nga ndërtimet e reja	12,000	4,815	12,000	3,914	5,000	4,971
8	Taksa e ndikimit në infr. nga legalizimet	0	0	0	0	2,000	23
9	Takse Tabele	560	419	650	200	418	201
10	Takse Reklame	0	0	0	238	0	193
II	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	10,280	11,192	10,300	12,959	12,300	20,796
1	Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura	7,980	11,173	8,000	12,464	10,000	12,884
2	Taksa pronësisë për pasuritë e paluajtshme	0	0	0	0	0	76
3	Tatimi mbi të Ardhurat Personale					0	6,997
4	Të ardhura nga taksa e rentës minerare	2,300	19	2,300	495	1,100	839
III	TË ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	54,505	44,741	69,602	67,962	67,601	56,850
1	Të ardhura nga tarifa e pastrimit të mbeturinave	23,830	18,535	31,200	30,154	31,692	28,870
a	<i>Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Familje</i>	10,190	6,098	10,290	8,250	10,841	7,667
b	<i>Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Institucione</i>	3,100	2,898	10,100	9,826	8,731	8,635
c	<i>Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Biznesi</i>	10,540	9,539	10,810	12,078	12,120	12,569
2	Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	8,800	6,981	9,122	9,532	10,629	8,146
a	<i>Të ardhura për ndriçimin publik nga Familje</i>	6,650	4,671	6,537	5,873	7,142	5,056
b	<i>Të ardhura ndriçimi publik nga Institucione</i>	200	168	250	315	320	300
c	<i>Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Biznesi</i>	1,950	2,142	2,335	3,344	3,167	2,790
3	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	5,530	4,015	7,080	8,397	7,685	6,666
a	<i>Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga Familje</i>	2,500	2,205	2,500	3,430	2,839	2,006
b	<i>Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Institucione</i>	820	766	2,300	3,430	2,210	2,296
c	<i>Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Biznesi</i>	2,210	1,044	2,280	1,537	2,636	2,364
4	Të ardh. tarifa të shërbimit të bashkisë	11,695	10,267	17,400	14,957	17,505	13,169
a	<i>Nga tarifa veterinere të bagëtive të therura</i>	50	62	250	3	0	0
b	<i>Nga Tarifën e licensimit të transportit</i>	200	268	200	375	220	386
c	<i>Nga tarifa parkimi.</i>	300	289	300	307	300	310
d	<i>Nga tarifë dhënie licensa për tregtimin e naftës.</i>	200	100	200	0	2,020	2,700

Nr	Emërtimi	Viti 2018		Viti 2019		Viti 2020	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
e	Nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave.	1,250	420	1,300	478	1,300	313
f	Nga tarifat e shërbimeve që kryen e MNZ	85	16	664	551	150	90
g	Nga tarifa për zënien e hapësirave publike	9,610	9,112	9,686	8,321	8,805	6,481
i	Tarifa nga kopshtet	2,800	3,673	2,800	3,303	2,800	1,923
j	Tarifa nga cerdhet	1,850	1,360	2,000	1,619	2,000	965
IV	TË ARDHURA TË TJERA	46,858	49,154	17,944	24,222	19,238	14,389
1	Të ardhura nga kundravajtjet administrative	0	2,014	0	1,756	0	1,305
2	Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve.	11,028	2,526	11,028	2,357	11,028	2,067
3	Të ardhura nga sekuestime dhe zhdëmtime	0	0	0	1,597	0	0
6	Të ardhura të tjera	35,830	44,614	6,916	10,205	8,210	11,017
V	TË ARDHURA NGA DONACIONET	0	10	0	0	0	1,557
1	Gjoha Gjendje Civile	0	10	0	0	0	10
2	Sponsorizime						1,547
	Totali	155,679	129,231	201,072	135,514	196,753	115,747

Kriteri: Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 nëPër sistemin e taksave vendore;

- Ligji nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar nëPër procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë.

-Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 nëPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Neni 117 nëDënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave, ku përcaktohet se: nëAgjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifat e mbledhura, apo i shmanget mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjohë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së pambledhura apo të shmangu.

-UMF Nr. 26, datë 4.9.2008 nëPër Taksat Kombëtare, i ndryshuar.

Impakti: Mos realizimi i të ardhurave, mosvjelja e detyrimeve etj., ka impakt negativ në burimet e financimit dhe për rrjedhojë në realizimin e shpenzimeve, për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Shkaku: Punë e pamjaftueshme e administratës së Bashkisë Kuçovë si dhe mosrakordim me strukturat e tjera, si QKB, Drejtoria e Tatimeve Gjirokastër, Zyrat e Gjendjes Civile etj. me qëllim evidentimin e subjekteve të paregjistruara, zbatimin e masave shtrënguese për vjeljen e detyrimeve etj.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, duhet të marrë masa të menjëhershme, për koordinimin e punës midis sektorëve, bashkëpunimin me struktura të tjera si QKB, Drejtoria e Tatimeve, Zyrat e Gjendjes Civile, DRSHTRR, etj me qëllim:

1. Kryerjen e rakordimeve me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër, (në cilësinë e agjentit tatimor) për numrin e subjekteve që duhet të paguajnë, si dhe të ardhurat që ato kanë realizuar brenda një viti ushtrimor, si dhe kryerjen e rakordimeve 6-mujore mbi realizimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin;
2. Marrjen e të dhënave mbi bizneset në QKB, që në fazën e planifikimit, mbi numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit ushtrimor mbyllen ose regjistrohen, dhe bazën e të dhënave për subjektet, të cilët në bazë të aktivitetit dhe xhiros vjetore, do të jenë objekt për pagesën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin;
3. Marrjen e masave për evidentimin e resurseve, analizimin dhe planifikimin e të ardhurave nga taksat kombëtare;
4. Marrjen e masave për kryerjen e rakordimeve me Zyrën e Gjendjes Civile nga ana e Sektorit të Tatim Taksave Vendore, për të nxjerrë numrin real të familjeve në Bashkinë Kuçovë, si dhe marrjen e masave për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të

ñNjoftim Vlerësimitò, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

► **Titulli i gjeties nr. 6:** Gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa në datë 31.12.2020

Situata: Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2020 për mos pagesën e detyrimeve tatimore në vlerën gjithsej 75,423,597 lekë, janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh gjithsej 338 subjekte në vlerën **12,391,597** lekë dhe 4431 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej **63,032,000 lekë**.

Për periudhën objekt auditimi, përfshihen debitorët e biznesit të vogël për 314 subjekte në vlerën 10,015,942 lekë dhe debitorët e biznesit të madh për 24 subjekte në vlerën 2,375,655 lekë, sipas të dhënave të administruara në regjistrat e Drejtorisë së të Ardhurave.

Drejtoria e të Ardhurave, në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimit të detyrimeve në zbatim të kreut XI-ñMbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore, me ndryshime, kështu gjatë vitit 2019, nga Drejtoria e të Ardhurave me shkreat nr. 3048, datë 10.09.2019, vendosje barre siguruese, nr. 3049, datë 10.09.2019, vendosje barre hipotekore, nr. 3050, datë 10.09.2019, nr. 3148, datë 17.09.2019, Bllokim llogarie bankare, për 39 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 917,856 lekë dhe 8 subjekte të biznesit të madh në vlerën 515,471 lekë, të Nj/Administartive Kuçovë, për 24 subjekte të biznesit të vogël dhe të madh në vlerën 205,921 lekë të Nj/Administrative Kozare, për 36 subjekte të biznesit të vogël dhe të madh në vlerën 370,324 lekë të Nj/Administrative Perondi dhe me shkresat nr 3434, datë 04.10.2019, bllokim i llogarive bankare, nr. 3433, datë 04.10.2019, Vendosje barre hipotekore, nr. 3432, datë 04.10.2019, vendosje barrë siguruese, për 12 subjekte në vlerën 106,224 lekë të Nj/Administrative Lumas dhe gjatë vitit 2020, me shkresën nr.2058, datë 10.06.2020, për 140 subjekte të biznesit të vogël në vlerën .

Gjithashtu gjatë vitit 2020, në kuader të masave rekomanduara dhe nga audituesit e grupit të KLSH, janë urdhëruar bllokimi i llogarive bankare me Urdherin nr.1923.prot date 18.06.2020 për subjektet e biznesit debitorë 2011-2019 për 224 subjekte biznesi vogël dhe 20 subjekte të biznesit të madh në vlerën 6,434,086 leke, vijuar me urdherat e bllokimit të llogarive bankare nr.2272.prot date 09.07.2020 për 20 subjekte biznesi debitorë, urdheri nr.2197.prot date 03.07.2020; vendosja e barres hipotekore me urdherin nr.1922.prot date 18.06.2020 për 224 subjekte biznesi i vogël dhe 20 subjekte debitorë të biznesit të madh. Gjithashtu është bërë njoftimi dhe urdheri me shkresën nr. 3363 prot datë 01.10.2020 për bllokim me Policinë Bashkiake, për 208 subjekte të biznesit debitorë për vitet 2011-2019. Me urdherin nr. 3539 prot date 13.10.2020, është bërë bllokimi i llogarive bankare për 16 subjekte të biznesit të vogël që rezultuan debitorë për ngarkesën e detyrimeve të vitit 2020, si dhe me urdherin nr. 4155 datë 27.11.2020 janë bërë bllokimi i llogarive bankare për 7 subjekte të biznesit të madh që rezultuan debitorë të detyrimeve të vitit 2020

Sa më sipër edhe pse vazhdojnë procedurat mbledhjes me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 338 subjekte debitorë në vlerën 12,391,597 lekë, janë aktiv 289 subjekte ose 84 % e totalit të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa, në vlerën 9,017,715 lekë ose 73 % e vlerës së debitorëve.

Kriteri: Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Kreu XI- *“Mbledhja me forcë e detyrimeve të papaguara”*, të neneve 88 deri 104, *Në funksion të mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administruara tatimore mund të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 për qind të qarkullimit të realizuar, por jo më shumë se detyrimi tatimor, për të cilin ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve*

tatimore, për llogari të detyrimeve tatimore të pashlyera të tatimpaguesit. Pagesa e shumë së qarkullimit të sekuestruar kalohet në llogarinë bankare të administratës tatimore ditën e nesërme. Tatimpaguesi, për të cilin administrata tatimore ka filluar mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara, nuk mund të kryejë transferim të shumave të parave nga llogaria e tij apo të shesë\të transferojë aktivet ose kapitalet e shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, nëpërmjet shitjes\transferimit të aktiveve, synohet shlyerja në masën 100 për qind e detyrimit tatimor të papaguar dhe për rastet kur subjektet nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga Sektori i Taksave dhe Tarifave, nuk është bërë kallëzim penal ndaj subjekteve problematike debitorë dhe me vlera të konsiderueshme, mbështetur në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, neni 181 "Mospagimi i taksave dhe tatimeve".

"Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet."

Impakti: Veprime që çojnë në mungesë të ardhurash në Buxhetin e Bashkisë Kuçovë dhe mos kontabilizimi i debitorëve në pasqyrat financiare, paraqet një situatë financiare ndryshe nga sa është në realitet.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në arkëtimin e detyrimeve nga debitorët.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kuçovë të marrë masat e duhura, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura për vlerën gjithsej **75,423,597 lekë**, gjithsej 338 subjekte në vlerën **12,391,597 lekë** dhe 4431 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej **63,032,000 lekë** konkretisht:

- Të dërgohen bankave të nivelit të dytë, urdhër bllokime të llogarive bankare të subjekteve;
- Të dërgohet Drejtorisë Rajonale të Transportit kërkesa për vendosje barrë siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme);
- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhojë strukturat e tij, për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar;
- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet e krijuara në vite, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sektori Juridik, të marrë masa administrative, apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të RSH, neni 181 në Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

1. Z. S.K., ish Kryetar i Bashkisë Kuçovë si Nëpunës Autorizues;
2. Z. K.H., Kryetar i Bashkisë Kuçovë si Nëpunës Autorizues;
3. Znj. H.SH., Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit;
4. Z. A.Ç., Drejtor i të ardhurave lokale.

► Titulli i gjetjes nr. 7: Mbi aplikimin e tarifës për lejet dhe autorizimet për subjektet që tregtojnë hidrokarbure.

Situata: Në Bashkinë Kuçovë gjatë periudhës objekt auditimi kanë ushtruar aktivitetin e tregëtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë 14 subjekte.

Nga auditimi rezultoj se nga këto janë pajisur me Autorizim/Licencë nga Bashkia Kuçovë të 14 subjektet nga të cilët 11 subjekte nuk kanë likuiduar detyrimin e plotë dhe kanë krijuar të ardhura të munguara prej 8,900,000 Lekë.

-U konstatua se 2 subjekte "Pirko" shpk" dhe "F.D." shpk janë paisur nga Bashkia me licencën për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, duke u rregjistruar me tarifen 100,000 lekë, ndërkohë që sipas VKM duhet të ishin rregjistruar me tarifen 1,000,000 lekë

Kriteri: - Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 nëPër sistemin e taksave vendore, neni 35 ku cilësohet:

"1. Çdo pagesë tjetër në buxhetin e bashkisë, të komunës ose të qarkut klasifikohet si tarifë kur:

a) përkon me përcaktimet e pikës 3 të nenit 16 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore";

b) nuk është taksë bashkiake ose komunale, si dhe gjobë e lidhur me to, në përputhje me këtë ligji.

2. Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore". Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifat e lidhura me to, këshilli bashkiak dhe ai komunal vendosin për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, përcaktojnë nëse tarifat do të mbledhen nga vetë strukturat bashkiake ose komunale apo nga një agjent".

- VKM nr.170, datë 25.4.2002 nëPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, i ndryshuar, kapitulli II, kapitulli III, pika 4, ku cilësohet:

II. Procedura për dhënien e autorizimeve

Dhënia e autorizimeve për funksionimin e stacioneve të shitjes së karburanteve, të ndërtuara në autostrada, bëhet nga ministri që mbulon veprimtarinë e transportit, ndërsa dhënia e autorizimit për stacionet e tjera të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikante dhe stacionet e mbushjes së bombolave të gazit të lëngshëm bëhet nga organet e qeverisjes vendore.

III. Pagesat

Dhënia e lejeve të tregtimit dhe të autorizimeve bëhet kundrejt pagesës nga subjekti kërkuar. Tarifat e pagesës për lejet dhe autorizimet, që jepen për herë të parë, janë:

1. për lejet e tregtimit të llojit "A" 500 000 lekë

2. për lejet e tregtimit të llojit "B" 200 000 lekë

3. për lejet e tregtimit të llojit "C" 200000 lekë

4. për autorizimet për stacione shitjeje karburanti, gazi të lëngshëm, vajrash lubrifikante dhe të stacioneve të mbushjes së bombolave të gazit të lëngshëm 100 000 lekë

5. për autorizime për njësitë e lëndëve djegëse 50000 lekë.

Tarifat për përsëritjen periodike të lejeve të tregtimeve dhe të autorizimeve janë sa gjysma e tarifave të mësipërme.

- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 nëPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj i ndryshuar kapitulli II, pikës 1 germës nëb ku cilësohet:

II. Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë

1.Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga:

b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njërive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.

9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante është 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për Bashkinë e Tiranës **dhe 2,000,000 (dy milionë) lekë, për bashkitë e tjera.**

- Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon: me VKM nr.344, dt. 19.4.2017.

"9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe **1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.**"

10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 1 000 000 (një milion) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe **200 000 (dyqind mijë) lekë, për bashkitë e tjera.**

- Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon: me VKM nr.344, dt. 19.4.2017.

"10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500 000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe **100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera.**"

"15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.

15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e licencuara dhe vendndodhjen e pikave të depozitimit apo të tregtimit, në mënyrë që këto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi."

-VKM nr. 344, datë 19.04.2017, për disa ndryshime ne VKM nr. 970, pika 15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.

15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e licencuara dhe vendndodhjen e pikave të depozitimit apo të tregtimit, në mënyrë që këto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi."

Impakti: Dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Kuçovë, identifikuar si mungesë në arkëtimin e të ardhurave për realizimin e investimeve, në vlerën 8,900,000 lekë, shkaktuar nga aktiviteti i 11 subjekteve dhe mospagim të detyrimeve.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Kuçovë të marrë masa për arkëtimin e të ardhurave të munguara prej **8,900,000 lekë**, për subjektet që tregtojnë karburant me pakicë dhe që janë të pa pajisur me autorizim/licencë, për tregtimin e karburanteve kundrejt tarifës së përcaktuar në VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 ndryshuar me VKM Nr. 344 datë 19.04.2017.

Për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi:

1. Z. P.SH. me detyrë Drejtor i Shërbimit Publik dhe Transportit për periudhën objekt auditimi.
2. Z. E.SH. me detyrë Drejtor i Shërbimit Publik dhe Transportit për periudhën nga 01.10.2020.

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me qendrimin në AK nr.6 ku citohet se “u konstatua se 2 subjekte "Pirko" shpk" dhe "F.D." shpk janë paisur nga Bashkia me licencën për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, duke u rregjistruar me tarifen 100,000 lekë, ndërkohë që sipas VKM duhet të ishin rregjistruar me tarifen 1,000,000 lekë”, përfaqësues të subjektit paraqesin evidencat si :Licenca dhe Autorizime të dy subjekteve të cilat provojnë aktivitetin e tyre për tregtim vetëm të gazit të lengshëm për konsumatorët familjarë final.

- Lidhur me detyrimet e subjekteve për dhënien e licencave në tregtimin e gazolilit, benzinës dhe gazit të lengshëm, të përlogaritur në vlerën e 8,900,000 lekë, nuk qëndrojnë si detyrim i paarkëtuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Transportit referuar VKB dhe paketës fiskale fq 11 pika 7 të miratuar në Bashkinë Kuçovë shprehet se pagesa për dhënien e licencës do të kryhet në mënyrë përpjestimore: 1/5 e tarifës para marrjes së licencës dhe çdo fillim viti pasardhës nga 1/5 deri në realizim të tarifës së plotë.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Referuar ndryshimeve ligjore të VKM nr. 344, datë 19.04.2017, për disa ndryshime në VKM nr. 970/2015, grupi i punës shqyrtoi përmbajtjen e evidencave shitesë si dhe përputhshmërinë e tyre në frymën e ligjit dhe vlerëson se pretendimi i subjektit qëndron dhe do të merret në konsideratë.

- Gjatë shqyrtimit të VKB Kuçovë për periudhën e auditimit lidhur me miratimin e paketës fiskale, taksave dhe tarifave vendore, grupi i auditimit e gjen të bazuar në akte ligjore ndarjen përpjestimore të tarifës së licensimit të sipërpërmendur dhe gjykon të arsyeshëm pretendimin e subjektit duke e marrë në konsideratë.

5. Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2018 dhe 2019, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, të bashkisë.

Nga auditimi i raportimit financiar, u konstatuan problematikat të cilat po i shprehim nëpërmjet gjetjeve si vijon:

► Titulli i gjetjes nr. 1: Mbi kontabilizimin e Aktiveve aftagjata materiale, pa titull pronësie.

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se, nga objektet inventari të pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 819,522,655 lekë, objektet nuk janë pajisur me titull pronësie, konkretisht sipas llogarive paraqiten si më poshtë:

-llog. 211 nëPyje plantacione, paraqiten në vlerën 0 lekë, ku në fakt janë 412 njësi të transferuara sipas VKM nr. 433 datë 08.06.2016 nëPër transferimin e në pronësi të pyjeve dhe kullotave.

-llog. 212 nëNdërtesa e konstruksione, 54 objekte me kosto historike 307,983,562 lekë.

-llog. 213 nëRrugë, rrjete, vepra ujore, 20 objekte në vlerën 517,753,292 lekë.

Për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve aftagjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor). Pavarësisht evidentimit të tyre në inventarin e aktiveve, dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë.

Kriteri: VKM nr. 510, datë 10.06.2015 nëpër inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme, Kreu VI në Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme, ku cilësohet:

“1. Bashkia është subjekti juridik që trashëgon të drejtat e pronësisë, të luajtshme dhe të paluajtshme të Njësive që Shkrihen (NJSH). Nga momenti i konstituimit të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive ajo ushtron të drejtën e pronësisë si dhe të drejta të tjera sipas mënyrës të përcaktuar me ligj.

2. NJSH-të duhet të plotësojnë dhe depozitojnë pranë bashkisë inventarin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi. Për pronat e paluajtshme inventari duhet të përmbajë edhe informacionin për fazën e regjistrimit në të cilën ndodhen”.

Impakti: Mungesa e titullit të pronësisë:

- Është pengesë për kryerjen e transaksioneve të ndryshme me pasuritë e paluajtshme;
- Është pengesë për menaxhimin e risqeve dhe mbrojtjen ndaj tyre, pasi mungesa e titullit të pronësisë pengon sigurimin e tyre.
- Ka sjellë që kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare të kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë. Titull i cili vërteton pronësisë dhe ushtrimin e të drejtave mbi një pasuri të paluajtshme.

Shkaku: -Nga ballafaqimi i problematikës, gjatë auditimit në terren, ka rezultuar se shkaqe të kësaj gjendjeje edhe pas 5 vitesh nga kryerja e këtij procesi janë:

- dokumentacioni i paplotë i trashëguar nga ish-Komunat;
- vështirësia e hasur në plotësimin e dosjeve sipas kërkesave të akteve ligjore e nënligjore për regjistrimin e titujve të pronësisë;
- kostoja e kryerjes së këtyre veprimeve në ZRPP, e cila është e konsiderueshme referuar numrit të objekteve të cilët duhet të regjistrohen.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Bashkia Kuçovë duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlloraritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi Drejtore e Financës dhe Buxhetit Znj. H.SH..

► **Titulli i gjetjes nr. 2: Mbi kontabilizimin e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.**

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit shoqërues në urdhër shpenzimet në ditarët e bankës, u verifikua se sipas kontratës së lidhur ndërmjet AK dhe në BSHPK për investimin me objekt në Rikualifikim urban i lagjes 1 Majë nënshkruar në datën 16.01.2019 me nr. 149, për vlerën 105,619,032 lekë, edhe pse janë bërë punimet dhe janë paraqitur faturat pranë AK Bashkia Kuçovë në mënyrë analitike si më poshtë;

Nr	Emri i Furnitorit	Nr.Fat.	Dt. fature	Sh.Totale	G.Punimi	Sh.Operatori	Nr.U.Shp	dt. Likui
1	Besta shpk	46396177	11.04.2019	28,084,440	1,404,222	26,680,218	297	30.03.2020
2	Besta shpk	46396177	30.06.2019	43,196,880	2,159,844	41,037,036	989	26.10.2020
3	Besta shpk	46396193	06.12.2019	34,337,712	1,716,886	32,620,826	1,033	13.11.2020

dhe është marrë në dorëzim aseti nëpërmjet aktit të marrjes në dorëzim në datën 10.12.2019, ky aset nuk është kontabilizuar. Kjo ka bërë të mundur nënvlerësimin e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” me 105,619,032 lekë.

Kriteri: - Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”* udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*.

Impakti: Paraqitja e aktivit 213 *“Rrugë, rrjete, vepra ujore”* në vlerën 105,619,032 lekë më pak në vitin 2019 sjell pasqyrim jo të saktë të AQT-ve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

Shkak: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit si dhe parimeve kontabël mbi pjesën e hyrjes së aktivit në njësi.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë, Drejtoria e financës dhe Buxhetit, të bëhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë 213 *“Rrugë, rrjete, vepra ujore”* për shumën 105,619,032 lekë për vitin 2019, me mbylljen e bilancit kontabël të vitit të ardhshëm, nëse kjo vlerë vazhdon të jetë e pa kapitalizuar edhe gjatë këtij vitit ushtrimor.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi Drejtore e Financës dhe Buxhetit znj. H.SH..

Pretendimi i subjektit të audituar mbi observacionin e shprehur për Projekt raportin e auditimit.

Në pikën 2.1 të akt konstatimit thuhet: është bërë nënvlerësimi i llogarisë 213 *“Rrugë, rrjete, vepra ujore”* në vlerën 105,619,032 lekë.

Për këtë pikë ju sqarojmë se: vlera 105,619,032 lekë e cila i përket *“Rrugë, rrjete, vepra ujore”* në llogarinë 231 në Aktivë afatgjatë materiale dhe vlera 95,315,032 lekë është pasqyruar në seksionin 486 *“Shpenzime të periudhave të ardhshme”* të llogarinë 486.

Fatura nr. 46396177, datë 11.04.2019 me vlerë 28,084,440 lekë është likuiduar pjesërisht sipas urdhër pagesave nr. 297, dt. 30.03.2020 likuidimi në vlerën 1,930,000 lekë, nr. 989, datë 26.10.2020 likuidimi në vlerën 4,374,700 lekë dhe nr. 1033, datë 13.11.2020 likuidimi është në vlerën 4,000,000 lekë.

Duke qenë se ky investim është në proces likuidimi, pjesa e likuiduar (10,304,700 lekë) është pasqyruar në seksionin e investimeve, në llogarinë 231 në Aktivë afatgjatë materiale dhe vlera 95,315,032 lekë është pasqyruar në seksionin 486 *“Shpenzime të periudhave të ardhshme”* të llogarinë 486.

Oëndrimi i Grupit të Auditimit

Në akt konstatim nuk flitet në asnjë moment për likuidime, por për pranimin e faturave nga ana e Bashkisë Kuçovë si dhe aktin e marrjes në dorëzim të asetit. Këto pika janë të mjaftueshme për të njohur në kontabilitet vlerën prej 105,619,032 si dhe në kundërparti njohja e detyrimit për faturat e palikujduara. Për rrjedhojë objeksioni juaj nuk merret parasysh.

► Titulli i gjetjes nr. 3: Mbi kontabilizimin e llogarisë 215 “Mjete Transporti”.

Situata: Llogaria 215 *“Mjete transporti”*, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Kuçovë, në fund të vitit 2018 rezulton për vlerën historike prej 21,355,928 lekë dhe në fund të vitit 2019 për vlerën historike prej 18,217,928 lekë ose me uljen në vlerën neto 3,138,000 lekë. Kjo ulje ka ardhur si rezultat i transferimit të dy makinave Automjet Benz nga Bashkia Kuçovë në kontabilitetin e Ndërmarrjes Komunale, e cila do të zotëroj asetet në vitin 2020 e në vazhdim.

Nga auditimi mbi administrimin e dokumentimi llogaria 215 "Mjete transporti" konstatohet se, 2 automjete transporti dhe 1 eskavator me zinxhirë në vlerë historike totale prej **13.639.196 lekë** janë administruar gabimisht në llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" të trashëguara dhe të mbartura nga periudha raportuese paraardhëse 2017

Kriteri: - Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Impakti: Keq klasifikimi i vlerës kontabël të automjeteve nga llogaria 215 "Mjete transporti" në llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" sjell pasqyrim jo të saktë të AQT-ve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, gjithashtu dhe amortizim me norma të ndryshme të përqindjes së amortizimit.

Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit si dhe parimeve kontabël mbi pjesën e hyrjes së aktivitetit në njësi

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë, Drejtoria e financës dhe Buxhetit, të bëhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë 215 "Mjete transporti" dhe llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" për vlerën **13.639.196 lekë** për vitin 2019, me mbylljen e bilancit kontabël të vitit të ardhshëm.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

- Zj. H.SH. në cilësinë e Drejtore e Financës dhe Buxhetit.

► **Titulli i gjetjes nr. 4: Mbi kontabilizimin e llogarisë 26 "Aktivet Afatgjata Financiare".**

Situata: Bashkia Kuçovë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100 % të aksioneve të Klubit të Futbollit Naftëtari, një Sh.A me NUIS nr.L27509102R0 e cila është shoqëri aksionere me objekt "Organizimi i aktiviteteve sportive në fushën e futbollit... Aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatën Shqiptare të Futbollit dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve të futbollit kombëtar dhe ndërkombëtarë. Numri i aksioneve është 3,500 me vlerë nominale 1000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 3.500.000 lekë.

Kjo vlerë e kapitalit me 100 % aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Kuçovë në "KF Nò Sh.A. në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2019, më konkretisht në llogarinë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar" me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale" pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 "Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje".

Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) 3,500,000 lekë dhe investitori është Bashkia Kuçovë.

Kjo procedurë mos pasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël **3,500,000 lekë** përbën shtrembërim të informacionit financiar.

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar" me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale" pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 "Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje".

Impakti: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2019 të llogarisë 26 në Pjesëmarrje në kapitalin e vetë, gjendje kjo e nën vlerësuar me 3,500,000 lekë.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 në Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, urdhrit nr. 64 datë 22.07.2014 në Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar, Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 në Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale dhe Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 28 në Investime në Pjesëmarrje.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të Klubit të Futbollit Naftëtari me vlerë kontabël 3,500,000 lekë në debi të llogarisë 26 në Pjesëmarrje në kapitalin e vetë dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen në kapitalin e vetë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

- Zj. H.SH. në cilësinë e Drejtore e Financës dhe Buxhetit.

► **Titulli i gjetjes nr. 5: Mbi kontabilizimin e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”.**

Situata: Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara, vendime Gjyqësore dhe shërbime të cilat nuk bëhen hyrje dhe për vitin 2019 paraqiten në shumën 38,884,831 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2019 paraqitet si më poshtë:

Lëvizjet e llogarisë	
Gjendja në 01.01.2019	91,387,452
Shtesa gjatë vitit 2019 (D)	23,908,032
Pakësime gjatë vitit 2019 (K)	76,410,653
Gjendja në 31.12.2019	38,884,831

Siç shihet edhe nga tabela llogaria 467 paraqitet në vlerën **38,884,831** lekë e përbërë nga:

- shpenzime të kryera por të pafinacuara për mallra shërbime dhe detyrime ndaj të tretëve në masën 32,834,271 lekë.

Shpenzimet për vendime gjyqësore në shumën 6,050,560 lekë.

Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Kuçovë nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likuiduara në 2020 por të paregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2019. Në mënyrë analitike këto fatura me kompetencë vitin 2019 dhe 2018 por të paregjistruara në dhe të likuiduara në 2020, paraqiten si më poshtë;

	Nr.Fat.	Dt. fature	Sh.Totale	G.Punimi	Sh.Operatori	Nr.U.Shp	dt. Likuid
Besta shpk	46396177	11.04.2019	28,084,440	1,404,222	26,680,218	297	30.03.2020
Besta shpk	46396177	30.06.2019	43,196,880	2,159,844	41,037,036	989	26.10.2020
Besta shpk	46396193	06.12.2019	34,337,712	1,716,886	32,620,826	1,033	13.11.2020
Ed konstruk	217	25.10.2019	2,011,394	100,570	1,910,824	207	14.03.2020
Fled shpk	44	09.12.2019	2,594,000	129,700	2,464,300	404	29.04.2020
Fled shpk	44	09.12.2019	2,595,265	129,763	2,465,502	493	26.05.2020
Fled shpk	44	09.12.2019	497,200	24,860	472,340	596	19.06.2020
Fled shpk	44	09.12.2019	596,000	29,800	566,200	603	25.06.2020
Fled shpk	44	09.12.2019	1,698,239	84,912	566,200	704	23.07.2020
Dhjonis shpk	20	30.11.2018	2,851,602	142,580	2,709,022	201	26.02.2020
						658	13.07.2020
						1046	18.11.2020
						204	18.12.2021
Dhjonis shpk	22	28.12.2018	3,449,208	172,460	3,276,748	205	18.12.2021
						288	11.03.2021
	Totali		121,911,940	6,095,597	114,769,216		

Mosparaqitja e tyre në kontabilitet, edhe pse janë kompetencë e vitit ushtrimor 2018 dhe 2019, ka nënvlerësuar llogarinë 467 ñKreditorë të ndryshëm me **121,911,940 lekë**. Kjo procedurë mospasqyrimi në llogarinë 467 ñKreditorë të ndryshëm të detyrimeve për faturat e likuiduara në 2020 por me kompetencë vitin 2019 dhe 2018, përbën shtrembërim të informacionit financiar, duke qenë se detyrimet e prapambetura për vitin 2019 të përcjella në Ministrinë e Financave **janë nënvlerësuar me 121,911,940 lekë** dhe mban përgjegjësi Drejtoresha e Financës dhe Buxhetit zj. H.SH..

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; Ligji 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, urdhrit nr. 64 datë 22.07.2014 “ Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 “Kuatr i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”

Impakti: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2019 të llogarisë 467 ñKreditorë të ndryshëm, gjendje kjo e nën vlerësuar me 121,911,940 për vitin 2019 dhe 6,300,810 lekë për vitin 2018.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 9228 datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, urdhrit nr. 64 datë 22.07.2014 ñPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar, Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 1 ñKuatr i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, të bëhen sistemimet në kontabilitet të llogarisë 467 ñKreditorë të ndryshëm” e cila është nënvlerësuar me **121,911,940 për vitin 2019 dhe 6,300,810 lekë për vitin 2018.**

Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi Drejtore e Financës dhe Buxhetit znj. H.SH..

Pretendimi i subjektit të audituar mbi projekt raportin e auditimit.

Në faqet 19 e 20 të akt konstatimit citohet se: nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Kuçovë nga sistemi SIFQ, janë identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likuiduara në vitin 2020 por të paregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2019.

Në lidhje me këtë pikë, nga ana e Bashkisë Kuçovë dhe Dega e Thesarit Kuçovë, është mbajtur akt rakordim për datat e regjistrimit në SIFQ për faturat e cituara në faqet 19 e 20 të akt konstatimit, një kopje e të cilit gjendet bashkëlidhur. Të gjitha këto vlera janë pasqyruar në pozicionin financiar në zërin 486 “ shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe në zërin 434/2 “operacione me shtetin, të drejta, të cilat pasqyrohen në kredi të llogarive 401-408 “furnitorë e llogari të lidhura me to” dhe 467 “ kreditorë të ndryshëm”.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit

Bazuar në të dhënat e analitikëve të dorëzuar nga ana juaj për llogarinë 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to” si dhe llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, të cilët janë rakorduar dhe me totalin e Bilancit Kontabël të mbyllur në vitin 2018 dhe 2019, në asnjë rast të analitikëve të detyrimeve, këto fatura nuk janë paraqitur. Për rrjedhojë objeksioni juaj nuk merret parasysh.

► **Titulli i gjetjes nr. 6: Mbi inventarizimin e vitit 2018 dhe 2019.**

Situata: 1-Në momentin e fillimit të inventarizimit në objekt, anëtarët e komisionit të inventarizimit në asnjë rast nuk kanë përpiluar deklarata për konflikt të interesit me punonjësit me përgjegjësi materiale, ose që kanë në përdorim aktive dhe në rastet kur anëtar komisioni inventarizimi është përfshirë drejtuesi i njësive që inventarizohet njëkohësisht edhe përgjegjës material.

2-Komisioni inventarizimit në fillim të procesit të inventarizimit, nuk ka në dispozicion listën e aktiveve për t’u inventarizuar e hartuar nga nëpunësi zbatues mbi bazën e të dhënave të pasqyruara nga regjistrat kontabël për secilën llogari kontabile të njësive publike vendore.

3-Komisioni inventarizimit fizik në fillim të procesit, në asnjë rast nuk ka hartuar akt akordim për të përcaktuar e fiksuar numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes së fundit e kontabilizuar.

4-Komisioni inventarizimit fizik në ato objekte ku është kryer procesi inventarizimi si; (Bashkia; Nj.Ad. Perondi; Nj.Ad. Lumas; Nj.Ad. Kozare; Sektori Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtim; Qendra Kulturore),megjithëse në flet inventarë ka pasqyruar dhe evidentuar në lidhje me gjendjen cilësore të artikujve me shënime; (të prishura; jashtë përdorimi, jashtë funksioni, ose dëmtuar), në përfundim të procesit komisioni nuk ka bërë vlerësim mbi gjendjen cilësore dhe evidentim të secilit artikull si dhe raport për ato aktive që janë vlerësuar gjatë procesit me evidentim (jashtë përdorimi) me qëllim për tu nxjerrë jashtë përdorimi dhe më pas të ndiqej procedurat e asgjësimit të tyre.

5-Në përfundim të procesit të inventarizimit fizik të aktiveve, komisioni megjithëse nuk ka përpiluar përmbledhëse bashkëlidhur së cilës janë fletë inventarë me gjendjen fizike të aktiveve sipas llogarive me analizë në objektet e inventarizuara gjendje në datë 31.12.2018 në përfundim nga auditimi u konstatua se;

a-në asnjë çast komisioni inventarizimit fizik nuk ka nxjerr rezultat me diferenca që kanë rezultuar në procesin e inventarizimit fizik për vlerat e aktiveve, aseteve, pasurisë dhe vlerave materiale, megjithëse në objektin e inventarizuar Njësia administrative Perondi nga inventarizimi fizik kanë rezultuar gjendje në mungesë me 213 artikuj libra ne vlerë 350.150 leke, si dhe gjendje ne tepricë me 6 artikuj ne vlerë 10.620 leke. Këto diferenca në (mungesë dhe tepricë) të rezultuara gjatë procesit të inventarizimit fizik në periudhën ushtrimore raportuese 2019, komisioni në përfundim të procesit nuk i ka analizuar dhe sistemuar me

kontabilizim në llogarinë 468 "Debitor të ndryshëm" në ngarkim të personit material përgjegjës si dhe shkarkimi vlerës së 213 artikujve nga kontabiliteti, ndërsa tepricat me kontabilizim hyrje të vlerës për 6 artikujt me shtesë në kontabilitet. Këto diferenca të konstatuara janë të mbartura nga inventarizimi fizik i kryer në periudhën ushtrimore raportuese 2018 të pa sistemuar nga kjo periudhe në mënyrë të përmbledhur diferencat paraqiten sa më poshtë.

Tabela nr. 1. Diferenca të rezultuara në Llogarinë (327)

<i>Nr.</i>	<i>Emërtim</i>	<i>Sasia</i>	<i>Vlera në mungesë</i>	<i>Vlera tepricë</i>	<i>Llogaria shënime</i>
1	Artikuj libra	213	350,150	-	327
2	Artikuj libra	6	-	10,620	327
	<i>Totali</i>	219	350,150	10,620	

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga fletë inventarë fizik

b-në përfundim të procesit të inventarizimit fizik, megjithëse në disa fletë inventarizimi është evidentuar gjendja cilësore e artikujve me shënimin (jashtë përdorimit, apo të dëmtuar), ndërsa në asnjë rast në objektin e inventarizuar nuk është bërë vlerësimi cilësor i artikujve për të nxjerr jashtë përdorimit.

c-në 8 raste në flete inventarë fizik rezulton se, ato nuk janë të nënshkruara veçanërisht nga punonjësi me përgjegjësi materiale, ku në disa flete ka korrigjime të ndryshme, apo shënime në fletë inventar të pa evidentuara me përmbledhëse, veprime në mospërputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin e pasqyrat financiare", pika 1, neni 7 "Inventari i aktiveve e detyrimeve"; ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar e kontrollin" i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësite e sektorit publik", Kreu (IV) "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi i aktiveve", pika 85 "Përgjegjësisë e komisionit të inventarizimit fizik"; pika 86, ku qartësisht përcaktohet se; "Personat e ngarkuar për kryerjen e inventarizimeve mbajnë sipas rastit përgjegjësi disiplinore, materiale a penale për moskryerjen me saktësi të inventarit".

6-Komisioni inventarizimit ka paraqitur fletë inventarë me gjendje fizike e krahasuar kjo me gjendjen kontabile (vlera historike) në objektet e inventarizuara sipas llogarive kontabile të evidentuara në përmbledhëse me rezultate të evidentuara edhe në pasqyrat financiare (bilanci kontabël) për periudhën raportuese e mbyllur në datë 31.12.2019 për 9 llogari me analizë për secilin AAGJM dhe AAGJJM dhe qarkullues sa më poshtë;

Bashkia Kuçovë												
Përmbledhja e gjendje fizike, vlera historike e inventarit të AAMM dhe Qarkullues gjendje date 31.12.2018)												
Nr	Objekti Inventarizua	Inventar Qarkullues			AAGJM		Aktive Afatgjatë Materiale					
		31	32	202	210	211	212	213	214	215	218	
1	BASHKIA		3,955,023						14,645,696	13,567,927	17,236,920	
2	NJA PERONDI		1,596,138						261,420	160,000	3,442,325	
3	NJA LUMAS		154,811						0		1,469,280	
4	NJA KOZARE		361,564						280,370		2,085,813	
5	Sektori I MNZ		2,177,572						1,525,564	2,400,000	244,500	
Gjendje fizike inventar		0	8,245,108	s'ka	s'ka		s'ka	s'ka	16,713,050	16,127,927	24,478,838	
Gjendja kontabile inventari		0	8,585,068	22,126,200	351,104		222,003,791	514,037,631	17,161,609	21,355,928	24,492,716	
Rezultati (Plus/Minus)			-339,960						-448,559	-5,228,001	-13,878	
Amortizimi vjetor				3,318,930			9,678,364	20,040,156	2,001,875	2,326,815	3,267,329	
Amortizimi akumuluar				8,225,910			36,954,587	35,512,947	5,819,283	18,431,636	11,575,278	
Gjendja inventari neto date			8,585,068	13,900,290	351,104		185,049,204	478,524,684	11,342,326	2,924,292	12,917,438	

Të dhënat në tabelë evidentojnë, diferencat në administrimin e aktiveve, ndërmjet gjendjes fizike të inventarit dhe gjendjes kontabile vlera historike e deklaruar në pasqyrat financiare, me diferenca në (mungese) në gjendjen fizike sipas flete inventarit ku; llog.(214) shuma 448.559 leke; llog (215) shuma 5,228,001 lekë; lloga (218) shuma 13,878 lekë llog.(32) shuma 339.960 leke. Komisioni inventarizimit në përfundim të procesit në asnjë rast nuk ka sistemuar asnjë diferencë në mungesë të rezultuara ndërmjet gjendjes fizike e gjendjes kontabile (vlera historike) të evidentuara në pasqyrat financiare.

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; Ligji nr.9367, date 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 81, 82, 83, 85(a) dhe (c), 86 dhe 95.

Impakti: Diferencat e gjendjes kontabël nga gjendja fizike çon në deformim i informacionit financiar për sa i përket Pasqyrave të Pozicionit Financiar për vitin 2019.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit nr.9367, date 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga Bashkia Kuçovë, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, të bëhen sistemimet në kontabilitet të diferencave në llogaritë 214 në Instalime teknike, makineri e pajisje për vlerën 448,559 lekë, 215 në Mjete Transporti për vlerën 5,228,001 lekë dhe 218 në Inventar ekonomik për vlerën 13,878 lekë. Të merren masa që procedura e inventarizimit të ndiqet sipas çdo hapi të përcaktuar në udhëzimin nr.30 për të cilat ka pasur problematika sipas 6 pikave të mësipërme.

Pretendimi i subjektit të audituar.

Nëpërmjet observacionit me nr.prot 98/4 datë 22.04.2021 janë paraqitur pretendimet për secilën nga 7 pikat e pjesës së inventarizimit të vitit 2018 dhe 2019. Dokumentacion mbështetës janë paraqitur vetëm për pikën 4

Qëndrimi i Grupit të Auditimit

Grupi i auditimit ka marrë në konsideratë dokumentacionin (relacion) e paraqitur për pikën 4. Pjesa tjetër nuk është marrë në konsideratë pasi nuk mbështetet në fakte dhe prova që të mund të vërtetojnë pretendimet e subjektit.

6. Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjensisë së Prokurimit Publik nr. 2, datë 24.04.2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”.

6.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendim të KB, pasqyra aneks 4/1, 4/2, 4/3 bashkëlidhur Raporti Përfundimtar të Auditimit.

6.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operojnë në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si vijon*:

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Kuçovë (*regjistrat e parashikimit dhe realizimit*), për periudhën 01.01.2018 i 31.12.2020, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Procedura 01/01/2018 - 31/12/2020	Nr.	VI. Fond Limit	VI. Kontrate
GJITHESEJ	23	626,826,153	576,678,877
-Të hapura	14	588,097,966	538,868,609
- Kërkesë me propozim	5	27,141,503	26,280,195
-Negocim pa shpallje	3	11,586,684	11,530,073
Sipas objekteve	23	626,826,153	576,678,877
-Objekte në fushën e investimeve	15	438,841,098	420,335,958
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	8	187,985,055	156,342,919

Burimi: Hartuar nga grupi i KLSH, sipas të dhënave të regjistrave të subjektit Bashkia Kuçovë

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.01.2018 i 31.12.2020, janë realizuar gjithsej **23** procedura me fond limit 626,826 mijë lekë dhe vlerë kontrate 576,678 mijë lekë, me një diferencë për vlerën 50,148 mijë lekë ose 8.8%, nga e cila: në **vitin 2018** janë realizuar gjithsej **12** procedura me fond limit 373,961 mijë lekë dhe vlerë kontrate 331,419 mijë lekë, për **vitin 2019** janë realizuar **4** procedura me fond limit 83,821 mijë lekë dhe vlerë kontrate 80,158 mijë lekë dhe për **vitin 2020** janë realizuar **7** procedura me fond limit 169,042 mijë lekë dhe vlerë kontrate 165,100 mijë lekë

Kanë marrë pjesë në procedura **89** OE/BOE dhe janë s kualifikuar **56** OE/BOE ose 62%.

Sipas llojit të aktivitetit, konstatohet se në fushën e ndërtimit (investime), janë **15** procedura me vlerë kontrate 420,335 mijë lekë ose 72% e kontratave të lidhura dhe në të tjera janë **8** procedura me vlerë kontrate 156,342 mijë lekë.

Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **4** procedura ose 17 % e procedurave të zhvilluara.

Mbi bazën e materialitetit dhe riskut të bërë nga Grupi i KLSH, nga **23** procedura me vlerë kontrate 692,013 mijë lekë janë vlerësuar për auditim **15** procedura me vlerë kontrate 655,652 mijë lekë ose 94.7%, ku shkeljet sipas procedurave dhe problematikave paraqitet si më poshtë vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 1:** KLSH-ja, konstatoj se në procedurat e zhvilluara për periudhën 01.01.2018 - 31.12.2020, janë konstatuar kritere jo në përputhje me procedurën dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST, të miratuar nga AK-ja.

Situata: Referuar të dhënave të regjistrimit të procedurave për periudhën 01.01.2018 i 31.12.2020, nga Bashkia Kuçovë janë realizuar gjithsej **23** procedura me fond limit 626,826 mijë lekë dhe vlerë kontrate 697,581 mijë lekë me TVSH, nga e cila: në **vitin 2018** janë realizuar gjithsej **12** procedura me fond limit 373,961 mijë lekë dhe vlerë kontrate 397,703 mijë lekë me TVSH, për **vitin 2019** janë realizuar **4** procedura me fond limit 83,821 mijë lekë dhe vlerë kontrate 96,190 mijë lekë me TVSH, dhe për **vitin 2020** janë realizuar **7** procedura me fond limit 169,042 mijë lekë dhe vlerë kontrate 197,688 mijë lekë me TVSH.

Grupi i KLSH-së, referuar vlerësimit të dhënave të materialitetit dhe riskut nga **23** procedura me vlerë kontrate 697,581 mijë lekë me TVSH, ka vlerësuar për auditim **15** procedura ose 65% me vlerë kontrate 655,652 mijë lekë me TVSH ose 94% të vlerës së kontratave të lidhura, nga e cila: për **vitin 2018** nga **12** procedura me vlerë kontrate 397,703 mijë lekë janë audituar **8** procedura me vlerë kontrate 370,232 mijë lekë ose 93% e vlerës së kontratave, për **vitin 2019** nga **4** procedura me vlerë kontrate 96,190 mijë lekë janë audituar **2** procedura me vlerë kontrate 93,499 mijë lekë ose 97% e vlerës së kontratave dhe për **vitin 2020** nga **7** procedura me vlerë kontrate 197,688 mijë lekë janë audituar **5** procedura me vlerë kontrate 191,921 mijë lekë ose 97% e vlerës së kontratave.

Nga auditimi i **15** procedurave me vlerë kontrate 655,652 mijë lekë, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej **14** procedura, nga të cilat: në **12** procedura kriteret nuk janë në përputhje me llojin e procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në mospjesëmarrjen e OE në procedura, në **2** procedura OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në vlerën **358,448 mijë lekë** pa TVSH, veprime në kundërshtim me ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, *“Për prokurimin publik”,* i ndryshuar nenet 2, 20, 24, 46, 47, 53, 55, 58, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,* i ndryshuar, nenet 26, 27, 28, 61 konkretisht sipas periudhave:

a- Për aktivitetin e vitit 2018, nga auditimi i **8** procedurave me vlerë kontratë 370,232 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP, gjithsej **8** procedura me vlerë kontratë **370,232 mijë lekë ose 100 %** e vlerës së kontratave të audituara, ku në **6** raste kriteret e aplikuar nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në **5** raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Kuçovë, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, veprime në paligjshmëri të fondeve publike në vlerën **180,156 mijë lekë pa TVSH.**

b- Për aktivitetin e vitit 2019, nga auditimi i **2** procedurave me vlerë kontratë 93,499 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP, gjithsej **2** procedura me vlerë kontratë **93,499 mijë lekë ose 100 %** e vlerës së kontratave të audituara, ku në **2** raste kriteret e aplikuar nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në **1** rast OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Kuçovë, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, veprime në paligjshmëri të fondeve publike në vlerën **62,150 mijë lekë pa TVSH.**

c- Për aktivitetin e vitit 2020, nga auditimi i **5** procedurave me vlerë kontratë 191,921 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP, gjithsej **4** procedura me vlerë kontratë **170,858 mijë lekë ose 89 %** e vlerës së kontratave të audituara, ku në **4** raste kriteret e aplikuar nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës,

veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në **3** raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Kuçovë, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, veprime në paligjshmëri të fondeve publike në vlerën **116,141 mijë lekë pa TVSH**.

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, *ËPër prokurimin publik*, i ndryshuar, neni 2, neni 20, neni 24, neni 46 dhe neni 53; VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *ËPër miratimin e rregullave të prokurimit publik*, i ndryshuar, nenet: Neni 26, pika 5, *ËKontratat për punë publike*, Neni 27, pika 3, *ËKontratat e mallrave*, Neni 28, pika 2, *ËKontratat e shërbimeve*, neni 61, pika 2, neni 74, pika 3.

Shkak: Mos vlerësimi i drejtë i kriterëve dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar dhe aplikimi i kriterëve të rënduara të cilat çojnë direkt ose indirekt në mospjesëmarrjen e OE.

Ndikimi/Efekti: Aplikimi i kriterëve jo në mënyrë të argumentuar dhe në përputhje me procedurën, si dhe shpallja fitues e OE me mangësi në plotësimin e kriterëve të DST, janë veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve për vlerën **358,448 mijë lekë**, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: anëtarët e NJHDT, KShA, sipas procedurave ku ato janë pjesëmarrës, ku rast pas rasti do trajtohen më poshtë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa që në komisionet e NJHDT dhe KVO, të emërojë persona me profil sipas llojit të procedurës, të cilët në hartimin e kriterëve të aplikohen kriteret të cilat i përshtaten procedurës së zhvilluar, ndërsa në shpalljen fitues të OE të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke mos lejuar veprime me dy standarde në klasifikimin e tyre dhe të udhëhiqen nga kriteri kryesor *ËÇmimi më i leverdishëm*, midis OE pjesëmarrës, kjo për të bërë të mundur përdorimin më me ekonomikitet të fondeve të prokuruar për vlerën **358,448 mijë lekë**.

Procedurat e periudhës 01.01.2018 – 31.12.2018

-Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetore.

Për periudhën 01/01/2018 i 31/12/2018, nga Bashkia Kuçovë referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej **12** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 373,961 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 331,419 mijë lekë, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 42,542 mijë lekë ose 11 %. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrë si vijon:

Procedura 01/01/2019 - 31/12/2020	Nr.	VI.Fond Limit	VI.Kontrate
GJITHESEJ	12	373,961,785	331,419,473
-Të hapura	7	342,841,980	300,657,290
- Kërkesë me propozim	3	20,826,745	20,524,092
-Negocim pa shpallje	2	10,293,060	10,238,091
-Objekte në fushën e investimeve	7	212,033,159	200,861,405
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	5	161,928,626	130,558,068

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **39** OE/BOE, nga të cilat janë s kualifikuar **23** OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **3** procedura ose 25 % e procedurave të zhvilluara.

-Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut, grupi i auditimit nga **12** procedura prokurimi të zhvilluara me vlerë kontrate 397,703 mijë lekë pa tvsh, u vlerësua për auditimin e **8** procedurave me vlerë kontrate 370,232 mijë lekë ose 93 % e vlerës së kontratave të lidhura.

-Nga auditimi i **8** procedurave me vlerë kontrate 370,232 mijë lekë, u konstatua se janë në shkelje të akteve ligjore/ nënligjorë të LPP, gjithsej **8** procedura me vlerë kontrate **370,232 mijë lekë ose 100 %** e vlerës së kontratave të lidhura, ku në **6** raste kriteret e aplikuar nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në **5** raste OE i shpallur fitues nuk

është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Kuçovë, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, veprime në paligjshmëri të fondeve publike në vlerën **180,156 mijë lekë** pa TVSH, veprime në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 nëPër prokurimin publikò, i ndryshuar dhe VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,ò për miratimin e rregullave të prokurimit publikò, të ndryshuar, **për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJHDT dhe KVO sipas procedurave, si më poshtë vijon:**

I. Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë së tenderit me objekt:
ñRikonstruksioni i ish-godinës së riparimit të mjeteve të rënda dhe e magazinës së rikuperove pranë parkut të naftësò, rezultoi problematika e shprehur me gjetjen si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 2:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **2.2** e cila kërkon certifikatë të gjendjes financiare nga një ose më shumë banka në një vlerë jo më të vogël se **10% e fondit limit**, është kërkesë e pa mbështetur në asnjë akt ligjor.

2.Kërkesa e pikës **6** e cila kërkon *ñKandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin/(t) Teknik të punimeve në objekt se ai/ata do të jetë/jenë i/ të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt”,* është kërkesë në kundërshtim me UKM nr. 2 , datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. nëPër zbatimin e punimeve të ndërtimitò, i cili përcakton se *Për vlera me vlerë të plotë të preventivuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.* Ky tender ka fond limit **21,792,283 lekë** ose **8,207,717 lekë** më e ulët se vlera e kërkuar për të deklaruar drejtuesin teknik se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera.

3.Kërkesa e pikës **8** e cila kërkon nga OE të disponojnë 15 punonjës me IQT, është kërkesë e paplotë, e cila nuk përcakton llojin e specialistëve të nevojshëm, por mjaftohet vetëm me kërkesën e disponimit të IQT.

Vlerësimi i Kriterëve: 1.OE nuk përmbush kriterin për dokumentacionin e disa prej mjeteve të kërkuar në NJP në DST. Autobetonieret e deklaruar nga OE ñAò SHPK me targa AA068HS dhe AA069HS, të marra me kontratë qiraje, nuk kanë certifikatën e transportit të lëshuar **për të tretë dhe me qira**. Autobetonieret e deklaruar nga OE ñBò SHPK, me targa TR3707L dhe TR9342M, të marra me kontratë qiraje nuk kanë certifikatën e transportit të lëshuar **për të tretë dhe me qira**. Autopompa e betonit e deklaruar nga OE ñAò SHPK, me targë AA306HS, e marrë me kontratë qiraje, nuk ka certifikatën e transportit të lëshuar **për të tretë dhe me qira**. Kamionët e deklaruar nga OE ñAò SHPK, me targa AA258EV, VL5873C të marrë me kontratë qiraje, nuk kanë certifikatën e transportit të lëshuar **për të tretë dhe me qira**. Autovinçi i deklaruar nga OE ñAò SHPK, me targë VL1026C, i marrë me kontratë qiraje, nuk ka certifikatën e transportit të lëshuar **për të tretë dhe me qira**. Kamionët e deklaruar nga OE ñBò SHPK, me targa AA872KR, AA216HR dhe AA490PI, të marrë me kontratë qiraje, nuk kanë certifikatën e transportit të lëshuar **për të tretë dhe me qira**.

Mungesa e certifikatës për të tretë dhe me qira për mjetet, është në kundërshtim me nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 nëPër transportet rrugoreò i ndryshuar i cili përcakton se *ñTransporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse”.*

2. OE nuk përmbush kërkesën për *Impiant betoni me leje mjedisi III.1.B.* OE ka lidhur kontratë furnizimi me shoqërinë ñB. V.ò, por rezulton se kjo shoqëri nuk ka leje mjedisi

III.1.B, si dhe nuk ka paraqitur monitorimin e 6 muajve të fundit. Ndërsa kontrata e lidhur me shoqërinë ËJ. C., rezulton se linja nuk është për betone, por për asfalto të betone.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi:** anëtarët e NJP z. E. A. (Jurist), znj. S. G. dhe znj. A. E. (anëtar), si dhe anëtarët e KVO: z. F. P. (kryetar), z. Y.ZH. dhe z. J.L. (anëtar).

Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri në përzgjedhjen e operatorit ekonomik fitues.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP z. E. A., znj. A. E. dhe znj. S. G. është paraqitur observacioni me nr. 235/35 prot., datë 09.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 98/11, datë 12.07.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1.Në lidhje me kërkesën e pikës 2.2 e cila kërkon certifikatë të gjendjes financiare në një vlerë jo më të vogël se 10% e fondit limit, sqarohet se kjo kërkesë është në përputhje me pikën c të nenit 46 të LPP.

2.Në lidhje me pikën 3, për kërkesën e drejtuesit teknik të paangazhuar në kontrata të tjera, sqarohet se ky kriter është lehtësisht i plotësueshëm nga OE, dhe nuk rëndon pozitën e tyre në procedurën përkatëse. Vihet në çdo procedurë nga NJP dhe nuk ka për qëllim shkëlqen e ndonjë dispozite ligjore. Bëhet për të krijuar një panoramë të përgjithshme të aftësive organizative të ofertuesve.

3.Në lidhje me pikën 4, për kërkesën për 15 punonjës me IQT pa specifikuar llojin e specialistit, sqarohet se kjo nuk rëndon pozitën e OE të interesuar, por i lehtëson ata në përmbushjen e kriterin duke rritur konkurrencë.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 7 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO z. F. P., z. Y.ZH. dhe z. J.L. është paraqitur observacioni me nr. 235/37 prot., datë 16.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 98/14, datë 19.07.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Anëtarët e KVO sqarojnë se BOE "A" shpk dhe "B" shpk janë shpallur fitues me vendim të KPP. KVO ka shpallur fitues një operator tjetër, por pas ankimimit të këtij BOE, KPP ka vendosur pranimin e ankesës dhe shpalljen e tyre fitues.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, nuk pranohen. KVO, ka s kualifikuar fillimisht BOE për arsye të cilat nuk qëndrojnë, dhe pas ankimimit të BOE në KPP, është pranuar ankesa e tyre. KPP është shprehur për objektin e ankesës dhe nuk ka trajtuar të gjithë procedurën dhe dokumentacionin e operatorëve ankimues. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në SPE nga audituesit e KLSH, është konstatuar se ky BOE ka pasur mangësi të tjera të cilat duhet të ishin evidentuar nga KVO, dhe për këtë arsye duhej s kualifikuar. Në lidhje me gjetjet e KLSH, juve nuk keni paraqitur observacion.

II- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në tenderin me objekt: *ñRikonstruksioni i Rrugës “E. B.”, fshati Rreth Tapi, Njësia Administrative Perondiò,* rezultoi problematika e shprehur me gjetjen si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 3:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE.

Situata: Hartimi i kriterëve: Në lidhje me kriteret e vendosura, pranë AK janë paraqitur disa ankesa si më poshtë:

1.Në datën 17.11.2017, është protokolluar në Bashkinë Kuçovë me nr. 3702 ankesa e OE SH.-M, i cili ankohet për vendosjen e kriterëve të kualifikimit, konkretisht Licencat profesionale, pasi i konsideron të papërshtatshme, kërkesën për 150 punonjës, disponimin e 10 inxhinierëve si drejtues teknikë, duke pasur nga 2 për secilën fushë të aktivitetit, kërkesën për 13 manovratorë me polica sigurimi për ta, pajisjen e 40 punonjësve me dëshmi kualifikimi teknik, pajisjet dhe makineritë, fabrikë betoni me QKL, nyje përpunim guri me QKL, impiant inertesh me QKL, impiant për prodhim asfalti me QKL, linjë për prodhim elementesh betoni, pllaka, bordura me QKL, raportet e testimeve, etj.

Me vendimin nr. 71, datë 17.11.2017, titullari pezullon procedurën me qëllim shqyrtimin e ankesës.

Me urdhrin e brendshëm nr. 383, datë 17.11.2017, krijohet KShA, me përbërje P. K., E. P. dhe A. B..

2.Në datën 20.11.2017, është protokolluar në Bashkinë Kuçovë me nr. 3719 ankesa e OE S., i cili ankohet për vendosjen e kriterëve të kualifikimit, konkretisht për kërkesën e një inxhinieri ndërtimi, pjesë e stafit teknik, i cili të jetë i certifikuar për sigurinë në kantier, për disponimin në licencën e shoqërisë të 12 inxhinierëve, për ekspertin zjarrfikës me kontratë pune, për policat e sigurimit të manovratorëve dhe automakinistave, për rrul mbi 18 ton, për QKL të tipit C, me kod III.1.A, për raportet e testimit të materialeve, etj.

Në lidhje me trajtimin e ankesave të mësipërme, rezulton se KSHA, nuk ka mbajtur asnjë procesverbal për trajtimin e tyre, por ka hartuar një shkresë përcjellëse drejtuar titullarit të AK ku bën me dije se KSHA ka pranuar pjesërisht disa pika të ankesave të mësipërme. Mos trajtimi i ankesës është në kundërshtim me nenin 78 ñAnkesat në autoritetin kontraktor të VKM me nr. 914 datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar.

Me shkresën nr. 3702/1 prot., datë 21.11.2017 është njoftuar OE ñSH. Mò për vendimin e komisionit, sipas të cilit janë ndryshuar disa kriterë bazuar në ankesën e OE.

Në lidhje me vendimin e AK, OE ka bërë ankesë pranë KPP, e cila me vendimin nr. 772/2017, ka vendosur mos pranimin e ankesës pasi ajo është paraqitur jashtë afatit ligjor.

Me shkresën nr. 3719/1 prot., datë 22.11.2017 është njoftuar OE ñS.ò SHPK për vendimin e komisionit, sipas të cilit nuk pranohet ankesa e OE.

1.Kërkesa e pikës **2.2** e cila kërkon nga OE të dorëzojë ñxhiro mesatare vjetore gjatë tre viteve të fundit ushtrimorë ... duhet të jetë me vlerë mesatare jo më të vogël se vlera e fondit limitò. Kjo kërkesë është në kundërshtim me VKM-në nr. 914, neni 26, ñKontratat për punë publikeò, pika 7, germa b) ku përcaktohet se “vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 50 % të vlerës limit të kontratës që prokurohetò.

2.Kërkesa e pikës **7.1** për disa nga kategoritë e licencës është e paargumentuar dhe jo në përputhje me natyrën dhe volumet e punimeve.

a)kërkesa për kategorinë **NP-7B** (Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës etj), është e paargumentuar. Objekti i prokurimit është ndërtim rruge.

b)kërkesa për kategorinë NP-11B (ndërtim për nënstacione, kabina e transformatorëve etj), është e paargumentuar, pasi zërat elektrikë të punimeve sipas preventivit janë 3,136,818 lekë. Kategoria B e kërkuar është për punime me vlerë mbi 20 milion lekë.

c)kërkesa për kategorinë NS-5B (impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut), është kërkesë e paargumentuar, pasi nuk ka zëra në preventiv për kategorinë e mësipërme.

d)kërkesa për kategorinë NS-6B (sinjalistikë rrugore jo ndriçuese), është kërkesë e ekzagjeruar dhe jo në raport me vlerën e punimeve. Nuk kemi sinjalistikë vlere e së cilës kalon shumë e 20 milion lekë, ndërkohë që vlere e gjithë investimin është 30 milion lekë.

e)kërkesa për kategorinë NS-7B (barriera dhe mbrojtje rrugore), është kërkesë e ekzagjeruar dhe jo në raport me vlerën e punimeve. Nuk kemi zëra për këto punime vlere e së cilave kalon shumë e 20 milion lekë, ndërkohë që vlere e gjithë investimin është 30 milion lekë.

f)kërkesa për kategorinë NS-8B (ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri), është e paargumentuar pasi nuk ka asnjë zë punimesh për këtë kategori.

g)kërkesa për kategorinë NS-19B (sistemet kundër zhurmës për infrastrukturën) është kërkesë e ekzagjeruar, pasi zërat në preventiv janë minimalist, ndërkohë që kategoria B kërkohet për punime me vlerë mbi 20 milion.

3.Kërkesa e pikës 9 e DST e cila kërkon mesatarisht staf prej 135 punonjësish për periudhën Janar 2017 i Shtator 2017, është kërkesë e paargumentuar dhe kufizuese. Kërkesa të tilla përbëjnë shkak për pjesëmarrje të ulët të OE.

4.Kërkesa e pikës 10 e DST, e cila kërkon 15 inxhinierë, është e paargumentuar. Kërkesat për 2 inxhinier mjedisi, 2 hidroteknik, 2 topograf, 2 gjeolog, 1 arkitekt dhe 1 inxhinier pyjesh janë të ekzagjeruara dhe përbëjnë shkak për kufizimin e OE në këtë tender. Nuk ka punime për disa nga inxhinierët e mësipërm, dhe në rastet kur ka, janë zëra me vlerë minimale.

5.Kërkesa e pikës 10 e DST, e cila kërkon *Police sigurimi personale për manovratorët dhe automakinistët*, është kërkesë e paargumentuar, dhe nuk gjen bazueshmëri në asnjë akt ligjor.

6.Kërkesa e pikës 10 e cila kërkon *1 mjek me licencë*, dhe në rast bashkimi operatorësh secili anëtar duhet të ketë mjekun, është kërkesë e paargumentuar dhe kufizuese e cila nuk i shërben AK. Kjo kërkesë është në kundërshtim me 74, pika 3 të VKM-së me nr. 914 nëPër miratimin e rregullave të prokurimit publik të ndryshuar, i cili përcakton se *.....Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

7.Kërkesa e pikës 9.2 e DST e cila kërkon nga OE të kenë minimalisht 40 punonjës me IQT, nga të cilët 2 ing.ndërtimi dhe 1 ing.mekanik, është kërkesë e ekzagjeruar, dhe nuk argumentohet nga AK. Së pari numri 40 punonjës me IQT është relativisht i lartë, si dhe AK nuk përcakton profesionet e kërkuara për këta punonjës, por mjaftohet vetëm me dëshminë e IQT.

8.Kërkesa e pikës 3 e cila kërkon nga OE *fabrika/impiante (sipas tabelës më poshtë)* së pari janë kërkesa të ekzagjeruara në raport me volumin e punimeve. Kërkesa për 5 fabrika apo impiante prodhimi betoni, asfalti apo inertesh, në një investim prej 30 milion lekësh, nuk përbën gjë tjetër veçse kërkesë kufizuese për OE për të paraqitur ofertat e tyre. Gjithashtu, kërkesa që këto fabrika/impiante të sigurohet vetëm me pronësi ose me qira, përbën një kufizim tjetër për OE, pasi kjo mund të sigurohej nëpërmjet kontratave të furnizimit, gjë e cila nuk është parashikuar nga NJP në DST. Vlen të theksohet edhe fakti, që në procedura tjera të prokuruar pranë këtij AK, me vlere 3 herë më të larta dhe volume punë po kaq të mëdha, AK nuk ka kërkuar nga OE disponibilitetin e fabrikës/implantit/nyje etj. (Në procedurën “Rikualifikim i lagjes 1 Maji” me vlerë 90,747,672 është kërkuar vetëm fabrikë asfalti dhe betoni, të cilat mund të sigurohen edhe me kontratë furnizimi).

Fabrikë Betoni me QKL	1 cope	Pronësi ose me qira
Nyje përpunim guri me QKL	1 cope	Pronësi ose me qira

Impiant Inertesh me QKL	1 cope	Pronësi ose me qira
Impiant prodhim Asfalti me QKL	1 cope	Pronësi ose me qira
Linje prodhimi elemente Betoni, Pllaka Bordura me QKL	1 cope	Pronësi ose me qira

Vlerësimi i Kritereve: 1.OE ñFò SHPK, nuk përmbush kërkesat e pikës **7.1** për kategoritë e licencës së shoqërisë. Nuk ka disponon kategoritë **NP-5B, NP-11B, NS-5B, NS-6B, NS-7B, NS-8B, NS-18B dhe NS-19B**. Ky OE disponon vetëm kategorinë **A**.

2.BOE, nuk përmbush sipas kërkesës së DST për pikën **10** e cila kërkon nga OE

Ing.ndërtimi (2), Ing.mjedisi (2), ing.hidroteknik (2), ing.topograf (2), ing.elektrik (1), ing.gjeolog (2), ing.mekanik (1), arkitekt (1) ing.pyjesh (1).

Sa më sipër, të gjithë inxhinierët e deklaruar nga OE ñSh-07ò SHPK, nuk kanë paraqitur librezën e punës, sipas kërkesës së NJP. Për inxhinierin gjeolog Viktor Loci, krahas librezës së punës, nuk është paraqitur kontrata e punës dhe diploma. Për këtë inxhinier, është paraqitur vërtetim nga Universiteti Politeknik se ka mbaruar universitetin dhe ka marrë diplomën për gjeolog, por në DST kërkohet në mënyrë eksplicite paraqitja e diplomës.

Në lidhje me inxhinierët e deklaruar nga OE ñFò SHPK, rezulton se ka mangësi në dokumentacion për ing. topograf A. K., për të cilin s'ka paraqitur librezën e punës, si dhe për ing.hidroteknik Dashamir Peqini, për të cilin s'ka paraqitur librezën e punës dhe diplomën. Për këtë inxhinier, është paraqitur vërtetim i lëshuar nga Universiteti Politeknik për mbrojtje diplome dhe dhënie titulli, por në DST kërkohet në mënyrë eksplicite paraqitja e diplomës.

3.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2 (dëshmi për mjetet)**, konkretisht për mjetin miniskrep. OE ñSh-07ò ka paraqitur 2 deklarata doganore me nr. *R 10160* dhe *R 10161*. Këto deklarata janë në emër të OE ñSHò dhe jo ñSh-07ò. Nuk ka fatura tatimore për kalimin e pronësisë së këtij mjeti ndërmjet këtyre operatorëve.

4.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **9** për një punësim mesatar prej 135 punonjës për periudhën Janar 2017 i Shtator 2017. Konkretisht, OE ñFò SHPK, i cili ka marrë përsipër kryerjen e 51% të punimeve, duhet të disponojë staf prej 65-66 punonjës. Nga kontrolli i listëpagesave të paraqitura nga OE në SPE për periudhën e mësipërme, rezulton se ky OE ka mesatarisht 56 punonjës për periudhën e kërkuar. Në këto kushte, ky OE nuk përmbush kriterin e kërkuar.

5.OE ñSh-07ò SHPK, nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/e** të DST për likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike.

-Rezulton se ky OE ka paraqitur vërtetimin nr. 5897 prot., datë 23.11.2017, sipas të cilit ky OE ka likuiduar faturat e llogaritura deri në datën 21.11.2017, duke përfshirë faturën koherente të muajit Tetor 2017. Në kushtet kur data e zhvillimit të tenderit është 17.12.2017, është kusht për OE likuidimi i faturave të maturuara, që në rastin konkret është fatura e muajit Nëntor 2017, e cila nuk rezulton të jetë likuiduar sipas dokumentacionit të ngarkuar në SPE.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi:** anëtarët e NJP z. E. A. (Jurist), znj. Gj. V. dhe znj. A. E. (anëtar), anëtarët e KSHA znj. P. K., z. E. P., znj. A. B. si dhe anëtarët e KVO: z. F. P. (kryetar), z. Y.ZH. dhe z. J.L. (anëtar).

Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **29,461,240 lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **29,461,240 lekë** pa SHPK. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë

kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP z. E. A., znj. A. E. dhe znj. Gj. V. është paraqitur observacioni me nr. 235/35 prot., datë 09.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 98/11, datë 12.07.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Njësia e Prokurimit sqaron se i qëndron objeksioneve të bëra sipas akt konstatimit nr. 7, protokolluar në Bashkinë Kuçovë me nr. 235/11 prot., datë 16.04.2021.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 7 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO z. F. P., z. Y.ZH. dhe z. J.L. është paraqitur observacioni me nr. 235/37 prot., datë 16.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 98/14, datë 19.07.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1.Në lidhje me pikën 7.1 për kategoritë e licencave e të OE "F" shpk i cili disponon vetëm kategorinë A, KVO sqaron se bashkë operatori tjetër "Sh-07" shpk i disponon kategoritë B të kërkuara në DST.

2.Në lidhje me pikën 2, KVO sqaron se stafi inxhinierik është i gjithi i deklaruar në listëpagesat e OE "Sh-07" shpk.

3.Në lidhje me pikan 4, KVO sqaron se numri i punonjësve përmbushet nga bashkimi i OE, dhe në këto kushte konsiderohet kriter i plotësuar.

4.Në lidhje me pagesën e maturuar të energjisë elektrike, KVO sqaron çdo operator ekonomik, individ apo subjekt është i detyruar që pagesën e muajit paraardhës ta bëjë deri në datën 30 të muajit pasardhës. Ne te tilla Kushte pagesa e muajit nëntor 2017 ka pasur afat për tu paguar deri ne 31 dhjetor 2017, dhe operatori ka paraqitur faturën e muajit tetor 2017.

Në DST nuk është përcaktuar që kriteret teknike, ligjore dhe ekonomike të plotësohen sipas % së punimeve të marra përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit të kruer ndërmjet operatorëve ekonomikë të ndryshëm.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, nuk pranohen. Në lidhje me mangësinë për kategorinë A të licencës për OE ñFò, rezulton se është OE me pjesëmarrjen më të lartë në përqindje të punimeve, ndërkohë që nuk disponon kategoritë e kërkuara në DST. E njëjta situatë vlen edhe për pikën 3 të observacionit. OE ñFò shpk nuk disponon numrin e punonjësve në përputhje me pjesëmarrjen në punime. Kjo ëshët në kundërshtim me pikën 3 të nenit 74 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i cili përcakton se "...kërkesat ekonomike, financiare, **profesionale** dhe ato **teknike** duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, **në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuar në akt marrëveshje.**

2.Në lidhje me pikën 2 të observacionit, pretendimi nuk qëndron. Është kërkesë eksplicite në DST, që OE duhet të paraqesin si dokumentacion librezën e punës për të gjithë inxhinierët e kërkuar. Rezulton se OE ñSh-07ò nuk e ka përmbushur këtë kriter të vendosur në DST.

3.Në lidhje me pikën 4 të observacionit, pretendimi nuk qëndron. Sipas pikës 7 germa (c) të nenit 26 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, përcaktohet qartë se OE duhet të paraqesin një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve **të maturuara të energjisë elektrike**. Sa më sipër, për shkak të aplikimit në procedura të prokurimit publik, është detyrim për OE që të kryejnë likuidimin e të gjitha detyrimeve.

III- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në tenderin me objekt: **ñBlerje Gazoili dhe Vaji për Bashkinë Kuçovë**, rezultoi problematika e shprehur me gjetjen si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 4:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **2.3** e cila kërkon nga *OE që të ketë vërtetim teknik të lëshuar nga IQT për depozita me kapacitet jo më pak se 85,000 litra*, është kërkesë e paargumentuar, e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me natyrën dhe vlerën e shërbimit. Kapaciteti i depozitës nuk përbën asnjë kriter të veçantë që ti shërbej AK, por përkundrazi pengon OE të tjerë për të marrë pjesë në këtë procedurë.

2.Kërkesa e pikës **2.3** e cila kërkon nga *OE që të ketë pasur fuqi punëtore jo më pak se 14 punonjës për periudhën Janar 2017 – Janar 2018*, është kërkesë e paargumentuar, dhe jo në përputhje me natyrën e shërbimit. Praktikisht një karburant funksionon 24 orë shërbim, dhe kushdo me një numër prej 5-6 punonjësish mund të menaxhojë shumë mirë këtë shërbim, pa qenë nevoja për një numër aq të lartë.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e NJP z. E. A. (Jurist), z. A. O. dhe znj. A. E. (anëtar)**

Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri në aplikimin e kriterëve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP z. E. A., znj. A. E. dhe z. A. O. është paraqitur observacioni me nr. 235/35 prot., datë 09.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 98/11, datë 12.07.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1.Në lidhje me kërkesën për depozita me kapacitet jo më pak se 85,000 litra, NJP sqaron se këtë kriter e ka vendosur duke pasur parasysh vlerën e kontratës, afatin për ekzekutimin e saj dhe sasinë e naftës së kërkuar.

2. Në lidhje me pikën 2, e cila kërkon 14 punonjës, NJP sqaron se kërkesa është në përputhje me nenin 46, pika 1, germa (b) të LPP. Sipas NJP, ky numër është i nevojshëm pasi furnizimi do kryhet 24 ore, dhe duke marrë parasysh zëvendësimin dhe ditët e pushimeve plus 1 shofer autoboti, kërkohet numri i mësipërm.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 7 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO z. F. P., z. Y.ZH. dhe z. J.L. është paraqitur observacioni me nr. 235/37 prot., datë 16.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 98/14, datë 19.07.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1.Në lidhje me pikën 2.3, KVO sqaron se bën kontrollin e dokumentacionit, të OE, dhe shpall fitues në bazë të dokumentacionit dhe ofertës së dhënë prej tyre. Në të tilla kushte, OE "G." shpk ka paraqitur një deklaratë që merr përsipër furnizimin dhe realizimin e shërbimit me karta elektronike, sipas kërkesës në DST.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Pranohet observacionit i KVO. Në kushtet kur në DST është përcaktuar me deklaram nga OE shërbimi i mësipërm, KVO ka përmbushur detyrën duke vlerësuar vetëdeklarimin e OE.

IV- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në tenderin me objekt: ËShërbimi i pastrimit, mbledhjes dhe transportimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kuçovë, rezultoi problematika e shprehur me gjetjen si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 5:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kriterëve.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës 9/b e DST e cila kërkon për kontejnerët nga OE akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar si dhe me fatura tatimore të blerjes, është kërkesë e paargumentuar dhe kufizuese. Pavarësisht pretendimit se me akt pronësie nënkuptohet kontrata e shitjes të blerjes, vlen të theksohet se edhe fatura tatimore e tvsh-së, është formë kontrate e cila ka elementët si të shitësit dhe të blerësit. Për kontejnerët, nuk disponohet dokument konkret për tu pajisur me *certifikatë pronësie*, dhe AK duhet të parashikonte njërin nga format për të provuar disponimin e tyre dhe jo të dyja siç është përcaktuar në DST.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me *përgjegjësi*: anëtarët e NJP z. E. A. (Jurist), z. N. P. dhe znj. A. E. (anëtar).

Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri në aplikimin e kriterëve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP z. E. A., znj. A. E. dhe z. N. P. është paraqitur observacioni me nr. 235/35 prot., datë 09.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 98/11, datë 12.07.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1.Në lidhje me kërkesën që mjetet për zbatimin e kësaj kontrate të jenë jo më pak se viti 2003, sqarohet se kjo kërkesë ka si qëllim zbatimin e kontratës së shërbimit dhe proceseve të punës së parashikuar, por njëkohësisht edhe ndikimit në mjedis. NJP sqaron gjithashtu se kjo procedurë e rishpallur në SPE, vjen si pasojë e procedurës së parë dhe të dytë ku pikërisht për këtë kriter ka pasur 2 ankesa, të cilat janë refuzuar nga KPP me vendimin nr. 643/2017 dhe vendimin nr. 806/2017.

2. Në lidhje me pikën 2, e cila kërkon akt pronësie si dhe faturën e TVSH-së për kontejnerët, NJP sqaron se Akt pronësie është kontrata e shit blerjes, e cila përcaktohet qartë në Kodin Civil. Disponimi i këtij dokumenti nuk është abuziv, dhe as anti ligjor.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Pranohet pika 1 e observacionit.

2.Në lidhje me pikën 2 të observacionit, pretendimi nuk qëndron. NJP ka kërkuar dokument pronësie origjinal ose kopje të noterizuar si dhe me faturat tatimore të blerjes. Pikërisht kërkesa që të disponohen të dy dokumentet, përbën kërkesë kufizuese kjo për arsye se çdo OE, i cili disponon kontenerët dhe për këto ka faturat përkatëse të TVSH-së, do duhej sipas NJP të disponojë edhe kontratën e shit blerjes për të përmbushur kriterin. Nuk ka asnjë përcaktim ligjor, që të detyrojë palët të nënshkruajnë kontratë përpara noterit për blerjen e kontejnerëve. Përsa kohë që palët kanë rënë dakord nëpërmjet firmosjes së faturave të TVSH-së për shitjen dhe blerjen e tyre, atëherë do të ishte e mjaftueshme ky dokument për të provuar disponimin e tyre. NJP, do duhej të përcaktonte njërin nga format *kontratën e shit blerjes ose faturat e tvsh-së, dhe jo të dyja së bashku*.

V- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në tenderin me objekt: “Rikonstruksion i shkollës së mesme 5 Tetori”, rezultoi problematika e shprehur me gjetjen si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 6:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE.

Situata: Hartimi i kriterëve 1.Kërkesa e pikës 7 e cila kërkon të paktën 20 punonjës me dëshmi kualifikimi nga ISHTI ose institucion ekuivalent me të cilët duhet ti përkasin grupeve përkatëse, është kriter i paqartë, jo i argumentuar i cili nuk i shërben AK, por krijon mundësinë e konfuzionit për OE. Nga NJP, duhej të specifikoheshin profesionet konkrete të punonjësve për zbatimin e kësaj kontrate.

2.Kërkesa e pikës 7.2 e cila kërkon në rast bashkim operatorësh mjek të përgjithshëm, e modifikuar nëpërmjet shtojcës ku përcaktohet se kur njëri prej anëtarëve ka mbi 15 punonjës, ky kriter duhet të plotësohet nga secili prej tyre, rezulton e paargumentuar dhe kufizuese. NJP duhej ti referohej nenit 74, pika 3 të VKM-së me nr. 914, datë 29.12.2014, dhe të përcaktonte kërkesën për mjek bazuar në përqindjen e punimeve të pjesëmarrjes në punë. Kjo kërkesë mund të përbëjë kufizim për OE, të cilët kanë më shumë se 15 punonjës, por përqindja reale sipas marrëveshjes mes palëve mund të jetë e tillë që fuqia punëtore të jetë me vogël se 15 punonjës. Në këto kushte OE penalizohet me të padrejtë për shkak të formulimit të bërë nga NJP.

Vlerësimi i Kriterëve: 1. OE ñBò SHPK, nuk përmbush kriterin e pikës 2.1/e të DST për likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike. OE ka paraqitur vërtetimin me nr. 1349 prot., datë 16.08.2018 sipas të cilit janë likuiduar faturat e energjisë elektrike të llogaritura deri në datën 16.08.2018, pa përfshirë faturën koherente të muajit Korrik 2018. Në kushtet kur data e zhvillimit të tenderit është 20.08.2018, është kusht likuidimi i faturës së maturuar të muajit Korrik 2018 për të përmbushur kriterin e vendosur në DST.

2.OE ñBò SHPK nuk përmbush kriterin e pikës 7.2 të DST për mjekun, pasi urdhri i mjekut E. B., rezulton jashtë afatit të vlefshmërisë. Urdhri mban datën e lëshimit 04.07.2012 me afat vlefshmërie 5 vjet. Data e zhvillimit të tenderit është 20.08.2018, pra urdhri ka mbi 1 vit që duhej të ishte rinovuar. Vlen të theksohet, se për të njëjtat arsye, është konsideruar kusht për s̑kualifikim në këtë tender mjeku i deklaruar nga OE ñPò SHPK, pikërisht për vlefshmërinë e urdhrit të mjekut.

3.Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se OE ñAò SHPK, ka deklaruar certifikatat ISO të lëshuara nga *RIGCERT Certification Services*. Këto certifikata janë brenda afatit të vlefshmërisë, dhe kanë kodet sipas kërkesës së DST. KVO, i ka konsideruar të rregullta certifikatat e mësipërme, por të njëjtat certifikata të lëshuara nga po e njëjta shoqëri *RIGCERT*, janë konsideruar të parregullta për OE ñB.I-I.S.ò SHPK, për OE ñAuò SHPK dhe

për OE ñCoò SHPK me arsyetimin se nuk janë të akredituara pranë DPA. Në këto kushte, i njëjti qëndrim duhej mbajtur edhe për OE ñAò SHPK.

4.Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se OE ñBò SHPK, ka deklaruar certifikatat ISO të lëshuara nga *AQSCERT Certification & Inspections Body*. Këto certifikata janë brenda afatit të vlefshmërisë, dhe kanë kodet sipas kërkesës së DST. KVO, i ka konsideruar të rregullta certifikatat e mësipërme, por të njëjtat certifikata të lëshuara nga po e njëjta shoqëri *AQSCERT*, janë konsideruar të parregullta për OE ñB-Bò SHPK, me arsyetimin se nuk janë të akredituara pranë DPA. Në këto kushte, i njëjti qëndrim duhej mbajtur edhe për OE ñBò SHPK.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi:** anëtarët e NJP z. E. A. (Jurist), znj. S. G. dhe znj. A. E. (anëtar), si dhe anëtarët e KVO: z. F. K. (kryetar), z. K. H. dhe z. J.L. (anëtar).

Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **42,664,066 lekë**.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **42,664,066 lekë** pa SHPK. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës..

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP z. E. A., znj. A. E. dhe z. F. P. është paraqitur observacioni me nr. 235/35 prot., datë 09.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 98/11, datë 12.07.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1.Në lidhje me kërkesën që kopjet e balanceve të jenë të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të autorizuar, sqarohet se kjo kërkesë është në përputhje me nenin 26, pika 7 germa (a) të VKM-së nr. 914, si dhe nenin 41 germa (c) të ligjit nr. 10091 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i cili përcakton detyrimin për kryerjen e auditimit ligjor, si dhe personat ose shoqëritë audituese.

2. Në lidhje me pikën 2, e cila kërkon 20 punonjës me IQT, të ndara sipas grupeve përkatëse, NJP sqaron se kërkesa e mësipërme është në përputhje me gjerat (a) dhe (b) të pikës 1 dhe 2 të nenit 46 të LPP, si dhe germës (b) pika 8 të nenit 26 të VKM-së nr. 914 e cila kërkon nga OE “dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit”. NJP ka sqaruar gjithashtu, se sipas nenit 9 pika 1 germa (a) të ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, parashikohej se “Formimi i punëmarrësve” Punëdhënësi merr masat e nevojshme që: a) përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja ose nga komisioni i miratuar prej saj”. Në nenin 7 të ligjit nr.13/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, parashikohet se “Në nenin 9, shkronja “a” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë: “a) Përdorimi i pajisjeve elektrike bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse. Bazuar në preventiv, AK ka përcaktuar nevojën për 20 punonjës me IQT në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

3.Në lidhje me pikën 3, për kërkesën e disponimit të mjekut për çdo operator që ka mbi 5 punonjës, NJP sqaron se kjo kërkesë është bërë në përputhje me rekomandimin e APP, e cila

ka marrë parasysh legjislacionin i cili përcakton detyrimin për OE që të disponojnë mjek kur kanë mbi 15 punonjës,

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 7 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

VI- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në tenderin me objekt: “Rikonstruksioni i objekteve të komunitetit Rom dhe Egjiptiane Kuçovë dhe banues në zona rurale”, rezultoi problematika e shprehur me gjetjen si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 7:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës 3 për kategoritë e licencës NP-12A (punime të inxhinierisë së mjedisit) dhe NS-19A (sistemi kundër zhurmës për infrastrukturë), janë kërkesa të tepërta, dhe të paargumentuara. Objekti i punimeve është rikonstruksion banesash ekzistuese, dhe nuk ka zëra punimesh në preventiv për të kërkuar kategoritë e mësipërme.

2.Kërkesa e pikës 5 në të cilën kërkohet 1 inxhinier mjedisi, është kërkesë e tepërt dhe jo e argumentuar, pasi nuk ka asnjë punim që shkakton ndikim në mjedis.

3,Kërkesa e pikës 6 dhe 7 e DST sipas të cilave kërkohet 1 teknik ndërtimi dhe 1 manovrator **në stafin drejtues**, janë kërkesa të paargumentuara, të cilat krijojnë konfuzion dhe nuk i shërbejnë AK.

4.Kërkesas e pikës 8 e cila kërkon staf të kualifikuar me IQT 9 punonjës, sipas kategorive nga I i V, është kërkesë e paargumentuar, e cila nuk jep ndonjë panoramë të qartë se cili staf i kualifikuar sipas profesionit është i nevojshëm për zbatimin e kësaj kontrate. Është kërkesë konfuze që nuk i shërben AK.

5.Kërkesa e pikës 8 e cila kërkon 1 specialist për prodhim dyer, dritare duralumin, i cili të figurojë në listëpagesë për periudhën Qershor 2017 i Qershor 2018, është kërkesë e paargumentuar e cila nuk i shërben AK. Së pari kontrata është punime rikonstruksioni, dhe nevojat janë për specialist montimi, ndërkohë që kërkesa është për specialist prodhimi, çka nuk është objekt i këtij tenderi. Gjithashtu, kërkesa që të jetë në listëpagesa për periudhën Qershor 2017 i Qershor 2018, është kërkesë që nuk i shërben AK, dhe njëkohësisht përbën pengesë për OE për të paraqitur oferta. NJP duhej që kërkesën e mësipërme ta parashikonte mundësinë edhe me kontratë shërbimi specialistin e kërkuar.

6.Kërkesa e pikës 8.4 e cila kërkon për *Raport testime për materialet inerte granel, inerte rërë e larë, sipas metodës S SH EN 1097-6-2000, raport i cili duhet të jetë të paktën muajt e fundit*, është kërkesë e tepërt, e paargumentuar e cila nuk i shërben AK, por bëhet pengesë për OE për të paraqitur ofertat e tyre. Testimet e kërkuara nuk janë për materialet me të cilat do të përdoren për zbatimin e kësaj kontrate.

Vlerësimi i Kriterëve: 1.OE ñZò SHPK, nuk përmbush kriterin e pikës 5 për 1 inxhinier topograf, pasi diploma e paraqitur nga OE rezulton kopje e panoterizuar, në kundërshtim me paragrafin e fundit të DST, i cili përcakton se ***të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.***

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës 6 dhe 7 të DST për 1 teknik ndërtimi dhe 1 manovrator të cilët **duhet të jenë në stafin drejtues**. Të dy punonjësit e paraqitur nga OE, rezultojnë sipas

kontratës dhe dokumentacionit të paraqitur, punonjës që kryejnë detyrat sipas kontratës, pa specifikuar në asnjë dokument rolin e tyre drejtues siç kërkohet nga NJP në DST.

3.OE nuk përmbush kriterin e pikës 9 të DST për mjek i cili duhet të jetë në listë pagesa. OE ka lidhur një kontratë shërbimi me shoqërinë ñR&T Cò për dhënie konsulence. Sipas objektit të kontratës, shoqëria do japë konsulencë kryesisht në formë verbale dhe/ose me shkrim sipas formës së kërkuar nga porositësi. Së pari, rezulton se OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion të kësaj shoqërie, i cili përcakton objektin e aktivitetit të saj. Vetëm kontrata nuk është e mjaftueshme. Së dyti, është paraqitur dokumentacion për dy mjek të cilët deklarohen punonjës të kësaj shoqërie, konkretisht mjekët I.M. dhe E. M.. Asnjëri prej këtyre mjekëve nuk rezulton në listë pagesën e OE ñZò. Sa më sipër, konstatohet se OE nuk ka përmbushur kriterin siç përcaktohet nga NJP në DST.

4.OE nuk përmbush kriterin për 1 Autovinç me kapacitet 3.5 i 7.5 Ton. Për këtë kërkesë, OE ka paraqitur 2 mjetet me targa AA216PR në pronësi, dhe AA047ND i marrë me kontratë qiraje nga shoqëria CSM Industri. Mjeti i parë rezulton me kapacitet 8.9 Ton, ndërsa mjeti i dytë me kapacitet 8.1 Ton. Sa më sipër, rezulton se asnjëri nga mjetet nuk ka kapacitetin e kërkuar.

5.OE nuk përmbush kriterin për minieskavtor 2.5 Ton. Për të përmbushur këtë pikë OE ka paraqitur deklaratën doganore me nr. R 3452, për mjetin mini eskavtor i cili rezulton me peshë neto 2.8 Ton. Sa më sipër mjeti nuk përmbush kriterin e vendosur.

6.OE nuk përmbush kriterin për kamionçinë me kapacitet 3.5 i 7.5 Ton. Për të përmbushur këtë pikë, OE ka paraqitur mjetin me targa AA971PT, i cili rezulton sipas lejes së qarkullimit me kapacitet 2.33 Ton, ose 1.17 Ton poshtë minimumit të kërkuar.

7.OE nuk përmbush kriterin për raport testimet e materialeve, për të cilat kërkohet të jenë të 3 muajve të fundit. Rezulton se për të përmbushur këtë kriter, OE ka paraqitur kontratë furnizimi nga shoqëria ñFò SHPK, e cila disponon fabrikë betoni, por raport testimet e paraqitura rezultojnë të vitit 2016, pra është 2 vite dhe jo 3 muaj siç kërkohet nga NJP në DST.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi:** anëtarët e NJP z. E. A. (Jurist), z. F. P. dhe znj. A. E. (anëtar), si dhe anëtarët e KVO: z. F. K. (kryetar), z. K. H. dhe z. J.L. (anëtar).

Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **12,145,527 lekë**.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **12,145,527 lekë** pa SHPK. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës..

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP z. E. A., znj. A. E. dhe z. F. P. është paraqitur observacioni me nr. 235/35 prot., datë 09.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 98/11, datë 12.07.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1.Në lidhje me kërkesën për kategorinë NP-12A (punime të inxhinierisë së mjedisit), sqarohet se OE fitues i kësaj procedure ka detyrimin ligjor që të rregullojë ambientin përreth 26 shtëpive që do ndërtojë. I shërben riaftësisimit natyror në përputhje me zbatimin e kësaj licence. Në lidhje me kërkesën për kategorinë NS-19A, sqarohet se referuar preventivit të punimeve autoriteti kontraktor ka parashikuar kryerjen e punimeve si F V dritare duralumini tek xham, F V dyer të brendshme tamburatë të rimesuar

druri importi Cilësia I, derë d/alumini pa xham me mbushje d/a për pothuajse të gjitha shtëpitë ku do të zhvillohet investimi.

2. Në lidhje me pikën 2, e cila kërkon 1 inxhinier mjedisi, NJP sqaron se operatori ekonomik fitues i kësaj procedure ka detyrimin ligjor që të rregullojë ambientin përreth 26 shtëpive ku do të kryhet ndërtimi, duke lënë një ambient të rregulluar, të pastër dhe bashkëkohor për familjet që do të jetojnë aty.

3. Në lidhje me pikën 3, e cila kërkon 1 teknik ndërtimi dhe 1 manovrator në stafin drejtues, sqarohet se kjo kërkesë është lapsus.

4. Në lidhje me pikën 4 e cila kërkon 9 punonjës me IQT sipas kategorive, NJP jep të njëjtat sqarime si në procedurën “Rikonstruksion i shkollës së Mesme 5 Tetori”.

5. Në lidhje me pikën 5, e cila kërkon 1 specialist për prodhim dyer, dritare duralumini, NJP sqaron se AK ka përcaktuar se operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të paktën 1 (një) Specialist për prodhim dyer dritare Duralumin të figurojë në listpagesë të paktën qershor 2017- qershor 2018 si dhe të disponojë dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik, është e nevojshme dhe në proporcion të drejtë me objektin e prokurimit duke pasur parasysh preventivin e punimeve ku në çdo banesë është e parashikuar që të bëhen Dritare d/alumini tek xham dhe Derë d/alumini pa xham me mbushje d/a . Është në të drejtën e AK të garantohej për çdo zbatim të zërave të preventivit të punimeve.

6. Në lidhje me pikën 6, e cila kërkon raport testimi për materialet inerte granil, rërë etj, sipas metodës S Sh EN 1097-6-2000 e cila duhet të jetë e 6 muajve të fundit, NJP sqaron se kërkesa e mësipërme është bërë në përputhje me LPP, pasi certifikatat e kërkuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1. Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 7 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

VII- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në tenderin me objekt: “Rikualifikim urban i lagjes 1 Maj”, rezultoi problematika e shprehur me gjetjen si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 8:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për shpalljen fitues të OE.

Situata: Vlerësimi i Kritereve: 1.OE ñAò SHPK, nuk përmbush pikën **2.1/dh** të DST për likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike.

Ky OE, ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga OSHEE me nr. 9558 prot., datë 16.11.2018, sipas të cilit OE ka likuiduar faturat e energjisë elektrike të llogaritura deri në datën 16.11.2018, duke përfshirë faturën koherente të muajit Tetor 2018. Në kushtet kur data e hapjes së ofertave është 17.12.2018, OE duhej të likuidonte faturën e maturuar të muajit Nëntor 2018 për të përmbushur kriterin e vendosura nga NJP në DST.

2.OE ñBò SHPK, nuk përmbush pikën **2.1/dh** të DST për likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike.

Ky OE, ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga OSHEE me nr. 1880 prot., datë 04.12.2018, sipas të cilit OE ka likuiduar faturat e energjisë elektrike të llogaritura deri në datën 04.12.2018, pa përfshirë faturën koherente të muajit Nëntor 2018. Në kushtet kur data e

hapjes së ofertave është 17.12.2018, OE duhej të likuidonte faturën e maturuar të muajit Nëntor 2018 për të përmbushur kriterin e vendosura nga NJP në DST.

3.BOE nuk përmbush pikën 11 të DST për mjetin *Autobitumatriçe*. BOE ka paraqitur vetëm mjetin me targa BR9255T, në pronësi të OE në SHPK, i cili rezulton nga dokumentacioni i paraqitur mjet i montuar kamion + bitumatriçe. Gjithashtu nga Certifikata e pronësisë së mjetit, rezulton ATV dhe jo cisternë për transport.

4.OE në SHPK, disponon certifikatat ISO të lëshuara nga RigCERT Certification. Këto certifikata janë konsideruar nga KVO arsye për s kualifikimin e OE në I.I.S. SHPK me argumentin se janë lëshuar nga një organizëm i pa akredituar. Në këto kushte, KVO duhet të kishte s kualifikuar OE në me të njëjtin argument.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e KVO: z. F. K. (kryetar), z. K. H. dhe z. J.L. (anëtar).*

Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **88,015,860 lekë**.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **88,015,860 lekë** pa SHPK. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

VIII- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në tenderi me objekt: “Shërbimi i dekorit për Bashkinë Kuçovë”, rezultoi problematika e shprehur me gjetjen si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 9:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për shpalljen fitues të OE.

Situata: Vlerësimi i Kritereve: a) OE “A. D.” nuk përmbush pikën 1.2/c të Kritereve të Veçanta për *likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike*.

-Rezulton se ky OE ka paraqitur vërtetimin me nr. 1114 prot., datë 28.06.2018 të Drejtorisë Rajonale Berat sipas të cilit ky person fizik rezulton me debi pranë OSHEE në vlerën 74,001 lekë, (45,626, principal dhe 28,375 kamatë), e cila është në proces ankimimi dhe vlerësimi nga OSHEE. Pranimi i këtij vërtetimi si i rregullt është në shkelje të nenit 28 të VKM-së 914, në Kontratat e shërbimeve, pika 4, germa ç), ku përcaktohet se:

“...Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për s kualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë...”

(Trajtuar gjerësisht në Akt-konstatimin nr. 7, datë 16.04.2021)

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e KVO: z. F. K. (kryetar), z. Y.ZH. dhe z. J.L. (anëtar).*

Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **7,869,615 lekë**.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **7,869,615 lekë** pa SHPK. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë

kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësive publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës..

Procedurat e periudhës 01.01.2019 – 31.12.2019

-Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetore.

Për periudhën 01/01/2019 i 31/12/2019, nga Bashkia Kuçovë referuar të dhënave të regjistrimit të prokurimeve ka kryer gjithsej **4** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 83,821 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 80,158 mijë lekë, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 3,663 mijë lekë ose 4.4 %. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënave janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01/01/2019 - 31/12/2019	Nr.	VI.Fond Limit	VI.Kontrate
GJITHESEJ	4	83,821,429	80,158,446
-Të hapura	2	81,527,805	77,916,214
- Negocim pa shpallje	1	1,293,624	1,291,982
- Kërkesë për propozim	1	1,000,000	950,250
Sipas objekteve	4	83,821,429	80,158,446
-Objekte në fushën e investimeve	3	82,821,429	79,208,196
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	1	1,000,000	950,250

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **21** OE/BOE, nga të cilat janë s kualifikuar **14** OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **1** procedura ose 25 % e procedurave të z hvilluara.

-Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut, grupi i auditimit nga **4** procedura prokurimi të zhvilluara me vlerë kontrate 96,309 mijë lekë pa tvsh, u vlerësua për auditimin e **2** procedurave me vlerë kontrate 93,499 mijë lekë ose 97 % e vlerës së kontratave të lidhura.

-Nga auditimi i **2** procedurave me vlerë kontrate 93,499 mijë lekë, u konstatua se janë në shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP, gjithsej **2** procedura me vlerë kontrate **93,499 mijë lekë ose 100 %** e vlerës së kontratave të lidhura, ku në **2** raste kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në **1** rast OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Kuçovë, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, veprime në paligjshmëri të fondeve publike në vlerën **62,150 mijë lekë** pa TVSH, veprime në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ãPër prokurimin publikò, i ndryshuar dhe VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,ò për miratimin e rregullave të prokurimit publikò, të ndryshuar, **për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJHDT dhe KVO sipas procedurave, si më poshtë vijon:**

I- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në tenderi me objekt: “Rehabilitim/përforcim banesash ekzistuese të familjeve në nevojë” rezultoi problematika e shprehur me gjetjen si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 10:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kriterëve.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **3** për 1 inxhinier **ndërtimi** i certifikuar për sigurinë në kantier, është e paargumentuar. AK nuk mund të kufizojë certifikimin pikërisht me inxhinierin e ndërtimit, por duhej të krijonte mundësinë që OE të dispononte punonjës të certifikuar për sigurinë në kantier.

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

3. Në lidhje me kërkesën për 7 manovratorë, sqarohet se është në përputhje me pikën dhe 2 të nenit 46 të LPP. Sipas NJP janë kërkuar 7 manovratorë pasi janë kërkuar 3 kamionë vetëshkarkues, 3 kamionçina, 1 autopompë për hedhje betoni, si dhe 3 minieskavtorë.

4.Në lidhje me kërkesën për policat e sigurimit për stafin teknik me IQT, NJP sqaron se bazuar në materialin informues të AMF (Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare), i cili ka për qëllim ti shërbejë konsumatorit si një udhëzues për t'i ndihmuar të kenë më tepër informacion përpara se të vendosin për të marrë një kontratë sigurimi. Materiali jep informacion edhe mbi të drejtat dhe detyrimet e konsumatorit.

5.Në lidhje me kërkesën për impiant betoni dhe impiant prodhim inertesh për të cilat kërkohej raport testimet e materialeve, NJP jep të njëjtat sqarime si në observacionet në procedurën Rikonstruksioni i objekteve të komunitetit Rom dhe Egjiptiane Kuçovë dhe banues në zona rurale.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 8 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

II- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë Tenderi me objekt: “Ndërtim i shkollës 9 vjeçare 18 Tetori”, rezultoi problematika e shprehur me gjetjen si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 11:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës 5 për 1 inxhinier elektronik/telekomunikacioni i cili të figurojë në listëpagesa për 6 muajt e fundit, është kërkesë e paargumentuar, dhe kufizuese. Së pari AK për stafin tjetër të inxhinierëve, ka kërkuar që të figurojnë në listëpagesa për 13 muajt e fundit. Në rastin e inxhinierit elektronik/telekomunikacion, e ka ulur në 6 muaj kërkesën për figurimin në listëpagesa. Sa më sipër, duke qenë se kërkesa për këtë kategori inxhinierësh është konsideruar e nevojshme nga AK dhe OE në fushën e ndërtimit nuk mund të kenë pjesë stafi të përhershëm inxhinierë të tillë, nuk duhej të përcaktonin afatin 6 mujor për deklarimin në listëpagesa, por do duhej të kërkohej disponimi i tyre me kontratë shërbimi.

2.Kërkesa e pikës 6 të DST, e cila kërkon 30 punonjës me dëshmi të sigurimit teknik dhe certifikata trajnimi, duke përcaktuar kategorinë nga I tek V, është kërkesë që mund të sjellë kufizim të pjesëmarrësve, të cilët disponojnë në nivele apo kategori më të lartë ose të përafërt stafin e kërkuar, por jo me kategorinë që kërkon AK.

3.Kërkesa e pikës 17 e cila kërkon nga OE të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori dhe certifikatë ISO 9900:2015 të prodhuesit të autorizuar për pajisjet e pasqyruara në preventiv, është kërkesë e tepërt dhe kufizuese. Sipas preventivit, pajisjet në përgjithësi janë hidraulike (lavamanë, bolier, tuba etj), pajisje që mund të gjenden lehtësisht në treg, dhe nuk argumentohet kërkesa për autorizimin nga prodhuesi/distributori i tyre. Gjithashtu, kërkesa që të paraqesë certifikata ISO të prodhuesit, sërish nuk argumentohet, pasi u adresohet palëve të treta të cilat nuk janë konkurrent. Neni 30 i VKM me nr. 914, datë 29.12.2014 përcakton se AK për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekti prokurimi i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve, të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ vlerësimi konformiteti..... Sa më sipër, VKM përcakton qartë, që kërkesa u drejtohet ofertuesve, dhe jo palëve të treta.

Vlerësimi i Kriterëve: 1.BOE nuk përmbush kriterin e pikës 18 të DST për disponimin e makinerive për 2 Autobetoniere, 1 Autopompë betoni dhe 1 Autobot uji. Për mjetet e

mësipërme, janë deklaruar 3 Autobetoniere me Targa TR8752K, TR6295K, TR6294K, Autopompa e betonit me Targa TR5537N, të marra me kontratë qiraje nga shoqëria ñEuro-Beton 2005ò SHPK. Të gjitha këto mjete, kanë certifikatën e transportit vetëm për vetën e tij, dhe jo për të tretë dhe me qira, në kundërshtim me nenin 41 të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 ñPër transportet rrugorë i ndryshuar, i cili përcakton se ñTransporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse”. Gjithashtu, mjeti me targa TR6295K, ka certifikatën e kontrollit teknik jashtë afatit të vlefshmërisë.

Për 2 Autobotet e deklaruar, me targa AA387PA dhe AA787DA, të marra me kontratë qiraje nga shoqëria ñSpektriò SHPK, nuk kanë certifikatën e transportit për të tretë dhe me qira, në kundërshtim me nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998.

2.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **18** për mjetin *vinxh kullë me kapacitet ngritës 0.5-1 Ton*. OE ñEd K.ò SHPK, ka paraqitur faturë tatimore me nr. serie 71723250, datë 11.01.2012 më shitës shoqërinë Flondi Konstruksion, për blerjen e një vinxhi kullë. Me përjashtim të faturës tatimore, nuk ka asnjë dokumentacioni tjetër për të provuar disponimin e këtij mjeti qoftë deklarata doganore e subjektit shitës. Gjithashtu, nuk ka asnjë skedë teknike për kapacitetin mbajtës të kërkuar nga 0.5 deri 1 Ton, por vetëm një përshkrim në faturë që mjeti ka kapacitet ngritës 1 Ton, e cila është e pamjaftueshme për të provuar kapacitetin mbajtës.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi:** anëtarët e NJP z. E. A. (Jurist), z. F. P. dhe znj. A. E. (anëtar), si dhe anëtarët e KVO: z. F. K. (kryetar), z. K. H. dhe z. J.L. (anëtar).

Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **62,150,364 lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **62,150,364 lekë** pa SHPK. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP z. L. K., z. E. A. dhe znj. A. E. është paraqitur observacioni me nr. 235/35 prot., datë 09.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 98/11, datë 12.07.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1. Në lidhje me kërkesën për inxhinier telekomunikacioni i cili duhet të figurojë në listëpagesa 6 muajt e fundit, NJP sqarohet se kjo kërkesë është bërë për kryerjen e shërbimit të instalimit dhe konfigurimit të pajisjeve elektronike, referuar proceseve të punës të lëvizjes, vendosjes apo përmirësimit të të gjithë linjave të telekomunikacionit dhe të linjave të tjera dixhitale si dhe të vendosjes së paneleve të kontrollit dhe të shpërndarjes.

2.Në lidhje me kërkesën për 30 punonjës me IQT, për të cilën ka përcaktuar kategoritë nga I-V për secilin punonjës, sqarohet se kategoritë e vendosura nga AK përkojnë me zbatimin e punimeve sipas vështirësisë së zërave në preventiv. Konkretisht për ka kërkuar elektrikistë me kategoritë IV-V, saldator me kategorinë II, mekanik me kategorinë II punonjësit e tjerë janë me kategori I. Punimet elektrike të parashikuara në preventiv e bëjnë të domosdoshme disponimin nga ana e OE ofertues të punonjësve me IQT me qëllim garantimin e AK për zbatimin me sukses të kontratës.

3.Në lidhje me kërkesën për autorizim nga prodhuesi të certifikatës ISO 9001:2015 për pajisjes e pasqyruara në preventive, NJP sqaron se kërkesa është në përputhje me nenin 30,

pika 1 dhe 2 të VKM nr. 914 që lidhet me kërkesat e cilësisë. Njësia e Prokurimit vlerëson se kriteri i përcaktuar në DST mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Dokumenti i kërkuar mund të sigurohet lehtësisht nga operatorët ekonomikë të cilët kanë për objekt të veprimtarisë së tyre furnizimin me mallra për të cilat kanë për detyrë të dëshmojnë në çdo rast origjinalitetin e tyre.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1. Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 8 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Procedurat e periudhës 01.01.2020 – 31.12.2020

-Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetore.

Për periudhën 01/01/2020 i 31/12/2020, nga Bashkia Kuçovë referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej **7** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 169,042 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 165,100 mijë lekë, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 3,942 mijë lekë ose 2.4 %. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënave janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01/01/2020 - 31/12/2020	Nr.	VI.Fond Limit	VI.Kontrate
GJITHESEJ	7	169,042,939	165,100,958
-Të hapura	5	163,728,181	160,295,105
- Kërkesë për propozim	2	5,314,758	4,805,853
Sipas objekteve	7	169,042,939	165,100,958
-Objekte në fushën e investimeve	5	143,986,510	140,266,357
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	2	25,056,429	24,834,601

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **29** OE/BOE, nga të cilat janë s kualifikuar **19** OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE nuk ka.

-Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut, grupi i auditimit nga **7** procedura prokurimi të zhvilluara me vlerë kontrate 197,688 mijë lekë pa tvsh, u vlerësua për auditimin e **5** procedurave me vlerë kontrate 191,921 mijë lekë ose 97 % e vlerës së kontratave të lidhura.

-Nga auditimi i **5** procedurave me vlerë kontrate 191,921 mijë lekë, u konstatua se janë në shkelje të akteve ligjore/nënligjorë të LPP, gjithsej **4** procedura me vlerë kontrate **170,858 mijë lekë ose 89 %** e vlerës së kontratave të lidhura, ku në **4** raste kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në **3** raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Kuçovë, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, veprime në paligjshmëri të fondeve publike në vlerën **116,141 mijë lekë** pa TVSH, veprime në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 nëPër prokurimin publikò, i ndryshuar dhe VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,ò për miratimin e rregullave të prokurimit publikò, të ndryshuar, **për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJHDT dhe KVO sipas procedurave, si më poshtë vijon:**

I- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë Tenderi me objekt: “Blerje Gazoil për Bashkinë Kuçovë, Bordin e Kullimit dhe Agjencinë e Shërbimit

Komunal”, mbas shqyrtimit të observacionit, merret në konsideratë argumentet mbi problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Gazoil për Bashkinë Kuçovë, Bordin e Kullimit dhe Agjencinë e Shërbimit Komunal”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 103 datë 17.04.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 101 datë 15.04.2020 L. K./jurist kryetar E. A. anëtar A. E. anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Nr. 101 datë 15.04.2020 F. P. kryetar A. ZH. anëtar J.L. anëtar
2. Lloji i Procedurës “Procedurë e Hapur-Shërbimeò Marrëveshje Kuadër 2 vjeçare		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 21,063,608 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) OE ñG.ò SHPK me ofertë 20.26 % nafta & 20.02 % benzina, me lidhje kontrate 17.06.2021 me afat 24 muaj	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 18.05.2020	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Kuçovë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-sëka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Sëka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: sëka

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO z. F. P., z. A. ZH. dhe z. J.L. është paraqitur observacioni me nr. 235/37 prot., datë 16.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 98/14, datë 19.07.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1.Në lidhje me pikën 2.3, KVO sqaron se bën kontrollin e dokumentacionit, të OE, dhe shpall fitues në bazë të dokumentacionit dhe ofertës së dhënë prej tyre. Në të tilla kushte, OE “G.” shpk ka paraqitur një deklaratë që merr përsipër furnizimin dhe realizimin e shërbimit me karta elektronike, sipas kërkesës në DST.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Pranohet observacionit i KVO. Në kushtet që në DST është përcaktuar me deklaram nga OE shërbimi i mësipërm, KVO ka përmbushur detyrën duke vlerësuar vetëdeklarimin e OE.

II- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë Tenderi me objekt: “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”, rezultoi problematika e shprehur me gjetjen si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 13:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kritereve.

Situata: Hartimi i kritereve: 1.Kërkesa e pikës 2.3 për kapacitetin teknik, e cila kërkon Punë të ngjashme për 1 kontratë të vetme të së njëjtës natyrë **sa 50% e fondit limit**, është hartuar në kundërshtim me nenin 26, pika 6 të VKM me nr. 914, datë 29.12.2014 ku parashikohet se “Për përvojën e mëparshme, AK kërkon punë të ngjashme për 1 objekt të vetëm me vlerë **jo më të madhe se 50% e vlerës**.”

2.Kërkesa e pikës 2, e cila kërkon kategorinë e licencës NP-12A (Punime të inxhinierisë së mjedisit) nuk është në përputhje preventivin e punimeve. Nuk ka asnjë zë në preventiv për të kërkuar këtë kategori licence.

3.Kërkesa e pikës 4 e cila kërkon nga OE ofertues që të përcaktojë nëpërmjet një deklarate drejtuesin teknik të punimeve, i cili duhet të jetë për gjatë gjithë afatit të zbatimit dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, është kërkesë e ekzagjeruar dhe vjen

në kundërshtim me UKM nr. 2 , datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. Është zbatimi i punimeve të ndërtimit, i cili përcakton se *Për vlera me vlerë të plotë të preventuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.* Ky tender ka fond limit **24,209,728 lekë**, vlerë kjo më e vogël se vlera e përcaktuar në UKM për të deklaruar drejtuesin teknik se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor për hartimin e kriterëve, duke ngarkuar me **përgjegjësi:** anëtarët e NJP: znj. L. K. (kryetar), z. E. A. dhe z. F. P. (anëtar).

Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri në hartimin e kriterëve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP z. L. K., z. E. A. dhe z. F. P. është paraqitur observacioni me nr. 235/35 prot., datë 09.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 98/11, datë 12.07.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1. Në lidhje me kërkesën për punë të ngjashme sa 50% e fondit limit, NJP sqaron se kërkesa është në përputhje me nenin 26, pika 6 germa (a), pasi nuk është tejkaluar vlera 50 e fondit limit.

2. Në lidhje me kërkesën për kategorinë e licencës NP-12A (Punime të inxhinierisë së mjedisit), NJP sqaron se kërkesa është bërë pasi OE ka detyrimin ligjor për rregullimin e ambientit përreth shtëpive që do ndërtojë.

3. Në lidhje me kërkesën për drejtuesin teknik të punimeve të paangazhuar në kontrata të tjera, NJP jep të njëjtat sqarime të trajtuara në observacionet e mësipërme.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1. Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 9 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

III- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë Tenderi me objekt:

Devijim i përroit Gegë për zgjerimin e varrezave publike, rezultoi problematika e shprehur me gjetjen si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 14:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1. Kërkesa e pikës 2.3 e cila kërkon *Punë të ngjashme për 1 kontratë të vetme të së njëjtës natyrë sa 50% e fondit limit*, është hartuar në kundërshtim me nenin 26, pika 6 të VKM me nr. 914, datë 29.12.2014 ku parashikohet se *“Për përvojën e mëparshme, AK kërkon punë të ngjashme për 1 objekt të vetëm me vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës.*

2. Kërkesa e pikës 2 e cila kërkon kategorinë NS-5A (implante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut), është kërkesë e ekzagjeruar, e paargumentuar dhe jo në përputhje me zërat në preventiv. Këto kategori nuk përputhen me llojin e punës.

3. Kërkesa e pikës 3 e cila kërkon që dy nga inxhinierët (njëri prej të cilëve inxhinieri hidroteknik), duhet të kenë certifikatë trajnimit përgjegjës/koordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit, përgjegjës për sigurinë në kantier, është jo në përputhje me vlerën dhe

natyrën e punës. Së pari kërkesa për 2 inxhinierë me certifikatat e mësipërme, është kufizuese, dhe specifikimi që njëra prej tyre të disponohet nga inxhinieri hidroteknik nuk është në përputhje dhe nuk i shërben AK, por mund të përbëjë pengesë për OE që disponojnë staf me certifikime të tilla, por nga inxhinierë të ndryshëm.

4.Kërkesa e pikës 4 e cila kërkon 1 Topograf të mesëm, është kërkesë e dubluar dhe e tepërt, pasi për zbatimin e kësaj kontrate është kërkuar gjithashtu 1 inxhinier Topograf.

5.Kërkesa e pikës 4 e cila kërkon nga OE ofertues që të përcaktojë nëpërmjet një deklarate drejtuesin teknik të punimeve, *i cili duhet të jetë për gjatë gjithë afatit të zbatimit dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera*, është kërkesë e ekzagjeruar dhe vjen në kundërshtim me UKM nr. 2 , datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. ãPër zbatimin e punimeve të ndërtimitò, i cili përcakton se *Për vlera me vlerë të plotë të preventuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt i diplomuar në inxhinieri ndërtimi*. Ky tender ka fond limit **15,182,264 lekë** ose **sa gjysma** e vlerës së kërkuar për të deklaruar drejtuesin teknik se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera.

6.Kërkesa e pikës 9 e cila kërkon Impiant prodhim betoni me QKL dhe Impiant prodhim inertesh me QKL, ndër të tjera kërkon që Impianti të jetë jo më larg se 50 km nga objekti, e paraqitur me plan vendosje nga një topograf vendndodhja, si dhe raport testimet e materialeve të cilat duhet të jenë e 6 muajve të fundit.

-Së pari, kërkesa që impianti të jetë jo më larg se 50 km, është kërkesë e paargumentuar dhe kufizuese. OE mund të sigurojnë cilësinë e materialit të kërkuar përtej kriterit të kilometrave, dhe kërkesa nga AK, nuk përbën gjë tjetër veçse kufizim për OE.

-Së dyti, kërkesa për raport testimet e materialeve, e cila duhet të jetë e muajve të fundit, është kërkesë e cila nuk i shërben AK, dhe mund të përbëjë kufizim për OE, kjo pasi raport testimet e materialeve janë të nevojshme për punën objekt prokurimi, dhe jo raport testime të kryera me parë.

7.Kërkesa e pikës 4, e cila kërkon për manovratorët *policë sigurimi për aksidentet personale*, është kërkesa e pabazuar dhe e paargumentuar. Gjithashtu, AK nuk mban të njëjtin standard për këtë kërkesë, pasi në procedura të tjera nuk kërkohet.

Vlerësimi i Kritereve: 1.OE nuk përmbush kriterin e pikës 4, e cila kërkon 5 manovratorë, për të cilët kërkon të paraqesë edhe **dëshminë e kualifikimit të sigurimit teknik**. OE ka paraqitur Dëshmi Kualifikimi vetëm për 1 manovrator (I.M.). Manovratorëve të tjerë u mungon dëshmia e kërkuar në DST.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës 8, për mjetet dhe pajisjet teknike për mjetet *Kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbi 18 Ton*. OE ka paraqitur kontratë qiraje me subjektin ãSh-07ò SHPK për mjetet me targa AA416JC, AA618XT, AA543AA dhe AA86AV. Këto mjete rezultojnë se nuk disponojnë certifikatën e transportit për të tretë dhe me qira, por vetëm për veten e vet. Mungesa e certifikatës së transportit për mjetet e dhëna me qira, është në kundërshtim me nenin 41 të ligjit me nr. 8308, datë 18.03.1998 ãPër transportet rrugorëò i ndryshuar.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e NJP z. E. A. (Jurist), z. F. P. dhe znj. A. E. (anëtar)**, si dhe **anëtarët e KVO: z. S. M. (kryetar), z. A. P. dhe z. J.L. (anëtar)**.

Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **14,899,900 lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **14,899,900 lekë** pa SHPK. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë

kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësive publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës..

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP z. L. K., z. E. A. dhe z. F. P. është paraqitur observacioni me nr. 235/35 prot., datë 09.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 98/11, datë 12.07.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1.Në lidhje me kërkesën për punë të ngjashme sa 50% e fondit limit, NJP sqaron se kërkesa është në përputhje me nenin 26, pika 6 germa (a), pasi nuk është tejkaluar vlera 50 e fondit limit.

2.Në lidhje me kërkesën për 1 inxhinier infrastrukturë transporti, NJP sqaron se tuneli që do të hapet, do të kalojë pikërisht mbi një rrugë ekzistuese me qarkullim të lartë të mjeteve dhe mendimi i specializuar i tij ndihmon në zbatimin e kontratës me sukses duke arritur qëllimin e autoritetit kontraktor që përpos punimeve që do të kryhen, mos të krijojë dëme anësore në rrugë por të kryhen punime sipas kushteve teknike dhe me standarde, në përputhje me cilësinë që kërkon autoriteti kontraktor.

4.Në lidhje me kërkesën për 2 inxhinierë (njëri prej të cilëve inxhinieri hidroteknik), të cilët duhet të kenë certifikatë trajnimit përgjegjës/koordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit, përgjegjës për sigurinë në kantier, NJP sqaron se bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10237 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, përcaktohet se punëmarrësi ngarkon një ose disa punëmarrës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë dhe shëndetit në punë të dhe parandalimit të rreziqeve profesionale... Sipas NJP, kërkesa që njëri duhet të jetë inxhinier hidroteknik është në përmbushje të zërave të preventivit si Gjermim dheu me eskavtor zinxhir 0.5 m^3 , në kanale gjerësi deri në 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk në mjet, Gjermim dheu me eskavtor zinxhir, 0.5 rn^3 , në kanale gjerësi $> 2\text{ m}$, toke zak, kategoria IV, me shk në toke, Struktura monolite betoni C-20/25 tombino katrore, Gjermim tuneli me makine shpimi në seksion $20 \sim 40\text{ m}^2$, $K = 6 \sim 10$, Tombino me tuba betoni Ø 1500, mbi shtrese betoni etj. Gjithashtu sipas NJP, kërkesa që certifikata për sigurinë në punë të jetë nga inxhinierë dhe jo staf tjetër i kompanisë, është në përputhje me nenin 8, të ligjit 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”

5.Në lidhje me kërkesën për 1 topograf të mesëm, NJP sqaron se kërkesa është e bazuar në nenin 46, pika 1 germa (b) të LPP, në nenin 26, pika 8 të VKM-së nr. 914. Sipas NJP, është e nevojshme kërkesa për 1 topograf të mesëm, pasi do zbatohet detyrat e inxhinierit topograf.

6.Në lidhje me kërkesën për drejtuesin teknik të punimeve të paangazhuar në kontrata të tjera, NJP ka dhënë të njëjtat sqarime në procedurat tjera.

7.Në lidhje me kërkesën për impiantin e betonit, **jo më larg se 50 km nga objekti i paraqitur si dhe raport testimet e materialeve për 6 muajt e fundit**, NJP sqaron se kjo kërkesë është në përputhje me aktet ligjore të prokurimit publik. Në rastin konkret është në të drejtën e autoritetit të kërkojë garanci lidhur me mundësitë e operatorëve ekonomik për sigurimin e lëndës bazë dhe materialeve që do të përdoren për realizimin e objektit, përse kohë lejohet provueshmëria e disponimit nëpërmjet edhe kontratave të furnizimit sikurse autoriteti kontraktor ka përcaktuar në DST. Sipas NJP, kur punimet e betonit janë në volume të mëdha, AK i lind e drejta të kërkojë garanci nga ofertuesit për mënyrën e furnizimit të betonit në kantier, dhe NJP e ka parë të konsiderueshme distancën 50 km nga kantieri.

Në lidhje me raport testimet, NJP ka dhënë sërish të njëjtat qëndrime, të cilat konsistojnë në të drejtat që parashikon LPP dhe VKM nr. 914 për kërkesën e certifikatave të lëshuara, aftësitë teknike të OE, dëshmitë për mjetet dhe pajisjet teknike etj. NJP citon gjithashtu nenin 20, pika (d) të ligjit nr. 9290, datë 07.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”, sipas të cilit organi i inspektimit ndalon hedhjen e produkteve në treg në rast moskonformiteti.

8.Në lidhje me kërkesën për policat e sigurimit për manovratorët, NJP jep të njëjtat sqarime të trajtuara në procedura të tjera.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

- 1.Në lidhje me pikën 3 të observacionit, pranohet pretendimit juaj si i bazuar në zërat e preventivit.
2. Pjesa tjetër e observacionit të paraqitur nga subjekti i audituar, është e njëjtë me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 9 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

IV- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë Tenderi me objekt:
ñRikonstrukcion i rrugës Murat Daulleò, rezultoi problematika e shprehur me gjetjen si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 15:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE.

Situata: Hartimi i kriterëve: Në lidhje me kriteret e vendosura, pranë AK janë paraqitur disa ankesa nga OE.

1.Ankesa nga OE ñRSM Coò SHPK pa nr. prot. Ky OE ankohet për kërkesën për 1 ing. Hidroteknik, 1 topograf dhe 1 ing.gjeolog për të cilat deklarohet se nuk janë në përputhje me zërat e punimeve. OE ankohet për numrin e lartë të stafit teknik sipas pikës 8. OE ankohet për kërkesën për impiant prodhim betoni, impiant prodhim inertesh, fabrikë asfalti si dhe linjë prodhimi për pllaka e bordura. OE ankohet gjithashtu për numrin e lartë të mjeteve të kërkuara.

2.Ankesa e OE ñLLò SHPK me nr. 4147 prot., datë 27.11.2020. Ky OE ankohet për numrin e lartë të mjeteve si dhe përcaktimet mbi tonazhin e mjeteve kamionë. OE ankohet për kërkesën për 2 rimorkio dhe 2 kokë tërheqës. OE kërkon sqarime për kërkesën për minieskavator, eskavtor me zinxhirë dhe me goma. OE ankohet për kërkesën për manovratorë si jo në përputhje me numrin e mjeteve.

3.Ankesa e OE ñI 2020ò SHPK me nr. 4201, datë 02.12.2020. OE ankohet për kërkesën për 2 ing. ndërtimi dhe 2 ing.topograf si të tepërt në raport me volumet e punimeve, dhe 1 ing.infrastrukturë transporti si jo në përputhje me proceset e punimeve për këtë procedurë. OE ankohet për kërkesën që 1 ing. ndërtimi, 1 ing. hidroteknik dhe 1 ing. mekanik të disponojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik. OE ankohet për kërkesën për numrin dhe kapacitetin e mjeteve të kërkuara. OE ankohet për kërkesën për disponimin e licencës QKL kodi III.2.B.

Nga titullari i AK është pezulluar procedura me urdhrin nr. 52, datë 27.11.2020, dhe me urdhrin nr. 368, datë 27.11.2020 është ngritur KSHA e përbërë nga P. K., A. E. dhe L. D..

Me shkresën nr. 4199/1 prot., datë 02.12.2020 është kthyer përgjigje OE ñRSM Coò SHPK, ku është bërë me dije me mos trajtimin e ankesës pasi ajo nuk është administruar sipas rregullave të LPP, pasi ajo nuk ka ardhur në mënyrë shkresore, por nëpërmjet e-mail.

Me shkresën nr. 4147/1, datë 02.12.2020, është kthyer përgjigje OE ñLLò SHPK, ku bëhet me dije për mos pranimin e ankesës, pasi nuk qëndrojnë pretendimet e tyre.

Me shkresën nr. 4201/1 prot., datë 03.02.2020, është kthyer përgjigje OE ñI 2020ò SHPK, ku bëhet me dije se ankesa e tyre është depozituar jashtë afateve ligjore.

1.Kërkesa e pikës 2.1 për kapacitetin teknik, e cila kërkon Punë të ngjashme për 1 kontratë të vetme të së njëjtës natyrë sa 50% e fondit limit, është hartuar në kundërshtim me nenin 26,

pika 6 të VKM me nr. 914, datë 29.12.2014 ku parashikohet se “Për përvojën e mëparshme, AK kërkon punë të ngjashme për 1 objekt të vetëm me vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës.

2.Kërkesa e pikës 4 e cila ndër të tjera kërkon 1 inxhinier gjeolog, është kërkesë e paargumentuar, dhe jo në përputhje me preventivin e punimeve. Nuk ka zëra për të cilat kërkohet ekspertiza e gjeologut, ndërkohë si kriter mund të përbëjnë kufizim për OE për të paraqitur oferta në këtë procedurë.

3.Kërkesa e pikës 5, e cila kërkon 2 prej inxhinierëve të jenë të pajisur me certifikatë trajnimi përgjegjës/koordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit, përgjegjës për sigurinë në kantier, është jo në përputhje me natyrën e punës. Së pari kërkesa për 2 inxhinierë me certifikatat e mësipërme, është kufizuese, dhe specifikimi që njëra prej tyre të disponohet nga inxhinieri i ndërtimit nuk është në përputhje dhe nuk i shërben AK, dhe mund të përbëjë pengesë për OE që disponojnë staf me certifikime të tilla, por nga inxhinierë të ndryshëm.

4.Kërkesa e pikës 7 e cila kërkon 1 Topograf të mesëm, është kërkesë e dubluar dhe e tepërt, pasi për zbatimin e kësaj kontrate janë kërkuar gjithashtu edhe 2 inxhinier Topograf.

5.Kërkesa e pikës 9, e cila kërkon kategorinë e licencës NS-5A (impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut), nuk është në përputhje preventivin e punimeve. Nuk ka asnjë zë në preventiv për të kërkuar këtë kategori licence.

6. Kërkesa e pikës 8 e cila kërkon për manovratorët policën e sigurimit të aksidenteve në punë, është kërkesë e paargumentuar në ligj. Përbën kufizim për OE.

7.Kërkesa e pikës 12 për dëshminë e mjeteve dhe pajisjeve teknike, ndër të tjera ka kërkuar 2 kamionë me kapacitet 22-25 Ton, dhe 6 kamionë me kapacitet 15-18 Ton. Kjo kërkesë, e cila ka kufizuar kapacitetin mbajtës të kamionëve me një diferencë prej 3 Tonësh, nuk argumentohet nga NJP. Kërkesa të tilla nuk i shërbejnë AK, por përbëjnë kufizim për OE që plotësojnë kushtet në tërësi, por mund të penalizohen nga detaje të panevojshme të vendosura nga NJP.

8. Kërkesa e pikës 13 e cila kërkon Implant prodhim betoni me QKL, Implant prodhim inertesh me QKL, Fabrikë asfalti me QKL.... ndër të tjera kërkon që Impianti të jetë jo më larg se 50 km nga objekti, e paraqitur me plan vendosje nga një topograf vendndodhja, si dhe raport testimet e materialeve të cilat duhet të jenë e 6 muajve të fundit.

-Së pari, kërkesa që impianti të jetë jo më larg se 50 km, është kërkesë e paargumentuar dhe kufizuese. OE mund të sigurojnë cilësinë e materialit të kërkuar përtej kriterit të kilometrave, dhe kërkesa nga AK, nuk përbën gjë tjetër veçse kufizim për OE.

-Së dyti, kërkesa për raport testimet e materialeve, e cila duhet të jetë e 6 muajve të fundit, është kërkesë e cila nuk i shërben AK, dhe mund të përbëjë kufizim për OE, kjo pasi raport testimet e materialeve janë të nevojshme për punën objekt prokurimi, dhe jo raport teste të kryera me parë.

Vlerësimi i Kritereve: 1.OE në Sh-070 SHPK nuk përmbush kriterin e pikës 2.1/gj për faturat e maturuara të energjisë elektrike.

-Ky OE ka paraqitur faturën e debisë me nr. 1337, datë 02.12.2020 sipas së cilës ky OE rezulton të ketë 0 lekë detyrime deri në datën 02.12.2020, pa përfshirë faturën koherente të muajit Nëntor 2020. Në kushtet kur data e zhvillimit të tenderit është 24.12.2020, OE duhej të likuidonte faturën e maturuar të muajit Nëntor 2020 për të përmbushur kriterin e vendosur në DST.

2.OE në K.0 SHPK nuk përmbush kriterin e pikës 2.1/gj për faturat e maturuara të energjisë elektrike.

-Ky OE ka paraqitur faturën e debisë me nr. 340, datë 21.12.2020 sipas së cilës ky OE rezulton të ketë likuiduar faturat deri në muajin Tetor 2020. Në kushtet kur data e zhvillimit të tenderit është 24.12.2020 OE duhej të likuidonte faturën e maturuar të muajit Nëntor 2020 për të përmbushur kriterin e vendosur në DST.

3.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **13** *Për Fabrikë asfalti me QKL, për të cilën kërkohet ndër të tjera edhe certifikata ISO14001:2015 “Mbi certifikimin e cilësisë së asfaltit nga prodhuesi”.* OE ñSh-07ò ka paraqitur dokumentacion për fabrikën e asfaltit, por nuk disponon ISO-n e kërkuar nga NJP.

4.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **12** për mjetet kamionë me kapacitet mbajtës 22-25 Ton. Vetëm mjeti me Targa AA856AV në pronësi të OE “Sh-07” SHPK, rezulton me kapacitet 23.4 Ton, por ky mjet rezulton gjithashtu i deklaruar i dhënë me qira OE “F” SHPK në tenderin me objekt “Devijim i përroit Gegë për zgjerimin e varrezave publike” me lidhje kontrate 14.12.2020. Të gjitha mjetet tjera të deklaruar nga BOE janë poshtë kapacitetit mbajtës 22 Ton, ose mbi kapacitetin mbajtës 25Ton.

5.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **12** për mjetet kamionçinë me kapacitet mbajtës 1.5-3.5 Ton (4 copë). BOE ka paraqitur 8 mjetet kamionçina nga të cilat vetëm 2 mjetet e OE “Sh-07” SHPK si dhe 1 mjet i OE “K.” SHPK rezultojnë brenda kapacitetit të kërkuar, ndërkohë që 4 mjetet me targa AA713RO, AA216YX, AA541UV dhe AA648XL të OE “F” SHPK janë me kapacitet mbajtës nga 0.7 T deri 1.3 Ton, mjeti me targa AA784YJ i deklaruar nga OE “Sh-07” SHPK rezulton me kapacitet mbajtës 1 Ton dhe mjeti me targa AA Sa më sipër, 4 mjetet e deklaruar janë poshtë kapacitetit mbajtës prej 1.5 Ton të kërkuar nga NJP.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi:** anëtarët e NJP znj. L. K. (kryetar), z. E. A. dhe znj. A. B. (anëtar), anëtarët e KSHA znj. P. K., znj. A. E. dhe znj. L. D., si dhe anëtarët e KVO: z. S. M. (kryetar), z. F. P. dhe z. J.L. (anëtar).

Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **36,936,700 lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **36,936,700 lekë** pa SHPK. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP z. L. K., z. E. A. dhe z. F. P., anëtarët KSHA P. K., A. E. dhe L. D. është paraqitur observacioni me nr. 235/35 prot., datë 09.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 98/11, datë 12.07.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1.Në lidhje me kërkesën për punë të ngjashme sa 50% e fondit limit, NJP sqaron se kërkesa është në përputhje me nenin 26, pika 6 germa (a), pasi nuk është tejkaluar vlera 50 e fondit limit.

2. Në lidhje me kërkesën për 1 inxhinier gjeolog, NJP sqaron se Ing. Gjeolog është vendosur pasi, në objektin ku do të zhvillohet investimi dhe konkretisht në preventivin e punimeve janë parashikuar punime si punime prishje + gjërmim, punime kanalizimi KUB + KUZ punime të cilat do të kryhen në rrugën Murat Daulle, dhe mendimi i specializuar i këtij inxhinieri gjeolog si Drejtues Teknik në stafin e një shoqërie ndërtimi, është e nevojshme për realizimin me sukses të punës, për sa kohë që ajo është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës, duke garantuar njëkohësisht autoritetin kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë. Në lidhje me inxhinierin infrastrukturë transporti, NJP sqaron kjo kërkesë është e lidhur ngushtë me objektin e punës e cila është rrugë. Inxhinierët janë përgjegjës për planifikimin, projektimin dhe mbikëqyrjen e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së

projekteve të inxhinierisë civile në lidhje me rrjetet e transportit, siç janë rrugët, urat, stacionet e transitit, hekurudhat etj.

3. Në lidhje me kërkesën për 2 inxhinierë (njëri prej të cilëve inxhinier ndërtimi), të cilët duhet të kenë certifikatë trajnimit përgjegjës/koordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit, përgjegjës për sigurinë në kantier, NJP sqaron se bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10237 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", përcaktohet se punëmarrësi ngarkon një ose disa punëmarrës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë dhe shëndetit në punë të dhe parandalimit të rreziqeve profesionale...

4. Në lidhje me kërkesën për 1 topograf të mesëm, NJP sqaron se kërkesa është e bazuar në nenin 46, pika 1 germa (b) të LPP, në nenin 26, pika 8 të VKM-së nr. 914. Sipas NJP, është e nevojshme kërkesa për 1 topograf të mesëm, pasi do zbatohet detyrat e inxhinierit topograf.

5. Në lidhje me kërkesën për kategorinë NS-5A (impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut), NP sqaron se kjo kërkesë është në përputhje dhe zbatim të plotë të objektit të kontratës dhe nuk tejkalon atë se çfarë është e nevojshme nga autoriteti kontraktor, por garanton këtë të fundit që përpos punime që do zhvillohen, të krijohen dhe kushtet e përshtatshme për trafikun rrugor.

6. Në lidhje me kërkesën për 2 kamionë me kapacitet 22-25 Ton, dhe 6 kamionë me kapacitet 15-18 Ton, NJP sqaron se është bazuar në preventivin e punimeve. Mjetet e mësipërme janë të nevojshëm për sjelljen pranë objektit të kontratës për materialet e ndërtimit si psh, Mbushje me çakëll gur gurore $h = 40$ përhapje ngjeshje me makineri në sasinë 1496 m^3 , Shtrese stabilizanti 10cm në sasinë 6800 m^2 , Shtrese binderi $t=6\text{cm}$ në sasinë 6800 m^2 , Shtrese asfaltobetoni $t=4\text{cm}$ në sasinë 6800 m^2 , Kunetë betoni M-200 në sasinë 116 m^3 , për punimet e trotuarit si psh Shtrese betoni në bordurë në sasinë 20 m^3 , F.V bordura betoni $15 \times 30 \text{ cm}$ në sasinë 1360 ml , F.V. Bordurë 0.12×0.25 konturi pemëve në sasinë 400 ml , Mbushje me çakëll gur gurore $h = 20 \text{ cm}$ në sasinë 404 m^3 , Shtrese pllaka betoni $t=6\text{cm}$ në sasinë 1700 m^2 , si dhe punimet prishje + gjërmim Transport mbeturina ndërtimi, dheu deri 3km në sasinë 700 m^3 , për punime kanalizimi KUB+KUZ Gjërmim dheu kanal me makineri në sasinë 1360 m^3 , Shtrese rere natyrore $t=10\text{cm}$ në tub në sasinë 108 m^2 , F.V. tuba te brinjëzuar HDPE SN8 $d=315\text{mm}$ në sasinë 1360 ml , Mbulim kanali me cakell në sasinë 760 m^3 , Ndërtim pusetë shkarkimi $40 \times 40\text{cm}$ betoni+kapak në sasinë 60 copë e tjerë.. Autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij të kërkojë garanci nga ofertuesit për përmbushjen e të gjithë zërave të preventivit të punimeve, prandaj ka dalë në konkluzion për vendosjen e kriterit të mësipërm.

7. Në lidhje me kërkesën për impiantin e betonit, **jo më larg se 50 km nga objekti i paraqitur si dhe raport testimet e materialeve për 6 muajt e fundit**, NJP sqaron se kjo kërkesë është në përputhje me aktet ligjore të prokurimit publik. Në rastin konkret është në të drejtën e autoritetit të kërkojë garanci lidhur me mundësitë e operatorëve ekonomik për sigurimin e lëndës bazë dhe materialeve që do të përdoren për realizimin e objektit, përse kohë lejohet provueshmëria e disponimit nëpërmjet edhe kontratave të furnizimit sikurse autoriteti kontraktor ka përcaktuar në DST. Sipas NJP, kur punimet e betonit janë në volume të mëdha, AK i lind e drejta të kërkojë garanci nga ofertuesit për mënyrën e furnizimit të betonit në kantier, dhe NJP e ka parë të konsiderueshme distancën 50 km nga kantieri.

Në lidhje me raport testimet, NJP ka dhënë sërish të njëjtat qëndrime, të cilat konsistojnë në të drejtat që parashikon LPP dhe VKM nr. 914 për kërkesën e certifikatave të lëshuara, aftësitë teknike të OE, dëshmitë për mjetet dhe pajisjet teknike etj. NJP citon gjithashtu nenin 20, pika (d) të ligjit nr. 9290, datë 07.10.2004 "Për produktet e ndërtimit", sipas të cilit organi i inspektimit ndalon hedhjen e produkteve në treg në rast moskonformiteti.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 9 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO z. F. P., z. S. M. dhe z. J.L. është paraqitur observacioni me nr. 235/37 prot., datë 16.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 98/14, datë 19.07.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1.Në lidhje me likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike, KVO sqaron se OE është i detyruar që pagesën muajit paraardhës, ta bëjë deri në datën 30 të muajit pasardhës. Në këto kushte, pagesa e muajit Nëntor ka pasur afat për tu paguar deri në 31 Dhjetor 2020, dhe OE ka paraqitur faturën e muajin Tetor 2020.

2.Në lidhje me pikën certifikatën ISO 14001-2015 për fabrikën e asfaltit, KVO sqaron se vë në dispozicion të KLSH kopje të kësaj certifikate e OE “Sh-07” shpk.

3.Në lidhje me kriterin për mjetet me kapacitet 22-25 Ton dhe 1.5-3.5 Ton, KVO sqaron se ky kriter ka kufizuar pjesëmarrjen, dhe ka marrë parasysh mjete me tonazh të përafërt duke bërë që ky kriter të mos jetë s'kualifikuas.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Në lidhje me observacionit për energjinë e maturuar të energjisë elektrike pretendimi nuk qëndron. Sipas pikës 7 germa (c) të nenit 26 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, përcaktohet qartë se OE duhet të paraqesin një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike. Sa më sipër, për shkak të aplikimit në procedura të prokurimit publik, është detyrim për OE që të kryejnë likuidimin e të gjitha detyrimeve. 2.Në lidhje me pikën 3 të observacionit, pretendimi nuk qëndron. Në SPE është hedhur dokumenti **FABRIK ASFALTI ME OKL Pronesia dhe Impianti ”SH-07”.pdf** nga ku rezulton se OE nSh-070 shpk nuk ka paraqitur certifikatën ISO 14001:2015 sipas kërkesës së bërë në DST.

3.Në lidhje me pikën 4 dhe 5 të observacionit, pretendimet nuk qëndrojnë. Në DST përcaktohet qartë kapaciteti i kërkuar për mjetet kamionë. KVO nuk ka hartuar ndonjë procesverbal të veçantë për të argumentuar devijimin e konstatuar dhe arsyet se pse e ka konsideruar të kualifikueshëm mospërmbushjen e kriterit për kapacitetin e kamionëve.

V- Nga auditimi mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë Tenderi me objekt: “Rikualifikim urban i lagjes Llukan Prifti”, rezultoi problematika e shprehur me gjetjen si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr. 16:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE.

Situata: Hartimi i kriterëve: Në lidhje me kriteret e vendosura, pranë AK është paraqitur ankesë me nr. 4186 prot., datë 01.12.2020 e OE nLL0 SHPK.

1.Ky OE ankohet për kriteret e kësaj procedure, duke i krahasuar thajse identike me procedura tjera pranë këtij AK, pavarësisht se kanë diferenca në fond limit dhe në volum punimesh.

2.OE ankohet për kërkesën e lartë të numrit të kamionëve të kërkuar (8), minieskavtorë (5), kokë tërheqës (2), rimorkiator (2).

3.OE ankohet për kërkesën e policës së sigurimit për manovratorët si të paargumentuar. Në lidhje me këtë ankesë, me urdhër nr. 54, datë 01.12.2020 është pezulluar procedura, dhe me urdhrin nr. 374 të kësaj datë, është ngritur KSHA e përbërë nga P. K., E. A. dhe L. D.. Me vendimin nr. 59, datë 03.12.2020, KSHA ka vendosur mos pranimin e ankesës si të pabazuar, dhe me shkresën nr. 4186/1 prot., datë 03.12.2020 është kthyer përgjigje OE.

1.Kërkesa e pikës **2.1** për kapacitetin teknik, e cila kërkon *Punë të ngjashme për 1 kontratë të vetme të së njëjtës natyrë sa 50% e fondit limit*, është hartuar në kundërshtim me nenin 26, pika 6 të VKM me nr. 914, datë 29.12.2014 ku parashikohet se *“Për përvojën e mëparshme, AK kërkon punë të ngjashme për 1 objekt të vetëm me vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës.*

2.Kërkesa e pikës **3** e cila kërkon një punësim mesatar jo më pak se 70 punonjës për periudhën Dhjetor 2019 i Nëntor 2020, është jo në përputhje me volumet e punës. NJP nuk ka mirë argumentuar nevojën për këtë numër të lartë stafi.

3.Kërkesa e pikës **5**, e cila kërkon 2 prej inxhinierëve të jenë të pajisur me certifikatë trajnimi përgjegjës/koordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit, përgjegjës për sigurinë në kantier, është jo në përputhje me natyrën e punës. Së pari kërkesa për 2 inxhinierë me certifikatat e mësipërme, është kufizuese, dhe specifikimi që njëra prej tyre të disponohet nga inxhinieri i ndërtimit nuk është në përputhje dhe nuk i shërben AK, por mund të përbëjë pengesë për OE që disponojnë staf me certifikime të tilla, por nga inxhinierë të ndryshëm.

4.Kërkesa e pikës **4** e cila kërkon 1 Topograf të mesëm, është kërkesë e dubluar dhe e tepërt, pasi për zbatimin e kësaj kontrate është kërkuar gjithashtu 1 inxhinier Topograf.

5.Kërkesa e pikës **9**, e cila kërkon kategorinë e licencës NS-5A (impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut), nuk është në përputhje preventivin e punimeve. Nuk ka asnjë zë në preventiv për të kërkuar këtë kategori licence.

6.Kërkesa e pikës **12** për dëshminë e mjeteve dhe pajisjeve teknike, ndër të tjera ka kërkuar 2 kamionë me kapacitet 22-25 Ton, dhe 6 kamionë me kapacitet 15-18 Ton. Kjo kërkesë, e cila ka kufizuar kapacitetin mbajtës të kamionëve me një diferencë prej 3 Tonësh, nuk argumentohet nga NJP. Kërkesa të tilla nuk i shërbejnë AK, por përbëjnë kufizim për OE që plotësojnë kushtet në tërësi, por mund të penalizohen nga detaje të panevojshme të vendosura nga NJP.

7. Kërkesa e pikës **13** e cila kërkon Impiant prodhim betoni me QKL, Impiant prodhim inertesh me QKL, Fabrikë asfalti me QKL.... ndër të tjera kërkon që Impianti të jetë jo më larg se 50 km nga objekti, e paraqitur me plan vendosje nga një topograf vendndodhja, si dhe raport testimet e materialeve të cilat duhet të jenë e 6 muajve të fundit.

-Së pari, kërkesa që impianti të jetë jo më larg se 50 km, është kërkesë e paargumentuar dhe kufizuese. OE mund të sigurojnë cilësinë e materialit të kërkuar përtej kriterit të kilometrave, dhe kërkesa nga AK, nuk përbën gjë tjetër veçse kufizim për OE.

-Së dyti, kërkesa për raport testimet e materialeve, e cila duhet të jetë e 6 muajve të fundit, është kërkesë e cila nuk i shërben AK, dhe mund të përbëjë kufizim për OE, kjo pasi raport testimet e materialeve janë të nevojshme për punën objekt prokurimi, dhe jo raport testime të kryera me parë.

Vlerësimi i Kritereve: 1.OE në SHPK nuk përmbush kriterin e pikës **8**, e cila kërkon 7 manovratorë. Ky OE, ka gjithë manovratorët të deklaruar në tenderin me objekt *“Devijim i përroit Gegë për zgjerimin e varrezave publike”*. Në kushtet kur ka marrë përsipër kryerjen e 75% të punimeve, do duhej që numri i manovratorëve të jetë në përputhje me përqindjen e marrë përsipër. Gjithashtu, me përjashtim të një manovratori, gjithë të tjerët nuk disponojnë *“Dëshmi Kualifikimi të Sigurimit Teknik”*, sipas kërkesës së NJP.

2.OE në SHPK, nuk përmbush pikën **9**, pasi nuk disponon kategorinë e licencës **NP-4C**.

3.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **12** për mjetet kamionë me kapacitet mbajtës 22-25 Ton. Vetëm mjeti me Targa AA856AV në pronësi të OE *“Sh-07” SHPK*, rezulton me kapacitet 23.4

Ton, por ky mjet rezulton gjithashtu i deklaruar i dhënë me qira OE "F" SHPK në tenderin me objekt "Devijim i përroit Gegë për zgjerimin e varrezave publike" me lidhje kontrate 14.12.2020, si dhe në tenderin me objekt "Rikonstruksion i rrugës Murat Daulle" me datë zhvillimi tenderi 24.12.2020. Të gjitha mjetet tjera të deklaruar nga BOE janë poshtë kapacitetit mbajtës 22 Ton, ose mbi kapacitetin mbajtës 25 Ton.

4. BOE nuk përmbush kriterin e pikës 12 për mjetet kamionçinë me kapacitet mbajtës 1.5-3.5 Ton (4 copë). BOE ka paraqitur 6 mjetet kamionçina nga të cilat vetëm 2 mjete të OE "Sh-07" rezultojnë brenda kapacitetit të kërkuar por rezultojnë gjithashtu të deklaruar në tenderin me objekt "Rikonstruksion i rrugës Murat Daulle" me datë zhvillimi tenderi 24.12.2020, ndërkohë që 3 mjetet me targa AA719UD, AA216YX dhe AA541UV të OE "F" SHPK janë me kapacitet mbajtës nga 0.8 T deri 0.9 Ton dhe mjeti me targa AA784YJ i deklaruar nga OE "Sh-07" SHPK rezulton me kapacitet mbajtës 1 Ton. Sa më sipër, 4 mjetet e deklaruar janë poshtë kapacitetit mbajtës prej 1.5 Ton të kërkuar nga NJP.

5. OE në SHPK nuk përmbush kriterin e pikës 12 për mjetet Grejder, Asfaltoshtruese, Autobitumatriçe, Rrul gome-hekur, Rrul hekur-hekur, Rrul ngjeshës. Ky OE, ka marrë përsipër kryerjen e 75% të punimeve, ndërkohë që nuk disponon asnjërin nga mjetet e mësipërme. Neni 74 pika 3 e VKM-së me nr. 914, datë 29.12.2014 nëPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, përcakton qartë se:

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi:** anëtarët e NJP znj L. K. (kryetar), znj. A. B. dhe znj. A. E. (anëtar), anëtarët e KSHA znj. P. K., z. E. A. dhe znj. L. D., si dhe anëtarët e KVO: z. S. M. (kryetar), z. F. P. dhe z. J.L. (anëtar).

Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike në shumën **64,303,900 lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **64,303,900 lekë** pa SHPK. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP z. L. K., z. Znj. A. B. dhe znj. A. E., anëtarët KSHA P. K., E. A. dhe L. D. është paraqitur observacioni me nr. 235/35 prot., datë 09.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 98/11, datë 12.07.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1. Në lidhje me kërkesën për punë të ngjashme sa 50% e fondit limit, NJP sqaron se kërkesa është në përputhje me nenin 26, pika 6 germa (a), pasi nuk është tejkualuar vlera 50 e fondit limit.

2. Në lidhje me kërkesën për një punësim mesatar jo më pak se 70 punonjës, NJP ka dhënë sqarime duke argumentuar dispozitat ligjore për prokurimin publik, mbi kërkesat për fuqinë punëtore që kërkon AK për OE (neni 46, pika 1 e LPP, neni 26 pika 8 germa (b) e VKM-së nr. 914). Gjithashtu NJP citon VKM nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit...." që përcakton punën me 3 turne për ndërtimin e rrugëve.

3. Në lidhje me kërkesën për 2 inxhinierë (njëri prej të cilëve inxhinier ndërtimi), të cilët duhet të kenë certifikatë trajnimi përgjegjës/koordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit, përgjegjës për sigurinë në kantier, NJP sqaron se bazuar në nenin 7 të ligjit

nr. 10237 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", përcaktohet se punëmarrësi ngarkon një ose disa punëmarrës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë dhe shëndetit në punë të dhe parandalimit të rreziqeve profesionale...

4.Në lidhje me kërkesën për 1 topograf të mesëm, NJP sqaron se kërkesa është e bazuar në nenin 46, pika 1 germa (b) të LPP, në nenin 26, pika 8 të VKM-së nr. 914. Sipas NJP, është e nevojshme kërkesa për 1 topograf të mesëm, pasi do zbatohet detyrat e inxhinierit topograf.

5.Në lidhje me kërkesën për kategorinë NS-5A (impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut), NP sqaron se kjo kërkesë është në përputhje dhe zbatim të plotë të objektit të kontratës dhe nuk tejkalon atë se çfarë është e nevojshme nga autoriteti kontraktor, por garanton këtë të fundit që përpos punime që do zhvillohen, të krijohen dhe kushtet e përshtatshme për trafikun rrugor.

6.Në lidhje me kërkesën për 2 kamionë me kapacitet 22-25 Ton, dhe 6 kamionë me kapacitet 15-18 Ton, NJP sqaron se është bazuar në preventivin e punimeve. Mjetet e mësipërme janë të nevojshëm për sjelljen pranë objektit të kontratës për materialet e ndërtimit si psh, Mbushje me çakëll gur guror $h = 40$ përhapje ngjeshje me makineri në sasinë 1496 m^3 , Shtrese stabilizanti 10cm në sasinë 6800 m^2 , Shtrese binderi $t=6\text{cm}$ në sasinë 6800 m^2 , Shtrese asfaltbetoni $t=4\text{cm}$ në sasinë 6800 m^2 , Kunete betoni M-200 në sasinë 116 m^3 , për punimet e trotuarit si psh Shtrese betoni në bordurë në sasinë 20 m^3 , F V bordura betoni $15 \times 30 \text{ cm}$ në sasinë 1360 ml , F.V. Bordurë 0.12×0.25 konturi pemëve në sasinë 400 ml , Mbushje me çakëll gur guror $h = 20 \text{ cm}$ në sasinë 404 m^3 , Shtrese pllaka betoni $t=6\text{cm}$ në sasinë 1700 m^2 , si dhe punimet prishje + gjërmim Transport mbeturina ndërtimi, dheu deri 3km në sasinë 700 m^3 , për punime kanalizimi KUB+KUZ Gjërmim dheu kanal me makineri në sasinë 1360 m^3 , Shtrese rere natyrore $t=10\text{cm}$ në tub në sasinë 108 m^2 , F.V. tuba te brinjëzuar HDPE SN8 $d=315\text{mm}$ në sasinë 1360 ml , Mbulim kanal me cakell në sasinë 760 m^3 , Ndërtim pusete shkarkimi $40 \times 40\text{cm}$ betoni+kapak në sasinë 60 copë e tjerë.. Autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij të kërkojë garanci nga ofertuesit për përmbushjen e të gjithë zërave të preventivit të punimeve, prandaj ka dalë në konkluzion për vendosjen e kriterit të mësipërm.

7.Në lidhje me kërkesën për impiantin e betonit, **jo më larg se 50 km nga objekti i paraqitur si dhe raport testimet e materialeve për 6 muajt e fundit**, NJP sqaron se kjo kërkesë është në përputhje me aktet ligjore të prokurimit publik. Në rastin konkret është në të drejtën e autoritetit të kërkojë garanci lidhur me mundësitë e operatorëve ekonomik për sigurimin e lëndës bazë dhe materialeve që do të përdoren për realizimin e objektit, përse kohë lejohet provueshmëria e disponimit nëpërmjet edhe kontratave të furnizimit sikurse autoriteti kontraktor ka përcaktuar në DST. Sipas NJP, kur punimet e betonit janë në volume të mëdha, AK i lind e drejta të kërkojë garanci nga ofertuesit për mënyrën e furnizimit të betonit në kantier, dhe NJP e ka parë të konsiderueshme distancën 50 km nga kantieri.

Në lidhje me raport testimet, NJP ka dhënë sërish të njëjtat qëndrime, të cilat konsistojnë në të drejtat që parashikon LPP dhe VKM nr. 914 për kërkesën e certifikatave të lëshuara, aftësitë teknike të OE, dëshmitë për mjetet dhe pajisjet teknike etj. NJP citon gjithashtu nenin 20, pika (d) të ligjit nr. 9290, datë 07.10.2004 "Për produktet e ndërtimit", sipas të cilit organi i inspektimit ndalon hedhjen e produkteve në treg në rast moskonformiteti.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 9 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO z. F. P., z. S. M. dhe z. J.L. është paraqitur observacioni me nr. 235/37 prot., datë 16.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 98/14, datë 19.07.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1.Në lidhje me mospërmbushjen e kriterit për 7 manovratorë, KVO sqaron se kjo pikë përmbushet nga OE “Sh-07” shpk, të cilët sipas akt marrëveshjes marrin përsipër bashkëpunimin për përmbushjen e kriteredve tekniko ligjore.

2.Në lidhje me pikën 2 për mospërmbushjen e kriterin nga OE “F” shpk për kategorinë C të licencës, KVO sqaron se kjo kategori disponohet nga OE “Sh-07” shpk.

3.Në lidhje me certifikatën ISO DS/CEN/TR 1528:2005, sqarohet se OE ka paraqitur ISO 13331-1:2002 (Sisteme për veshjen e kanaleve) e cila është ekuivalent i certifikatës së kërkuar.

4. Në lidhje me kriterin për mjetet me kapacitet 22-25 Ton dhe 1.5-3.5 Ton, KVO sqaron se ky kriter ka kufizuar pjesëmarrjen, dhe ka marrë parasysh mjete me tonazh të përafërt duke bërë që ky kriter të mos jetë s’kualifikuas.

5.Në lidhje me mos disponimin e mjeteve Grejder, Asfaltoshtruese, Autobitumatriçe, Rrul me gomë, Rrul me hekur dhe Rrul ngjeshës nga OE “F” shpk, KVO sqaron se këto mjete disponohen nga OE “SH 07” shpk, dhe në këto kushte e ka konsideruar kriter të plotësuar.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Në lidhje me pikën 1 (për manovratorët), pikën 2 (për kategorinë NP-4C të licencës), dhe pikën 5 (për mjetet e rënditura më sipër), pretendimi nuk qëndron. Sipas akt marrëveshjes mes operatorëve, rezulton se OE nFò shpk ka marrë përsipër kryerjen e 75% të punimeve, dhe në këto kushte, është detyrim i saj përmbushja e kriterëve në masën e punëve që ka marrë përsipër, kjo sipas pikës 3 të nenit 74 të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014.

2.Pranohet pretendimi për pikën 2 të kërkesës, pasi OE nSh-07ò shpk disponon certifikatën ISO ekuivalente me atë të kërkuar në DST.

3.Në lidhje me pikën 4 dhe 5 të observacionit, pretendimet nuk qëndrojnë. Në DST përcaktohet qartë kapaciteti i kërkuar për mjetet kamionë. KVO nuk ka hartuar ndonjë procesverbal të veçantë për të argumentuar devijimin e konstatuar dhe arsyet se pse e ka konsideruar të kualifikueshëm mospërmbushjen e kriterit për kapacitetin e kamionëve.

Shënim: Në 3 procedura të mësipërme të vitit 2020, pavarësisht llojit të punës, vlerës dhe volumeve të saj, kërkesat e bëra nga NJP janë pothuajse identike. Në secilën procedurë kërkohen të paktën 2 inxhinierë me certifikatë trajnimi për sigurinë dhe shëndetin në punë, në secilën prej tyre kërkohet 1 topograf i mesëm pavarësisht se është kërkuar inxhinieri topograf, në 2 prej tyre kërkohet në mënyrë të paargumentuar kategoria e licencës NS-5A (Punime të sinjalistikës ndriçuese të trafikut), ndërkohë që nuk ka asnjë zë në preventiv për sinjalistikë rrugore, e aq me pak ndriçuese, në 2 prej procedurave të mësipërme, kërkesat janë identike për kamionë me kapacitet 22 deri 25 Ton, si dhe kamionë me kapacitet 15 deri 18 Ton, si dhe kërkesat identike për fabrikat apo impiantet e betonit me distancë jo më larg se 50 km, si dhe raport testimet e materialeve për 6 muajt e fundit. Vlen të përmendet gjithashtu, kërkesa e hartuar në mënyrë të gabuar për punimet e ngjashme, ku NJP e kërkon për punime sa 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës.

Në të gjitha rastet e mësipërme, OE fitues është “F” SHPK, i vetëm ose me Bashkim Operatorësh.

VI-Tenderi me objekt:“Ndërtimi i ujësjellësit për fshatrat lumas, pëllumbas, bardhaj, sheqëz, vodëz, krekëz dhe koritëz, njësia administrative lumas gjithashtu dhe ndërtimi i

pjesshëm i ujësjellësit në fshatin tapi, njësia administrative perondi, bashkia Kuçovë”, me këto të dhëna:

b. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtimi i ujësjellësit për fshatrat lumas, pëllumbas, bardhaj, sheqëz, vodëz, krekëz dhe koritëz, njësia administrative lumas gjithashtu dhe ndërtimi i pjesshëm i ujësjellësit në fshatin tapi, njësia administrative perondi, bashkia Kuçovë”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 370 datë 27.11.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 371 datë 27.11.2020 L. K./jurist kryetar E. A. anëtar D. B. anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Nr. 371 datë 27.11.2020 S. M. kryetar F. P. anëtar J. L. anëtar
2. Lloji i Procedurës “Procedurë e Hapur-Punë publike”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 361,206,231 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) OE S. 354,143,215 lekë, me lidhje kontrate 08.02.2021 me afat 18 muaj	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 7,063,016 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 05.01.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-KA	12. Përgjigje Ankesës nga AK KA	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: sëska

Procedura e prokurimit me objekt “Ndërtimi i ujësjellësit për fshatrat Lumas, Pëllumbas, Bardhaj, Sheqëz, Vodëz, Krekëz dhe Koritëz, njësia administrative lumas gjithashtu dhe ndërtimi i pjesshëm i ujësjellësit në fshatin tapi, njësia administrative perondi, bashkia Kuçovë” me fond limit 354,143,215 lekë, e shpallur me datë 27.11.2020, rezulton se data e zhvillimit të tenderit është 05.01.2021 me lidhje kontrate datë 08.02.2021. Në kushtet kur vlerësimi i kësaj procedure është kryer jashtë periudhës së auditimit e cila përfundon me 31.12.2020, ngelet për tu kontrolluar në auditimin e radhës.

Procedura te Prokurimit me vlerë të vogël

Në zbatim të pikës 6 të programi mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr.9643, datë 20.11.2016 nëPër Prokurimin Publikò i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 nëPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017; Blerjet në vlera të vogla, në bazë të Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3, datë 08.01.2018 nëPër procedurën e prokurimit me vlerë të vogëlò, Urdhri i Ministrit të Financave nr. 33, datë 11.07.2013, i ndryshuar me urdhrin nr.57, datë 12.06.2014 nëPër gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe ta lartëò; (Auditimi për zbatimin e proceduarve ligjore të prokurimit publik do të kryhet për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datën 31.12.2020).

Përbërja e komisionit për blerjet e vogla është miratuar me urdhrat e Titullarit të AK si më poshtë:

Urdhër Nr. 08, datë 03.01.2018 i Kryetarit të Bashkisë Kuçovë me përbërje:

1.L. K., në cilësinë e kryetarit të komisionit blerjeve në vlera të vogla, e ndryshuar me urdhër nr. 78, datë 09.03.2018 me z. A. O., në cilësinë e anëtarit

2.E. A., në cilësinë e anëtarit të komisionit blerjeve në vlera të vogla, i ndryshuar me urdhër nr. 78, datë 09.03.2019 në cilësinë e kryetarit.

3.A. E., në cilësinë e anëtares të komisionit blerjeve në vlera të vogla.

Për vitin 2029,

Urdhër Nr. 14, datë 25.01.2019 i Kryetarit të Bashkisë Kuçovë me përbërje:

1.L. K., në cilësinë e kryetarit të komisionit blerjeve në vlera të vogla.

2.E. A., në cilësinë e anëtarit të komisionit blerjeve në vlera të vogla.

3.A. E., në cilësinë e anëtares të komisionit blerjeve në vlera të vogla.

Për vitin 2020,

Urdhër Nr. 1, datë 08.01.2020 i Kryetarit të Bashkisë Kuçovë me përbërje:

1.L. K., në cilësinë e kryetarit të komisionit blerjeve në vlera të vogla.

2.E. A., në cilësinë e anëtarit të komisionit blerjeve në vlera të vogla.

3.A. E., në cilësinë e anëtares të komisionit blerjeve në vlera të vogla.

Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve

Për vitet 2018-2020, institucioni i Bashkisë Kuçovë, fondet e akorduara në artikullin 602 në Shpenzime operative i ka parashikuar në regjistrin e parashikimit të prokurimit me procedurë blerje me vlera të vogla. Regjistri i parashikimit të prokurimeve dhe regjistrat e realizimeve janë hartuar në zbatim të Neni 4, të VKM nr.914, datë 29.12.2004 në për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar, sipas formatit të bashkëlidhur Udhëzimit të APP nr.2 datë 27.01.2015 në për hartimin e regjistrit të parashikimit të prokurimit publik dhe regjistri i realizimit të prokurimit publik dhe me udhëzimin nr.01, datë 05.01.2018 në për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik Kreu I, pika 3.

Sipas regjistrave të realizimit të dërguar në APP, për vitin 2018 janë zhvilluar 40 procedura prokurimi me fond limit pa tvsh për vlerën prej 5,723,377 lekë, dhe vlerën e kontratës prej 4,961,495 lekë (87% e fondit limit), me një diferencë nga fondi limit prej 761,466 lekë.

Sipas regjistrave të realizimit të dërguar në APP, për vitin 2019 janë zhvilluar 26 procedura prokurimi me fond limit pa tvsh për vlerën prej 4,344,576 lekë, dhe vlerën e kontratës prej 3,823,858 lekë (88% e fondit limit), me një diferencë nga fondi limit prej 520,718 lekë.

Sipas regjistrave të realizimit të dërguar në APP, për vitin 2020 janë zhvilluar 31 procedura prokurimi me fond limit pa tvsh për vlerën prej 4,623,553 lekë dhe vlerën e kontratës prej 4,131,630 lekë (89% e fondit limit), me një diferencë nga fondi limit prej 490,923 lekë.

6.3 Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit.

Procedurat e zhvilluara për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020

Nr	Periudha	Nr.	Vlera në Lekë					Ecuria e Auditimit /lekë	
			Fondi limit pa tvsh	Fituesit pa tvsh	Diferenca nga fondi limit pa tvsh	Audituar Nr.	Pa audituar Nr.	Audituar në vlerë	Pa audituar në vlerë
1	01.01.2018-31.12.2018	40	5,723,377	4,961,495	761,466	18	22	4,751,713	971,664
2	01.01.2019-31.12.2019	26	4,344,576	3,823,858	520,718	11	15	3,596,421	748,155
3	01.01.2020-31.12.2020	31	4,623,553	4,131,630	490,923	13	18	3,970,022	507,431
	Gjithsej	97	14,691,506	12,916,983	1,774,523	42	55	12,318,156	2,227,250

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, duke copëzuar fondin publik, si dhe mos argumentimi i përlllogaritjes së fondit limit.

Situata: Për vitin 2018, u konstatuan mangësitë si më poshtë:

1.Në 2 raste për prokurime të së njëjtës natyrë, nga ana e Autoritetit Kontraktor, u konstatua copëzim i fondeve, dhe konkretisht *11 urdhra prokurimi të së njëjtës natyrë me objekt "Materiale për funksionimin e zyrës" me fond limit 1,650,442 lekë pa tvsh, dhe 15 urdhra prokurimi me objekte të ngjashme si ñblerje pjesë këmbimi, bateri, goma dhe shërbime të ndryshme automjeteshò, për nevojat e bashkisë dhe bordit të kullimit" me fond limit 1,711,000 lekë pa tvsh.* Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 1 dhe 8 të nenit 40 ñProcedura e prokurimit me vlerë të vogëlò, të VKM-së me nr. 914 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, si dhe pikës 3 të Udhëzimit të APP me nr. 3, datë 08.01.2018 ñMbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò, i cili përcakton se ñkjo lloj procedure do të përdoret për blerjen e një grupi mallrash, kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjashme, që kanë të njëjtin funksion kryesor apo që kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve. Përdorimi i kësaj procedure **nuk duhet parë si mundësi për shmangien e procedurave konkurruese të prokurimit. Në asnjë rast, autoritetet kontraktore nuk duhet të prokurojnë veçmas mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre, apo për shkak të funksionit kryesor**".

Për vitin 2019, u konstatuan mangësitë si më poshtë:

1.Në 2 raste për prokurime të së njëjtës natyrë, nga ana e Autoritetit Kontraktor, u konstatua copëzim i fondeve, dhe konkretisht *5 urdhra prokurimi të së njëjtës natyrë me objekt "Materiale për funksionimin e zyrës" me fond limit 1,203,000 lekë pa tvsh, dhe 8 urdhra prokurimi me objekte të ngjashme si ñblerje pjesë këmbimi, bateri, goma dhe shërbime të ndryshme automjeteshò, për nevojat e bashkisë dhe bordit të kullimit" me fond limit 1,308,000 lekë pa tvsh.* Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 1 dhe 8 të nenit 40 ñProcedura e prokurimit me vlerë të vogëlò, të VKM-së me nr. 914 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, si dhe pikës 3 të Udhëzimit të APP me nr. 3, datë 08.01.2018 ñMbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò, i cili përcakton se ñkjo lloj procedure do të përdoret për blerjen e një grupi mallrash, kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjashme, që kanë të njëjtin funksion kryesor apo që kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve. Përdorimi i kësaj procedure **nuk duhet parë si mundësi për shmangien e procedurave konkurruese të prokurimit. Në asnjë rast, autoritetet kontraktore nuk duhet të prokurojnë veçmas mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre, apo për shkak të funksionit kryesor**".

Për vitin 2020, u konstatuan mangësitë si më poshtë:

1.Në 2 raste për prokurime të së njëjtës natyrë, nga ana e Autoritetit Kontraktor, u konstatua copëzim i fondeve, dhe konkretisht *6 urdhra prokurimi të së njëjtës natyrë me objekt "Materiale për funksionimin e zyrës" me fond limit 1,125,500 lekë pa tvsh, dhe 4 urdhra prokurimi me objekte të ngjashme si ñblerje pjesë këmbimi, bateri, goma dhe shërbime të ndryshme automjeteshò, për nevojat e bashkisë dhe bordit të kullimit" me fond limit 1,144,100 lekë pa tvsh.* Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 1 dhe 8 të nenit 40 ñProcedura e prokurimit me vlerë të vogëlò, të VKM-së me nr. 914 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, si dhe pikës 3 të Udhëzimit të APP me nr. 3, datë 08.01.2018 ñMbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeò, i cili përcakton se ñkjo lloj procedure do të përdoret për blerjen e një grupi mallrash, kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjashme, që kanë të njëjtin funksion kryesor apo që kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve. Përdorimi i kësaj procedure **nuk duhet parë si mundësi për shmangien e procedurave konkurruese të prokurimit. Në asnjë rast, autoritetet kontraktore nuk duhet të prokurojnë veçmas mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre, apo për shkak të funksionit kryesor**".

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor si dhe udhëzimit të APP nr. 3, datë 08.01.2018 mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike.

Ndikimi/Efekti: Pengon konkurrencë, rrit shpenzimet administrative.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Titullari i AK, të ngrejë grupe pune me specialistë të fushës për hartimin e fondit limit mbi bazën e kërkesave të Drejtorive/Sektorëve, duke bërë grumbullimin e tyre sipas grup mallrave, dhe përcaktimin e saktë të nevojave të institucionit dhe procedurës që do zhvillohet, duke respektuar kufijtë monetarë dhe llojin e procedurës.

Për sa është trajtuar në Akt Konstatimin Nr. 10, nga anëtarët e KBV znj. L. K., znj. A. E. dhe z. E. A. dhe z. A. O. është paraqitur observacioni si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1.Në lidhje me copëzimin e fondeve, KBV sqaron se çdo vit kur miratohet buxheti dhe hartohet regjistri i parashikimit të prokurimeve publike, miratohet gjithashtu një vlerë për pjesët e këmbimit dhe riparimin e mjeteve të bordit të kullimit. Duke iu referuar mjeteve të mësipërme të cilat janë mjete të rënda dhe një pjesë e tyre të këmbimit kushton shtrenjtë, miratohet edhe një vlerë kaq e madhe për ata. Kjo vlerë miratohet gjithmonë në parim që të jenë në gjendje për çdo rast të paparashikuar që mund të ndodhë gjatë vitit. KBV sqaron se nuk mund të parashikojë defektet e mjeteve për të kryer procedurën Kërkesë për Propozim, dhe për efekt shpejtësie procedure, përdor blerjet e vogla. Brenda këtij fondi, janë parashikuar edhe pjesët e këmbimit. Ndërsa në lidhje me procedurën materiale për funksionimin e zyrës, bojëra, kompjuterë, programe kompjuterike etj, KBV sqaron se çdo vit kalendarik regjistri hartohet nga Dr. e Financës dhe Buxheti sipas kërkesave që vinë nga drejtoritë. Sipas KBV, objektet e mësipërme nuk janë brenda të njëjtës familje, të cilat AK duhet ti zhvillojë brenda një procedure të vetme.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 10 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

6.4. Auditim për zbatimin e punimeve, deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimi i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve.

Në zbatim të pikës mbi Auditimin e zbatimit të kontratave për punë publike, në Bashkinë Kuçovë, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizuan regjistrat e investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit 2018-2019-2020, ku janë realizuar **13** investime/kontrata për punë publike në vlerën **385,953,604 lekë me TVSH**, respektivisht sipas viteve:

- **Për vitin 2018:** Janë realizuar **7 (shtatë)** investime/kontrata për punë publike në vlerën **244,072,861 lekë me TVSH**.
- **Për vitin 2019:** Janë realizuar **3 (tre)** investime/kontrata për punë publike në vlerën **95,049,835 lekë me TVSH**.
- **Për vitin 2020:** Janë realizuar **3 (tre)** investime/kontrata për punë publike në vlerën **46,830,908 lekë me TVSH**.

Nga analiza e bërë, u arsyetua që si objekte me risk në realizimin e punimeve për kontratat për punë publike, të cilat janë kërkuar për t'u audituar, janë përzgjedhur në bazë të vlerës më të lartë të kontratës, llojit të objekteve të ndërtimit, zërave të punimeve të ndërtimit me risk të lartë në zbatimin e veprave ndërtimore, të rishikimit të projekteve të zbatimit si dhe të shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve për objektet e paraqitura në tabelë për periudhën e auditimit (2018-2019-2020):

Nr.	Objekti i Prokurimit	Oferta fituese (lekë pa TVSH)	Kontrata të realizuara (lekë me TVSH)	Kontrata të audituara (lekë me TVSH)	Operatori ekonomik i shpallur fitues	Data e lidhjes së kontratës	Afati i realizimit të kontratës
1	2	3	4	5	6	7	8
INVESTIME PER VITIN 2018							
1	Rikualifikim Urban i Lagjes 1 Maj	88,015,860	105,619,032	105,619,032	BOE në SHPK & A SHPK	16.01.2018	180 ditë
2	Rikonstruksioni i shkollës së mesme 5 tetori	42,664,066	51,196,879	51,196,879	BOE në SHPK & A SHPK	28.09.2018	4 muaj
3	Rikonstruksion i rrugës në E. B.0 Fshati Rreth Tapi Njësia Administrative Perondi, në Bashkinë Kuçovë.	29,461,240	35,353,488	35,353,488	BOE në SHPK & Sh-07 SHPK	24.01.2018	3 muaj
4	Rikonstruksion i ish-godinës së riparimit të mjeteve të rënda dhe magazinës së rikuperave pranë parkut të naftës.	15,920,225	19,104,270	19,104,270	BOE në SHPK & në SHPK	23.05.2018	4 muaj
5	Rikonstruksioni i objekteve të komunitetit Rom dhe Egjiptianë Kuçovë dhe banues në zona rurale	12,319,336	14,574,632	14,574,632	në SHPK	12.09.2018	2 muaj
6	Rikonstruksioni i kopshtit nr 1, Bashkia Kuçovë	6,903,243	8,283,891	8,283,891	në SHPK	11.09.2018	
7	Ndërtim shtese kati Biblioteka Kuçovë	6,053,502	9,940,669	9,940,669	në SHPK	14.11.2018	
Totali I (2018)		201,337,472	244,072,861	244,072,861			
INVESTIME PËR VITIN 2019							
1	Ndërtim i shkollës 9 vjeçare 18 Tetori	62,150,364	74,580,437	74,580,437	BOE në SHPK & në SHPK	04.07.2019	60 ditë kalendarike
2	Rehabilitim/Përforsim banesash ekzistuese të familjeve në nevojë	15,765,850	18,919,020	-	në SHPK	08.07.2019	
3	Rehabilitim/Përforsim banesash ekzistuese të familjeve në nevojë	1,291,982	1,550,378	-	në SHPK	19.12.2019	
Totali II (2019)		79,208,196	95,049,835	74,580,437			

INVESTIME PËR VITIN 2020							
1	Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pa favorizuara.	23,090,997	27,709,196	27,709,196	ñV. Kon.ò SHPK	30.09.2020	4 muaj
2	Devijimi i përroit Gege për re	14,899,900	17,879,880	-	ñFò SHPK	22.12.2020	
3	Rikonstruksion i Sheshit të shkollës 18 Tetori	1,034,860	1,241,832	1,241,760	ñFò SHPK	10.08.2020	30 ditë
Totali III (2020)		39,025,757	46,830,908	28,950,956			
Totali (I + II +III) (2018+2019+2020)		319,571,425	385,953,604	347,604,254			

Nga objektet e prokuruar për periudhën e auditimit, u konsideruan si objekte me risk dhe u vendos për t'iu audituar nga grupi i auditimit investimet/kontrata për punë publike si vijon:
Për periudhën e auditimit e auditimit (2018-2019-2020), u audituan **10 (dhjetë)** objekte të prokuruar, kontrata për punë publike në vlerën totale **347,604,254 lekë me TVSH** ose në **masën 90.06 %**, respektivisht sipas viteve:

- **Për vitin 2018**, u audituan 7 (shtatë) kontrata për punë publike në vlerën **244,072,861 lekë me TVSH** ose në **masën 100 %**.
- **Për vitin 2019**, u auditua 1(një) kontratë për punë publike në vlerën **74,580,437 lekë me TVSH** ose në **masën 78.46 %**.
- **Për vitin 2020**, u audituan 2(dy) kontrata për punë publike në vlerën **28,950,956 lekë me TVSH** ose në **masën 61.82 %**.

Nga grupi i auditimit janë audituar 10 (dhjetë) dosje teknike të objekteve të poshtëshënuar, për të cilat nga auditimi në terren rezulton të ketë përfunduar zbatimi i punimeve. Dosjet teknike të audituara nga dokumentacioni teknik dhe për ato për të cilat kanë rezultuar mangësi paraqiten si vijon:

► **Titulli i gjetjes nr.1**: Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik, për kontratën me objekt ñRikonstruksioni i ish-godinës së riparimit të mjeteve të rënda dhe magazinës së rikuperove pranë parkut të naftësò.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve, argumentuar si në tabelë.

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësi a	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
Zëri (2.37/5b)	Transport mbeturinash 5 km	M3	230	771.52	771.52	207.40	564.12	129,747
Zëri (2.401)	Lyrje me bojë sip metalike	kg	850	3	3	-	3	2,550
Totali në lekë pa TVSH								132,297

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ñPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiò, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 1807 prot, datë 23.05.2018; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 1807/1 prot, datë 23.07.2018.

Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Kuçovë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt- preventivit. Vlera prej **132,297 lekë pa TVSH**, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik

shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Kuçovë. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. F. B., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

Rëndësia : E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **132,297** lekë pa TVSH nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive ñAò SHPK & ñBò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1807 prot, datë 23.05.2018 me objekt ñRikonstruksioni i ish-godinës së riparimit të mjeteve të rënda dhe magazinës së rikuperove pranë parkut të naftësò, Bashkia Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Pretendimi i subjektit të audituar.

Nëpërmjet observacionit me nr. prot 33 datë 14.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 98/12 prot, datë 15.07.2021, nga shoqëria sipërmarrëse BOE "A" SHPK & "B" SHPK përfaqësuar nga z. A. A., janë paraqitur pretendimet se detyrimi në vlerën 132,297 lekë nuk ekziston pasi të gjitha volumet e punës të pasqyruara në situacionin përfundimtar, janë faktike të kryera në objekt dhe të argumentuara...

Observacioni për shoqërinë sipërmarrëse BOE "A" SHPK & "B" SHPK është paraqitur në KLSH edhe nga Bashkia Kuçovë me nr. 2325/2, datë 16.07.2021.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit

1. Lidhur me diferencën evolumit tek zëri i pnëve "Transport mbeturinash 5 km" sqarojmë se, diferenca 564.12 m³ nuk ka ardhur se volumet e punimeve të disa zërave dalin në sasi më të madhe sesa ato të pasqyruara në preventivin e kontratës, por riqsarojmë edhe një herë për sipërmarrësin e punimeve se:

Nga auditimi i analizës së çmimit të zërit ñPrishje mur tulleò dhe zërit ñPrishje shtresë betoniò në VKM Nr. 629, datë 15.07.2015 ñPër miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyreò, konstatohet se transporti është përfshirë si nën zë punimi brenda çmimit të analizës, si rrjedhojë zëri i punimeve transport për prishjen e murit të tullës dhe shtresave të betonit, nuk mund të paguhet 2(dy) herë përkatësisht: si nën zë punimi tek analiza e zërit 2 (2.426/1) ñPrishje mur tulle me pastrimò dhe në zërin e preventivit 6 (2.37/5b) ñTransport mbeturinashò. E njëjta situatë argumentohet edhe për zërin e preventivit 2 (2.426/3) prishje shtresë betoni. Pra, zëri ñTransport mbeturinashò është realizuar në volumn 207.4 m³ transport dhe 771.52 m³.

Pra, audituesi nuk ka kundërshtuar rritjen e volumnit, por theksojmë se volumni i transportit për zërat ñPrishje e mureveò dhe ñPrishje shtresë betoniò është i përfshirë si nën zë pune dhe nuk është e drejtë dhe nuk mund të paguhet dy herë. Për sa më sipër argumentuar, observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

2. Lidhur me zërat òHekur shirit i tokëzimitò dhe ñElektroda tokëzimiò sqarojmë se nga auditimi në objekt në prezencë të mbikëqyrërit të punimeve i cili nuk ka paraqitur observacion për këtë problematikë, nuk dukeshin fare, por bazuar në fotot bashkangjitur këtij observacioni marrim në konsideratë observacionin dh do të reflektohet në raportin e auditimit.

3. Lidhur me zërin e punës ñLyrje me bojë metalikeò sqarojmë se, kjo problematikë është konstatuar në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve i cili nuk ka paraqitur observacion. Nga auditimi në objekt rezultoi se ky zë punimi nuk është kryer fare. Sipërmarrësi i punimeve ndryshe nga sqarimi me fotografi për zërat e punëve òHekur shirit i tokëzimitò dhe ñElektroda tokëzimiò në rastin konkret nuk ka paraqitur asnjë foto për të vërtetuar realizimin e tij, prandaj observacioni nuk merret në konsideratë.

► **Titulli i gjetjes nr. 2:** Hartimi i projekteve të zbatimit pa licencën përkatëse, në kundërshtim me neni 5 të Ligjit Nr. 8402, datë 10.9.1998 nëPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar.

Situata: Nga kontrolli i bërë në dokumentet e administruara në dosje dhe verifikimi në zyrat e Bashkisë, për kontratat për punë publike:

- Rikonstruksioni i ish-godinës së riparimit të mjeteve të rënda dhe magazinës së rikuperove pranë parkut të naftës.
- Ndërtim shtesë kati Biblioteka Kuçovë.
- Rikonstruksion i sheshit shkollës 9-vjeçare 18 Tetori.
- Rikonstruksion i kopshtit nr. 1.
- Rikonstruksion i rrugës nëE. B.ò Fshati Rreth Tapi Njësia Administrative Perondi, në Bashkinë Kuçovë.
- Ndërtim i shkollës 9 vjeçare 18 Tetoriò, Bashkia Kuçovë. (Ndryshimi i projektit nga AK)
- Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të paforizuara.
- Rikonstruksioni i objekteve të komunitetit Rom dhe Egjiptian Kuçovë dhe banues në zona rurale.
- Rikualifikimi urban i lagjes 1 Maj.
- Rikonstruksion i shkollës së mesme 5 Tetori.

rezulton se grupi i punës për hartimin e projektpreventivit, nuk është i pajisur me licencën e projektimit. Ky veprim, është në kundërshtim me neni 5 të Ligjit Nr.8402, datë 10.9.1998 nëPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, sipas të cilit *Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji ndërtohen në bazë të projekteve të zbatimit të hartuara nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse. Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektitò.*

Kriteri: Veprime në kundërshtim me neni 5 të Ligjit Nr.8402, datë 10.9.1998 nëPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar.

Impakti: Si pasojë e hartimit të projekteve të zbatimit nga inxhinierë pa licenc përkatëse, është shkaktuar hartimi i projekteve jo cilësore duke u bërë shkak për rishikimin e tyre.

Shkak: Neglizhencë nga ana e inxhinierëve për t'u pajisur me licenca profesionale.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Titullari i AK dhe DPZHT dhe Kordinimit dhe Zhvillimit Strategjik.

Rëndësia : E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Kuçovë të merren masa që projekt preventivat e objekteve të planifikuar për tu zbatuar, të hartohen nga persona të pajisur me licencën përkatëse dhe nëse në administratën e bashkisë nuk gjenden persona të licencuar, shërbimi i projektimit të prokurorët në zbatim të legjislacionit të prokurimeve, me qëllim përfitimin e projekteve sa më cilësorë.

► **Titulli i gjetjes nr. 3:** Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik, për kontratën me objekt “*Ndërtim shtesë kati Biblioteka Bashkia Kuçovëò.*

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve, argumentuar si në tabelë.

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësi a	Çmimi i ofertës	Situaci oni përfun	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera

				dimtar				
Zëri (3.24 4)	Struktura monolite betoni C 20/25 (kollona + soletë)	m ³	11,494	73	73	48	25	287,350
Zëri (2.20 6/b)	Kasetë shkarkimi bakri për ullukun t=1 mm	copë	3,224	4	4	-	4	12,896
Zëri (2.20 9/b)	Ulluk shkarkimi vertikal bakri Ø120 mm	ml	5,384	32 [32 ml*538 4 lekë]	32	32 ml, në kundërshti m me specifikim et teknike [32 ml * 693 lekë]	32 [32 ml*46 91 lekë]	150,112
Totali në lekë pa TVSH								450,358

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 nëpër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 nëpër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 3871 prot, datë 14.11.2018; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 3871/1 prot, datë 14.11.2018.

Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Kuçovë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit. Vlera prej **450,358 lekë pa TVSH**, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Kuçovë. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. E. N., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

Rëndësia : E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **450,358** lekë pa TVSH nga sipërmarrësit të punimeve në ZD SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3871 prot, datë 14.11.2018 me objekt nëndërtim shtesë kati Biblioteka Kuçovë, Bashkia Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Pretendimi i subjektit të audituar.

Nëpërmjet observacionit të paraqitur nga mbikëqyrësi i punimeve Z. E. N., me nr. prot 235/33 datë 30.04.2021 (protokolluar në KLSH me nr. 98/6, datë 06.05.2021) janë paraqitur pretendimet; për të gjetur një zgjidhje të mirë teknike dhe në mënyrë që objekti të mos ngarkohej nga bashkia Kuçovë është propozuar zgjidhja që soleta të ndërtohej me trashësi 30 cm nga të cilat 20 cm do të ishin polisterol dhe 2 shtresa betoni....Polisteroli vendoset pa u kryer ngurtësimi i betonit dhe për këtë arsye polisteroli pëson zhytje në beton gjë e cila çon në rritjen e shtresës së betonit në pjesën e sipërme të soletës e cila në kushte të zakonshme shkon në 8 cm..

Oëndrimi i Grupit të Auditimit

Arsytimi i pasqyruar në observacion bie ndesh me Projektin e zbatimit të azhurnuar, sepse në pasqyrimin në librin e masave trashësia e betonit të soletës është marrë 25 cm dhe polisteroli me t=25, pra trashësia e soletës është 50 cm, ndërkohë që sipas faktit dhe sipas projektit të zbatimit soleta ka trashësinë 30 cm (25 cm polisteroli + 5 cm betoni) dhe jo siç shpreheni Ju 30 cm nga të cilat 20 cm do të ishin polisterol dhe 2 shtresa betoni me 5 cm. sa më sipër

trajtuar nuk keni sjellë argumente që vërtetojnë të kundërtën e mendimit të grupit të auditimit. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

► **Titulli i gjetjes nr. 4:** Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik, për kontratën me objekt Rikonstruksion i sheshit shkollës 9-vjeçare 18 Tetori.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve, argumentuar si në tabelë.

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësi a	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
Zëri 13(2.1 09/2	Themel e xokol betoni C 12/15	m ³	6,000	18.5	18.5	13.55	4.95	26,940
Totali në lekë pa TVSH								26,940

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 nëpër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 nëpër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 2649 prot, datë 10.08.2020; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 2649/1 prot, datë 10.08.2020.

Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Kuçovë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit. Vlera prej **26,940 lekë pa TVSH**, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Kuçovë. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. V. T., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

Rëndësia : E ulët

Rekomandime: Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **26,960 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësit të punimeve në SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2649 prot, datë 10.08.2020 me objekt Rikonstruksion i sheshit shkollës 9-vjeçare 18 Tetori, Bashkia Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Pretendimi i subjektit të audituar.

Nëpërmjet observacionit me nr. prot 2325/2 prot., datë 16.07.2021 (protokolluar në KLSH me nr. 98/12 prot., datë 19.07.2021) janë paraqitur pretendimet për rekomandimin e lënë në projekt raportin e auditimit mbi kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të objektit: "Rikonstruksion i sheshit shkollës 9-vjeçare 18 Tetori" sipas kontratës nr. 3918 prot, datë 09.11.2020 duke argumentuar me dokumente për kolaudimin dhe marrjen në dorëzim.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit

Mbas rekomandimit të lënë nga KLSH në Projekt Raportin e Auditimit, konkretisht: "Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa për zbatimin e kontratës së kolaudimit me nr. 3918 prot, datë 09.11.2020 për të realizuar kolaudimin e objektit si dhe marrjen në dorëzim nga Bashkia Kuçovë". nga AK janë paraqitur:

- Urdhri i brendshëm të Kryetarit të Bashkisë nr. 118, datë 08.06.2021 (nr. prot. 1981) për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të përkohshëm të punimeve të objektit dhe hartimin e certifikatës së përkohshme të marrjes në dorëzim të punimeve.

- Certifikatë e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve për objektin “Rikonstruksioni i sheshit të shkollës 9-vjeçare 18 Tetori” Bashkia Kuçovë. Kjo certifikatë është firmosur nga: Sipërmarrësi i punimeve “F” SHPK me drejtues ligjor Z. F. M.; Mbikëqyrësi i punimeve shoqëria “D” SHPK përfaqësuar nga Z. V. T.; Kolaudatori në Personit Fizik Znj. M. K. si dhe grupi i marrjes në dorëzim nga Bashkia Kuçovë

i përbërë nga: G. B., F. P. dhe O.Z.. Sqarojmë se akti i kolaudimit nuk iu vu në dispozicion grupit të auditimit, por bazuar në argumentet e mësipërme, observacioni merret në konsideratë dhe do të reflektohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

► **Titulli i gjetjes nr. 5:** Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik, për kontratën me objekt “**Rikonstruksion i kopshtit nr. 1**”.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve, argumentuar si në tabelë.

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësi a	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
Zëri 12(2.200/1)	Termoizolim solete me polisterol t=25 cm	M2	1400	143	143	136.4	6.6	9,240
Zëri (2.206/b)	Kasetë shkarkimi bakri për ullukun t=1 mm	copë	3,200	4	4	-	4	12,800
Zëri (2.209/b)	Ulluk shkarkimi vertikal bakri Ø120 mm	ml	5,200	12.8	12.8	12.8 në kundërshtim me specifikimet teknike [32 ml * 693 lekë]	12.8	57,689
Zëri 33 (2.383/1)	F.V Dyer të brendshme druri importi cilësi e I-rë	M2	21,000	7.2 me çmim 21,000	7.2	7.2 me çmim 14,279		48,391
Totali në lekë pa TVSH								128,120

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 në Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 në Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 3040 prot, datë 12.09.2018; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 3040/1 prot, datë 12.09.2018.

Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Kuçovë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit. Vlera prej **128,120 lekë pa TVSH**, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik

shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Kuçovë. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. V. T., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

Rëndësia : E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **128,120** lekë pa TVSH nga sipërmarrësit të punimeve JV ñDHò SHPK & ñTò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3040 prot, datë 12.09.2018 me objekt ñRikonstruksion i kopshtit nr. 1ò, Bashkia Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Pretendimi i subjektit të audituar.

Lidhur me observacionin me nr. 2322/1 prot., datë 09.07.2021, protokolluar në KLSH me nr. 98/11 prot, datë 12.07.2021, nga shoqëria sipërmarrëse “DH” përfaqësuar P/subjektin Z. L. D., sqarojmë lidhur me pretendimet mbi Auditimin e kontratës me objekt “Rikonstruksion i kopshtit nr. 1”, si vijon:

1. Zëri i punëve “Ulluk shkarkimi vertikal bakri Ø120 mm” . Zbatuesi pretendon se janë vendosur 50 ml ulluk alumini veritikal dhe horizontal dhe jan fakt në objekt. Pra pretendimi i KLSH nuk qëndron.

Qëndrimi i grupit të auditimit

1. Audituesi sqaron se nuk është shprehur se nuk është shprehur se ulluku horizontal dhe vertikal nuk është bërë, por nuk ka vendosur ulluk me material jo bakër siç është përcaktuar në specifikimet teknike me çmim më të lirë dhe nuk mendojmë se vendosja e materialeve me çmim më të lirë ka përmirësuar cilësinë e punimeve të ullukut vertikal dhe horizontal.

Përsa sipër, pretendimi i ardhur nëpërmjet observacionit, nuk merret në konsideratë.

2. Zëri i punëve “Dyer të brendshme druri importi cilësi e parë” . Zbatuesi i punimeve pretendon se lidhur me këtë zë, në këtë rast është jo sasia por çmimi nga 14,279 lekë/m² në 21,000 lekë/m², edhe ky pretendim i KLSH nuk qëndron, por është fakt që me kërkesë të Bashkisë Kuçovë është vendosur 2.2 m² më shumë dhe nuk është faturuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit

2. Nga auditimi në objekt u konstatohet se, ky zë punimi ñF.V Dyer të brendshme importi cilësi e I-rënd është realizuar në kundërshtim me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) dhe me kushtet e kontratës së nënshkruar, sepse materiali i përdorur për dyert nuk është dru, por dyert janë prodhuar me material tamburate të rimesuara (dhe jo material dru masiv i staxhionuar (dërrasë) siç është specifikuar dhe deklaruar për tû zbatuar nga sipërmarrësi i punimeve). Në fakt ky zë është realizuar në objekt sipas zërit 2.388/1 ñF.V Dyer të brendshme tamburate të rimesuara me çmim 14,279 lekë të VKM Nr. 629, datë 15.07.2015 ñPër miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre.

Sa më sipër trajtuar, ky zë pune edhe pse është realizuar në sipërfaqen 7.2 m² nuk konsiderohet punë e pakryer sipas kushteve të kontratës dhe specifikimeve teknike, për pasojë vlera 48,391 lekë pa TVSH [7.2 m² x 6,721 lekë (21,000 lek/m² sipas situacionit i 14,279 lek/m² sipas faktit] është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Përsa sipër, pretendimi i ardhur nëpërmjet observacionit, nuk merret në konsideratë.

3. Zëri i punëve “Bordura trotuari të derdhura në vend 25 x 12 cm” . Diferenca lidhur me bordurat e betonit nuk qëndron pasi me kërkesën e Bashkisë Kuçovë kjo është bërë mure betoni, pasi terreni ishte i tillë dhe për t’u bërë më i sigurt për fëmijët u kërkuar mure betoni, sasia e betonit të përdorur faktikisht është më shumë se ajo që është përcaktuar për bordurat e mësipërme.

Qëndrimi i grupit të auditimit

3. Audituesi sqaron se nga auditimi në fakt ky zë pune nuk është kryer fare, pra nuk është realizuar bordurë. Por nga auditimi në objekt pranojmë faktin se është realizuar mure betoni, por gjithsesi duhet të sqarojmë se punimet e ndërtimit në objekt nuk kryhen sipas dëshirës së sipërmarrësit apo bashkisë. këto ndryshime duhej të ishin pasqyruar në rishikimin e projekt preventivit, duke bërë zero zërin e borurës dhe duke shtuar si zë të ri murin e betonit. Gjithsesi audituesi merr në konsideratë faktin se është realizuar ky volume pune. Përsa sipër, pretendimi i ardhur nëpërmjet observacionit, merret pjesërisht në konsideratë, duke u pasqyruar në materialin e Raportit përfundimtar të auditimit.

► **Titulli i gjetjes nr. 6:** Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik, për kontratën me objekt **“Rikonstruksion i rrugës “E. B.” Fshati Rreth Tapi Njësia Administrative Perondi, në Bashkinë Kuçovë”**.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve, argumentuar si në tabelë.

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësi a	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
Zëri 7	Shtresë rëre t=10 cm nën tub	m2	276	160	160	-	160	44,083
Zëri 39	Pllaka betoni gri t=6 cm për trotuar	m ²	1,253	1,040	1,040	956.76	74.24	93,022
Zëri 40	Shtresë stabilizanti t=5 cm nën pllaka	m ²	277	1,040	1,040	956.76	74.24	20,564
Totali në lekë pa TVSH								157,669

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 nëpër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 nëpër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 297 prot, datë 24.01.2018; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 298 prot, datë 24.01.2018.

Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Kuçovë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit. Vlera prej **157,669 lekë pa TVSH**, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Kuçovë. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. E. M., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

Rëndësia : E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **157,669** lekë pa TVSH nga sipërmarrësit të punimeve JV në SHPK & Sh-07 SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3040 prot, datë 12.09.2018 me objekt Rikonstruksion i rrugës E. B. Fshati Rreth Tapi Njësia Administrative Perondi, në Bashkinë Kuçovë, Bashkia Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

6. Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit për kontratën me objekt “Ndërtim i shkollës 9 vjeçare 18 Tetori”, me të dhënat si vijon:

Të dhëna për :			
Kontratën		Mbikqyrjen	kolaudimin
Nr. 2286 Prot, datë 04.07.2019	Afati zbatimit 60 ditë	Nr. 2339 prot, datë 09.07.2019	Nr. 1227 prot, datë 09.07.2019
Vlera e kontratës 74,580,437 lekë me TVSH	Perioda e garancisë së difekteve 12 muaj	Mbikqyrësi nA AM me administrator z. E. M. me Liç. MK 2892/3	nG & L Co.ò, me licence MK. 2928/5 me administrator z. G. S.
Kontraktori nEd K.ò SHPK & nAò SHPK, përfaqësuar nga nEd K.ò SHPK me administrator z. Alfred Ibrahim	Punimet kanë filluar me datë 11.07.2019 Punimet kanë përfunduar, brenda afatit 04.03.2020	Vlera e kontratës së mbikëqyrjes 863,040 lekë me TVSH.	Vlera e kontratës së kolauditimit 91,200 lekë me TVSH.

► **Titulli i gjetjes nr. 7:** Mos zbatim i zërave të punimeve në volumet e situacionuara me pasojë dëm ekonomik, për kontratën me objekt “Ndërtim i shkollës 9 vjeçare 18 Tetori”.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatuan diferenca në volumet e zërave të punimeve, argumentuar si në tabelë.

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
1/1. 2	Prishje mur tulle pa pastrim	m ³	600	702	702	390	312	187,200
2. 2	Shtresë betoni C 7/10, t = 10 cm, nën themele	m ³	7655	74	74	49.2	24.8	189,844
Totali pa TVSH								377,044

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 nPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 nPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit Kreu II, Pika 3.2; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 2286 prot, datë 04.07.2019; Kontratën e sipërmarrjes me nr. 2339 prot, datë 09.07.2019.

Impakti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Kuçovë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit. Vlera prej **377,044 lekë pa TVSH**, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt në volumin e situacionuar, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Kuçovë. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Z. E. M., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

Rëndësia : E lartë

Rekomandime: Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **377,044 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësit të punimeve JV nEd K.ò SHPK & nAò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2286 prot, datë 04.07.2019 me objekt nNdërtimi i shkollës 9-vjeçare n18 Tetoriò, Bashkia Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Pretendimi i subjektit të audituar.

Lidhur me observacionin me pa nr. prot dhe pa datë, protokolluar në KLSH me nr. 98/8 prot, datë 24.05.2021, nga shoqëria mbikëqyrëse “A AM” dhe sipërmarrësi i punimeve “Ed K.” SHPK sqarojmë se audituesi nuk është shprehur në Projekt Raportin e Auditimit, sepse u paraqit me vonesë.

Observacioni për shoqërinë sipërmarrëse BOE “Ed K.” SHPK & “A” SHPK është paraqitur në KLSH nga Bashkia Kuçovë me nr. 2325/2, datë 16.07.2021 protokolluar në KLSH me nr. 98/12 prot, datë 19.07.2021.

Sipërmarrësi pretendon se në projekt preventiv nuk ishin parashikuar volumet e prishjes si dhe nga studimi i projektit lindnin disa nevoja për ndryshime në kuadër të përmirësimit të funksionimit të shkollës dhe të rritjes së cilësisë....

1. Lidhur me pretendimin se diferenca e volumit tek zëri i pnëve “Prishje mur tulle pa pastrim” nuk qëndron se objektit i janë bërë matje faktike dhe se objekti ekzistues ka qenë i realizuar me themele guri dhe muraturë mbajtëse, gjerësia e mureve ishte 38 cm dhe se bashku me suvatimin nga të dy anët e tij i cili për shkak të bojatisjes ndër vite kishte marrë gjerësi 45 cm. Ndaj mbeshetur në sa më sipër nuk kemi të bëjmë me diferencë të volumeve për këtë zë punimi.

Oëndrimi i grupit të auditimit

1. Nga ana e grupit të auditimit janë marrë të mirëqena gjatësitë dhe lartësitë e mureve sipas librit të masave, ndërsa trashësitë e mureve i ka llogaritur sipas vizatimeve që shoqërojnë librin e masave. Bashkëlidhur observacionit nuk gjendet asnjë dokument shoqërues (video, foto) që të kundërshtojë konstatimin e grupit të auditimit. Përsa sipër, pretendimi i ardhur nëpërmjet observacionit, nuk merret në konsideratë.

2. Zëri 2.262/1. Shtrese betoni C7/10 t = 10 cm nën themele

Gjatë germimit të themeleve dhe mbushjes me cakull u vu re prezence e ujrave nëntoksore çka e bënte aftësinë mbajtëse të tabanit të tokës të dobët, këto arsye na çuan në gjetjen e zgjidhjes teknike ku shtresa e betonit C 7/10 e parashikuar 10 cm nën themele ta bënim me trashësi 15 cm. Volume këto të paraqitura në sasi të njëjtë në librin e masave si dhe në situacionin e punimeve. Sa më sipër nuk kemi të bëjmë me diferencë të volumeve për këtë zë punimi.

Oëndrimi i grupit të auditimit

2. Nga ana e grupit të auditimit është marrë e mirëqenë trashësia e shtresës së betonit të projektit të zbatimit, e cila nuk ka asnjë ndryshim në procesverbalin e ndryshimit të volumeve, i cili nuk është i firmosur nga AK. Përsa sipër, pretendimi i ardhur nëpërmjet observacionit, nuk merret në konsideratë.

7. Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit për kontratën me objekt “**Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të paforizuar**” Bashkia Kuçovë.

Të dhëna për :			
Kontratën		Mbikëqyrjen	Kolaudimin
Nr. 3343 , Prot, datë 30.09.2020	Afati zbatimit 4 muaj	Nr. 3343/1 prot, datë 30.09.2020	Nr. 906 prot, datë 11.03.2021
Vlera e kontratës 27,709,197 lekë me TVSH	Periodha e garancisë së difekteve 12 muaj	Mbikëqyrësi nDò SHPK me administrator z. V. T.	nF. S.ò, me licence MK. 3429 dhe administrator z. S. B.
	Punimet kanë filluar me datë 13.10.2020		
Kontraktori nViante Konstruksionò SHPK me administrator z. Gjergji Bezati	Punimet kanë përfunduar, brenda afatit 11.02.2021	Vlera e kontratës së mbikëqyrjes 310,853 lekë me TVSH.	Vlera e kontratës së kolaudimit 37,302 lekë me TVSH.

Nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor si dhe nga auditimi i zbatimit të punimeve në objekt, rezultoi se:

1. Nga auditimi mbi realizimin e punimeve të ndërtimit në objektin **“Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të paforizuara** ò në prezencë të përfaqësuesit të bashkisë Kuçovë, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi se:

- Nuk ka shmangie nga projekti i zbatimit i ripunuar, në drejtimin funksional, të qëndrueshmërisë përse i përket zbatimit të zërave të punimit sipas projekt-preventivit.
- Punimet e ndërtimit sipas zërave të preventivit janë të njëjta me ato të specifikuar në kushtet e kontratës të miratuara nga projektuesi, mbikëqyrësi si dhe Autoriteti Kontraktor Bashkia Kuçovë.

2. Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë dhe të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, nuk rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e zbatimit dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

3. Punime të kryera dhe të situacionuara rezultojnë në shumën **27,709,197** lekë me TVSH ose në masën 100 % dhe janë realizuar brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

4. Në situacionin përfundimtar, nuk ka ndryshime çmimesh për zërat e punimeve të ndërtimit dhe punimet janë zbatuar në përputhshmëri me:

- Kontrata e sipërmarrjes me Nr. 3343 Prot., datë 30.09.2020.
- Kontrata e mbikëqyrjes së punimeve nr. 3343/1 prot., datë 30.09.2020.
- VKM nr. 354, datë 11.05.2016 nëPër miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim, i ndryshuar.
- UKM Nr. 3 , datë 15.2.2001 nëPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar;

8. Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit për kontratën me objekt **“Rikonstruksioni i objekteve të komunitetit Rom dhe Egjiptian Kuçovë dhe banues në zona rurale”**.

Të dhëna për :			
Kontratën		Mbikëqyrjen	Kolaudimin
Nr. 3050 , Prot, datë 12.09.2018	Afati zbatimit 2 muaj	Nr. 3050/1 prot, datë 12.09.2018	Nr. --- prot, datë ---
Vlera e kontratës 14,574,632 lekë me TVSH	Periudha e garancisë së difekteve 12 muaj	Mbikëqyrësi nëDò SHPK me administrator z. V. T. dhe Lic: MK 1676/8	-----
	Punimet kanë filluar me datë 13.09.2018	Vlera e kontratës së mbikëqyrjes 144,000 lekë me TVSH.	Vlera e kontratës së kolaudimit ---- lekë me TVSH.
Kontraktori nëDò SHPK me administrator z. Dashnor Sinanaj	Punimet kanë përfunduar, brenda afatit 13.11.2018		

Nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor si dhe nga auditimi i zbatimit të punimeve në objekt, rezultoi se:

1. Nga auditimi mbi realizimin e punimeve të ndërtimit në objektin **“Rikonstruksioni i objekteve të komunitetit Rom dhe Egjiptian Kuçovë dhe banues në zona rurale**ò në datën 04.03.2021 në prezencë të përfaqësuesit të bashkisë Kuçovë, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultoi se:

- Nuk ka shmangie nga projekti i zbatimit i ripunuar, në drejtimin funksional, të qëndrueshmërisë përse i përket zbatimit të zërave të punimit sipas projekt-preventivit.
- Punimet e ndërtimit sipas zërave të preventivit janë të njëjta me ato të specifikuar në kushtet e kontratës të miratuara nga projektuesi, mbikëqyrësi si dhe Autoriteti Kontraktor Bashkia Kuçovë.

2. Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë dhe të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit në datën 04.03.2021 në prezencë të përfaqësuesit të bashkisë Kuçovë, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, nuk rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e zbatimit dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

3. Punime të kryera dhe të situacionuara rezultojnë në shumën 14,574,632 lekë me TVSH ose në masën 100 % dhe janë realizuar brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

4. Në situacionin përfundimtar, nuk ka ndryshime çmimesh për zërat e punimeve të ndërtimit dhe punimet janë zbatuar në përputhshmëri me:

- Kontrata e sipërmarrjes me Nr. 3050 Prot, datë 12.09.2018 në Rikonstruksionin i objekteve të komunitetit Rom dhe Egjiptian Kuçovë dhe banues në zona rurale ” Kuçovë.
- Kontrata e mbikëqyrjes së punimeve nr. 3050/1 prot, datë 12.09.2018.
- VKM nr. 354, datë 11.05.2016 në Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim, i ndryshuar.
- UKM Nr. 3 , datë 15.2.2001 në Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit i ndryshuar;

9. Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit për kontratën me objekt **“Rikualifikimi urban i lagjes 1 Maj” Bashkia Kuçovë.**

Të dhëna për :			
kontratën		Mbikqyrjen	kolaudimin
Nr. 149 Prot, datë 16.01.2019	Afati zbatimit 180 ditë	Nr. 149/1 prot, datë 16.01.2019	Nr. 3313 prot, datë 30.09.2019
Vlera e kontratës 105,619,032 lekë me TVSH	Periudha e garancisë së difekteve 12 muaj	Mbikqyrësi nëL. Co.ò SHPK & nëA-St.ò SHPK përfaqësuar nga nëL. Co.ò SHPK me administrator z. A. K.	nëDò, me licence MK. 1676/8 me administrator z. V. T.
Kontraktori nëBò & nëAò SHPK, përfaqësuar nga nëBò SHPK me administrator z. G. T.	Punimet kanë filluar me datë 31.01.2019	Vlera e kontratës së mbikëqyrjes 904,271 lekë me TVSH.	Vlera e kontratës së kolaudimit ---- lekë me TVSH.
	Punimet kanë përfunduar, brenda afatit 04.09.2019		

Zbatimi i punimeve:

1. Nga auditimi mbi realizimin e punimeve të ndërtimit në objektin në Rikualifikimi urban i lagjes 1 Maj ò në prezencë të përfaqësuesit të bashkisë Kuçovë, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezulton se:

- Nuk ka shmangie nga projekti i zbatimit i ripunuar, në drejtimin funksional, të qëndrueshmërisë përsa i përket zbatimit të zërave të punimit sipas projekt-preventivit.
- Punimet e ndërtimit sipas zërave të preventivit janë të njëjta me ato të specifikuar në kushtet e kontratës të miratuara nga projektuesi, mbikëqyrësi si dhe Autoriteti Kontraktor Bashkia Kuçovë.

2. Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë dhe të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, nuk rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e zbatimit dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

3. Punime të kryera dhe të situacionuara rezultojnë në shumën 105,619,032 lekë me TVSH ose në masën 100 % dhe janë realizuar brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

4. Në situacionin përfundimtar, nuk ka ndryshime çmimesh për zërat e punimeve të ndërtimit dhe punimet janë zbatuar në përputhshmëri me:

- Kontrata e sipërmarrjes me nr. 149 prot datë 16.01.2019.
- Kontrata e mbikëqyrjes së punimeve nr. 149/1 prot, datë 16.01.2019.

- VKM nr. 354, datë 11.05.2016 nëPër miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudimò, i ndryshuar.
- UKM Nr. 3 , datë 15.2.2001 nëPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar;

10. Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit për kontratën me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme 5 Tetori” Bashkia Kuçovë.

Të dhëna për :			
kontratën		Mbikëqyrjen	Kolaudimin
Nr. 3271/1 Prot, datë 28.09.2018	Afati zbatimit 4 muaj	Nr. 3280 prot, datë 01.10.2018	Nr. 1719 prot, datë 13.05.2019
Vlera e kontratës 51,196,879 lekë me TVSH	Periodha e garancisë së difekteve 12 muaj	Mbikëqyrësi nëH.E. & S.K. 11ò SHPK me dministrator z. F. B. me Liç. MK 2018/14	nDò, me licence MK. 1676/7 me administrator z. V. T.
	Punimet kanë filluar me datë 03.10.2018		
Kontraktori BOE nëBò SHPK & nëAò SHPK përfaqësuar nga nëBò SHPK me administrator z. G. T.	Punimet kanë përfunduar, brenda afatit 15.03.2019	Vlera e kontratës së mbikëqyrjes 636,000 lekë me TVSH.	Vlera e kontratës së kolaudimit -- lekë me TVSH.

Zbatimi i punimeve:

1. Nga auditimi mbi realizimin e punimeve të ndërtimit në objektin nëRikonstruksion i shkollës së mesme 5 Tetori ò në prezencë të përfaqësuesit të bashkisë Kuçovë, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultojnë se:

- Nuk ka shmangie nga projekti i zbatimit i ripunuar, në drejtimin funksional, të qëndrueshmërisë përse i përket zbatimit të zërave të punimit sipas projekt-preventivit.
- Punimet e ndërtimit sipas zërave të preventivit janë të njëjta me ato të specifikuar në kushtet e kontratës të miratuara nga projektuesi, mbikëqyrësi si dhe Autoriteti Kontraktor Bashkia Kuçovë.

2. Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë dhe të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, nuk rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e zbatimit dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

3. Punime të kryera dhe të situacionuara rezultojnë në shumën 51,196,879 lekë me TVSH ose në masën 100 % dhe janë realizuar brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

4. Në situacionin përfundimtar, nuk ka ndryshime çmimesh për zërat e punimeve të ndërtimit dhe punimet janë zbatuar në përputhshmëri me:

- Kontrata e sipërmarrjes me nr. 3280 prot, datë 01.10.2018.
- Kontrata e mbikëqyrjes së punimeve nr. 3280 prot, datë 01.10.2018.
- VKM nr. 354, datë 11.05.2016 nëPër miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudimò, i ndryshuar.
- UKM Nr. 3 , datë 15.2.2001 nëPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar;

7. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

- Hartimi i programit (Plan veprimi) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve
- Realizimi i programit (Plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor....
- Statusi i rekomandimeve të lëna në Auditimin e mëparshëm ...

► **Titulli i gjetjes nr. 1:** Realizimi i rekomandimeve sipas plan veprimi të hartuar nga subjekti, duke pasqyruar punën e bërë dhe analizuar rekomandimet e realizuara plotësisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë realizuar.

Situata:

Gjatë auditimit rezultoi se bashkia Kuçovë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH^{ja} me shkresën nr. 54/13, datë 18.06.2018, konstatohet se disa nga masat nuk janë zbatuar ose janë në proces zbatimi, si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Kuçovë 11 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 6 masa, janë në proces zbatimi 3 masa dhe 2 masa organizative nuk janë zbatuar. (respektivisht rekomandimi nr 10 dhe 11) . Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: -Nga Drejtorët, Përgjegjëset e zyrës taksave dhe inspektorët e taksave edhe pse janë nxjerr listat e debitorëve dhe janë dërguar në zyrën e financës për tu regjistruar si debitorë, nuk janë kryer rakordime ndërmjet Drejtorisë Financës dhe Drejtorisë së Taksave. Për pasojë më datën 31.12.2017 ka një mos rakordim për më tepër në total në vlerën 14,820,840 lekë, pasi kontabiliteti pasqyron debitorë në vlerën 78,155,673 lekë, ndërsa inventarizimi i debitorëve faktik me lista paraqitet në shumën 63,334,833 lekë. Kjo ka ardhur pasi nuk është kryer rakordim periodik dhe nuk janë hapur analizat (partitarët), në kundërshtim me nenet 6 dhe 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 nëPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare të ndryshuar dhe pikën 3, të Udhëzimit Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011 nëPër menaxhimin e aseteve në sektorin publik, Kreu III, paragrafi nëDokumentimi i lëvizjeve të aktiveve.

-Me kërkesën e grupit të auditimit të KLSH-së, gjatë periudhës së auditimit, u nxorën dhe rakorduan të dhënat e debitorëve të taksave dhe tarifave vendore për periudhën nga viti 2012 deri më datën 31.12.2017, për taksat e papaguara: nga bizneset, taksa e tokës, qiraja e tokave bujqësore shtetërore të pandara, respektivisht për Bashkinë Kuçovë dhe 3 ish-komunat, aktualisht Njësitë Administrative: Kozare, Lumas dhe Perondi. Nga ky rakordim rezultoi se nga mos ndjekja e procedurave të nevojshme ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore është krijuar një e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Kuçovë në vlerën 63,335,269 lekë (pa përfshirë këtu vlerën e taksave/tarifave vendore të papaguara nga popullata e Qytetit Kuçovë si, tarifat për banesat, pastrimin, ndriçimit etj, për të cilën nga Drejtoria e Taksave nuk njihet gjendja pasi që 4 vjet nuk është bërë rakordim me Agjentin Tatimor Ujësjiellësi Berat-Kuçovë SHA (sipas Aneksëve nga numri 1 deri 4 të cilat ndodhen në Drejtorinë e Taksave Bashkia Kuçovë).

-Bashkia Kuçovë bazuar në nenin 5, shkronja (ii), neni 7 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 nëPër Procedurat Tatimore të ndryshuar, pikës 7.1 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 nëPër Procedurat Tatimore të ndryshuar, për arkëtimin e taksave vendore që në vitin 2012 ka lidhur Akt marrëveshje me Ujësjiellësi Berat Kuçovë SHA, në cilësinë e Agjentit tatimor, por deri

më datën 31.12.2017 që 3 vjet nuk ka kryer akt akordime mujore dhe vjetore për tu njohur me listën dhe gjendjen e debitorëve të cilët nuk kanë paguar taksat, kjo kryesisht për familjarët.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Drejtoria e Financës Bashkia Kuçovë, të marrin masa për kryerjen e akt-rakordimeve për debitorët e taksave për periudhën 01.01.2012 deri më datën 31.12.2017 dhe pasqyrimin e saktë në kontabilitet të tyre në vlerën prej 63,335,269 lekë, nga e cila:

- 304 subjekte biznesi në vlerën. 14,059,432 lekë.

-3687 fermerë nuk kanë paguar taksën e tokës në vlerën prej 36,887,926 lekë.

- 264 qiramarrës nuk kanë paguar vlerën e qerasë të tokave prej 12,387,731 lekë.

Gjithsejtë: 63,335,269 lekë.

Sa sipër, bazuar në nenin 70 pika 3 në drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, nga Drejtoria e Taksave të nxirren njoftim vlerësimit tatimore dhe për arkëtimin e detyrimeve të mësipërme të ndiqen rrugët e mëposhtme:

a) Tu ridërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar (Në rast mos kryerjes të urdhër bllokimeve prej bankave të njoftohet Guvernatori i Bankës Shqipërisë).

b) Ti ridërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar.

c) Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të fillojë llogaritja e gjobës në masën 0,06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më tepër se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, me ligjin nr.164/2014, datë 15.12.2014.

ç) Në se edhe pas njoftimeve zyrtare Bizneset nuk pranojnë në vite të paguajnë detyrimet, nga ana e Bashkisë (Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria Juridike) të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të Republikën e Shqipërisë miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,-Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

d) Drejtoria e Taksave në Bashkinë Kuçovë të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të familjarëve, taksës së tokës nga fermerët e 3 Njësive Administrative. Në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 19.01.2018 për zbatimin e buxhetit të vitit 2018, pika 76, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatimpaguesit familjarë dhe bizneset me Njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale (të Bashkisë) për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimit me anë të zyrës postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifave etj (Listat e debitorëve për Bashkinë Kuçovë dhe 3 Njësive Administrative gjenden pranë Drejtorisë të Ardhurave Bashkia Kuçovë, të printuara dhe në mënyrë elektronike (Aneksat nr. 1,2 ,3, 4, 5 dhe 6 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit)

e) Drejtoria e Taksave, Bashkia Kuçovë, të marrë masa për rakordimin progresiv me Ujësllësin Berat-Kuçovë SHA, për ngarkesat dhe arkëtimin e taksave vendore që nga data e lidhjes së aktmarrëveshjes dhe në vazhdim të kryejë rakordime periodike. Për familjarët të cilët rezultojnë debitorë pasi sipas akt-marrëveshjes nuk kanë paguar taksat apo tarifave tu dërgohen njoftim Vlerësimit tatimore nëpërmjet postës zyrtare.

1.2 Nga verifikimi rezultoi se: Nga Drejtoria e Tatim Taksave Për subjektet e biznesit për vitet ushtrimor 2016, 2017 janë kryer procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit në zbatim të nenit 90, 91 të ligjit nr.9920, date 19.05.2008 òPër Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, vërtetuar me shkresat si më poshtë:

Nr.912 prot., datë 16/03/2018

Nr.3587 prot., datë 24.11.2017

Nr.3777 prot., datë 24.11.2017

Nr.3913 prot., datë 11.12.2017

Nr.1290 prot., datë 24.4.2017

Nr.1037 prot., datë 03.04.2017

Në lidhje me këto shkresa të gjitha bankat të cilave ju janë derguar urdhër bllokime kanë kthyer përgjigje nëse kanë ose jo llogari bankare dhe marrjen e masës së bllokimit.

Edhe Drejtoria Rajonale e Transportit ka kthyer përgjigje për marrjen e masës së bllokimit ndaj subjekteve që janë të regjistruar pranë saj.

Bashkëlidhur keni dhe disa kopje të kësaj korrespondence.

C) Për të gjithë subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat është aplikuar gjopa në masën 0.06% bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, date 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, me ligjin nr.1 64/2014, datë 15.12.2014.

Bashkëlidhur keni edhe shkresën dërguar Drejtorisë së Financës me të gjithë subjektet debitorë me nr.740 prot, datë 27.02.2018 dhe shkresës nr. 683 prot, datë 27.02.2017.

Ç) Në rast se edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset nuk pranojnë në vite të paguajnë detyrimet, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në kodin Penal të Republikës së Shqipërisë miratuar me ligjin nr. 7859, datë 27.01.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,- Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

Në lidhje me këtë pikë Bashkia Kuçove nuk disponon ambiente për magazinimin e mallrave të sekuestruara apo konfiskuara ndaj kjo pike nuk është zbatuar. Gjithashtu në lidhje me procedimin penal Bashkia Kuçove po përgatit dosjet që t'ia përcjellim organeve kompetente.

d) Drejtoria e Taksave në Bashkinë Kuçove të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të familjarëve, taksës së tokës nga fermerët e 3 Njësive Administrative.

Po punohet intensivisht për hartimin e një regjistri të plotë të abonentëve familjarë. Do të merren të gjitha masat për arkëtimin e plotë të taksave të familjarëve dhe taksës së tokës nga fermerët.

e) Drejtoria e Taksave Bashkia Kuçovë, të marrin masa për rakordimin progresiv me Ujësjiellësin Berat-Kuçovë SHA, që nga data e lidhjes së aktmarrëveshjes dhe në vazhdim të kryejë rakordime periodike. Për familjarët të cilët rezultojnë debitorë t'atë dërgohen njoftim vlerësime tatimore nëpërmjet postës zyrtare.

Drejtoria e të Ardhurave ka kryer rakordime periodike me Ujësjiellësin Berat-Kuçovë. Bashkëlidhur po ju sjellim dhe kopje të këtyre aktrakordimeve.

Pas përfundimit të regjistrit elektronik abonentëve familjare do të merren masa për dërgimin e njoftim vlerësimit tatimor nëpërmjet postes zyrtare.

Në mënyrë të përmbledhur lista e debitorëve paraqitet si më poshtë:

Nga rekomandimi i KLSH për arkëtimin e 4268 debitorëve të taksave dhe tarifave vendore në vlerën 63,335,269 leke deri më datën 31.12.2018, janë arkëtuar nga 1651 persona /subjekte në vlerën 10.173,565 lekë, ose në masën 14.7 %, duke mbetur pa u arkëtuar më datën 31.12.2018 edhe 2617 debitorë në vlerën prej 51,973,917 lekë, nga e cila vlera prej 12,993,909 i përket 234 subjekteve debitorë Biznesi i madh dhe Biznesi i vogël, vlera 28,806,443 lekë u përket 2241 debitorëve (fermerëve) për mos pagesën e taksës së tokës bujqësore, ndërsa 142 debitorë për vlerën 11,361,1712 lekë, përfaqëson mos arkëtimin e

vlerës së qerasë për tokat bujqësore shtetërore të dhëna me qera në vitet nga ish komunat apo Bashkia Kuçovë.

Në mënyrë tabelore gjendja e debitorëve më datën 31.12.2017 të rekomanduara nga KLSH, arkëtimet gjate vitit 2018 dhe debitorët gjendje më datën 31.12.2018 paraqiten në pasqyrën e mëposhtme.

Gjithashtu gjatë vitit 2020, në kuadër të masave të rekomanduara, janë urdhëruar bllokimi i llogarive bankare me Urdhrin nr. 1923 prot., datë 18.06.2020 për subjektet e biznesit debitorë 2011-2019 për 224 subjekte biznesi vogël dhe 20 subjekte të biznesit të madh në vlerën 6,434,086 Leke, vijuar me urdhrat e bllokimit të llogarive bankare nr. 2272 prot., datë 09.07.2020 për 20 subjekte biznesi debitorë, urdhri nr. 2197 prot., datë 03.07.2020; vendosja e barrës hipotekore me urdhrin nr. 1922 prot., datë 18.06.2020 për 224 subjekte biznesi i vogël dhe 20 subjekte debitorë të biznesit të madh. Gjithashtu është bërë njoftimi dhe urdhri me shkresën nr. 3363 prot., datë 01.10.2020 për bllokim me Policinë Bashkiake, për 208 subjekte të biznesit debitorë për vitet 2011-2019. Me urdhrin nr. 3539 prot., datë 13.10.2020, është bërë bllokimi i llogarive bankare për 16 subjekte të biznesit të vogël që rezultuan debitorë për ngarkesën e detyrimeve të vitit 2020, si dhe me urdhrin nr. 4155 datë 27.11.2020 janë bërë bllokimi i llogarive bankare për 7 subjekte të biznesit të madh që rezultuan debitorë të detyrimeve të vitit 2020. *Në proces zbatimi*

6. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2016-2017 në subjektet private janë dhënë 32 Leje ndërtimi, dhe po kaq me fondet shtetërore, ndërkohë nga ana e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik i Bashkisë Kuçovë nuk janë hapur dosje për secilin subjekt, nuk ka marrë zyrtarisht nga subjektet ndërtuese dokumentacionin teknik-ligjor dhe nuk ka pajisur zbatuesin e punimeve (subjektet ndërtuese) me vërtetim për likuidimin e gjobave dhe vërtetim për plotësim ose jo të dokumentacionit tekniko-ligjor të paraqitur, në kundërshtim me nenin 9 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.2014 Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, ndryshuar me ligjin nr. 10,324, datë 23.09.2010.

Nga 32 persona të pajisur me lejë ndërtimi, nuk është zbatuar grafiku i përfundimit të objekteve, pasi në asnjë rast nuk është dorëzuar objekti në afat dhe nuk është hartuar akt kolaudimi i objekteve, ndërkohë për këto raste nga IMTV nuk janë zbatuar sanksione për dënim me gjobë apo anulimin e lejeve të ndërtimit, siç parashikohet në ligjin nr. 107/2014 datë 01.10.2014 i ndryshuar, neni 52 -Kundërvajtjet administrative shkronja (dh).

6.1 Rekomandim: Nga ana e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik i Bashkisë Kuçovë të merren masa që për 32 Lejë ndërtimi në subjekte private dhe objektet me fondet shtetërore të dhëna nga Bashkia për 2 vitet 2016-2017 dhe në vazhdim, të hapen dosje për secilin subjekt duke marrë zyrtarisht nga subjektet ndërtuese dokumentacionin teknik-ligjor dhe të pajisin zbatuesin e punimeve (subjektet ndërtuese) me vërtetim për likuidimin e gjobave dhe vërtetim për plotësim ose jo të dokumentacionit tekniko-ligjor të paraqitur, në zbatim të nenit 9 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.2014 Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, ndryshuar me ligjin nr. 10,324, datë 23.09.2010.

Nga ana e IMTV Bashkia Kuçovë të ushtrohet kontroll për përfundimin e objekteve për 32 Subjektet e pajisura me lejë ndërtimi për 2 vitet 2016-2017 dhe në rastet kur nuk është zbatuar grafiku i fillimit apo përfundimit të punimeve të objekteve, të vendosen sanksione dënim me gjobë apo anulimin e lejeve të ndërtimit, siç parashikohet në ligjin nr. 107/2014 datë 01.10.2014 i ndryshuar, neni 52 -Kundërvajtjet administrative shkronja (dh) ku parashikohet se: Shkelja e afatit të fillimit punimeve apo përfundimit të punimeve, sipas nenit 40 të këtij ligji dënohen me gjobë nga 50,000-150,000 lekë.

6.2 Nga verifikimi rezultoi se: Nga ana e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik janë hapur dosje për çdo subjekt. *Në proces zbatimi*

8. Gjetje nga auditimi. Në auditimin e kryer për administrimin e aseteve në Bashkinë Kuçovë, u konstatua se ky proces nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e nenin 8, të

ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 nëPër transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, nëPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, me pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 nëPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 nëPër përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, i ndryshuar, në mënyrë që kjo njësi vendore të mund të realizonte të ardhura nga vënia në funksion e këtyre aseteve, si dhe VKM nr. 500, datë 14.08.2001 nëPër inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore, për shkak të mos funksionalitetit të zyrës së menaxhimit të aseteve (për prona publike, objekte, toka, troje, rrugë, pyje, kullota, etj.), në kundërshtim me: kreu II nenin 6, kreu III nenin 13 pikat a, b, c të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 nëPër krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës, kreu II organizimi, Neni 6 Për menaxhimin dhe mbrojtjen e tokës. Strukturë e cila duhet të realizonte administrimin dhe menaxhimin e aseteve për marrjen në dorëzim dhe zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV-ve, për vënien në efikasitet të ndërtesave të zaptuara me sipërfaqe gjithsej 21,984 m² dhe trull me sipërfaqe 51,239 m² për plotësimin e nevojave të komunitetit dhe krijimin e të ardhurave të munguara nga mos dhënia me qira e tyre.

8.1.Rekomandimi: Bashkia Kuçovë të marrë masa për ngritjen e zyrës për administrimin dhe mbrojtjen e tokës (ZAMT) siç përcaktohet në kreu II nenin 6, kreu III nenin 13 pikat a, b, c të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 nëPër krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës, kreu II organizimi, Neni 6 Për menaxhimin dhe mbrojtjen e tokës dhe vënien në efikasitet të ndërtesave të zaptuara me sipërfaqe gjithsej 21,984 m² dhe trull me sipërfaqe 51,239 m².

8.2 Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Kuçovë ka marrë masa për ngritjen e zyrës për administrimin dhe mbrojtjen e tokës (ZAMT) me vendim nr. 89 datë 19.12.2018 e cila do të sigurojë administrimin dhe menaxhimin e aseteve. *Në proces zbatimi*

10. Gjetje nga auditimi: Në investimin me objekt Rikonstruksion i banesave të komunitet Rom në fshatin Vodës, Lumasë për të cilin është lidhur kontrata e sipërmarrjes me OE nëPsh.p.k, sipas aktit me nr. 48, Prot., datë 20.03.2013, me vlerë të kontratës 9,634,354 lekë me TVSH, nga inspektimi në objekt i 10 banesave nga 22 në total, u konstatua se në çdo njërin prej tyre punimet ishin me mangësi si dhe me diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën 762,481 lekë pa TVSH.

Gjithashtu u konstatuan se në shumë raste ka punime dhe procese apo zëra pune jo të përfunduara plotësisht duke u bërë shkak për praninë e lagështisë apo degradimin e ambienteve të banesave. Në dy raste u konstatua se volumet e punës për tualetet janë përlogaritur një herë si volume pune së bashku me volumet e shtëpisë dhe një herë si volume pune sipas zërit nëNdërtim ambient tualeti jashtë. Në disa raste dritaret ishin të pasilikonuara. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 4, 7 dhe 12 , të ligjit nr. 8402 nëPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit të ndryshuar, Udhëzimin e KM nr. 3 datë 15.02.2001 nëPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit të ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, pika 9 dhe Udhëzimin e KM nr. 1 datë 16.06.2011 nëPër disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave nëPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit, pika b, nr. 3.3 paragrafi i dytë.

10.1. Rekomandim: Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa, nëpërmjet një grupi specialistësh përkatës sipas nevojave të investimit, për verifikimin e objekteve të pa inspektuara në terren nga përfaqësuesit e KLSH-së, respektivisht objekt Rikonstruksion i banesave të komunitet Rom në fshatin Vodës, Lumasë dhe objektin Rikualifikim urban i lagjes 11 janari, Kuçovë me qëllim identifikimin si dhe arkëtimin e vlerës së punimeve për volumet e punës të likuiduara por të pakryera në fakt në 12 nga 22 banesat e pa inspektuara si dhe korrigjimin e mangësive të punimeve si pasojë e cilësisë së dobët të zbatimit në të gjitha banesat.

10.2 Rekomandim: Nga verifikimi rezultoi se: Nuk është zbatuar, me argumentin se diferenca e volumeve nuk mund te kontrollohet nga urbanistika por nga supervizori punimeve. ***Pa zbatuar***

11. Gjetje nga auditimi: KLSH ka ushtruar auditim për periudhën 2013-2015 dhe me shkresën nr. 32/6, datë 30.4.2015 ka adresuar gjetjet dhe rekomandimet në Bashkinë Kuçovë. Nga verifikimi rezultoi se deri më datën 30.03.2018, rekomandimet e dërguara nga KLSH me shkresën nr. 32/6, datë 30.04.2015, protokolluar në Bashkinë Kuçovë me nr. 51/48 dt. 06.05.2015 nga vlera e rekomanduar për masa shpërblim dëmi prej 24,941,331 lekë, është pranuar vlera 1,079,301 lekë e cila është kontabilizuar, deri më datën 16.03.2018 ishte arkëtuar vlera prej 976,666 lekë, ndërkohë nuk është pranuar vlera prej 23,862,030 lekë. Për rekomandimet e pa zbatuara me vendimin e kryetarit të KLSH-së nr.32, datë 31.03.2016 përcjellë në Bashkinë Kuçovë me shkresën nr. 1015/62 datë 05.04.2016, i është rikërkuar zbatimi i këtyre rekomandimeve z. S.K., kryetar i Bashkisë dalë pas zgjedhjeve të vitit 2015, por prej tij nuk është ndërmarrë asnjë veprim.

11.1 Rekomandim: Nga kryetari i Bashkisë Kuçovë të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin dhe arkëtimin e dëmit të shkaktuar Bashkisë Kuçovë për rekomandimet e lëna në auditin e mëparshëm dhe dërguar me shkresën e KLSH-së nr. 32/6, datë 30.04.2015, protokolluar në Bashkinë Kuçovë me nr. 51/48, datë 06.05.2015 të cilat nuk janë pranuar në 9 raste në vlerën prej 24,068,830 lekë, të analizuara në faqen 7-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

11.2 Rekomandim: Nga verifikimi rezultoi se: Nuk janë nxjerrë akte të tjera administrative. ***Pa zbatuar***

Realizimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik, nga nxjerrja e akteve administrative, regjistrimi në kontabilitet, deri në arkëtimin e shumës, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar, sipas kërkesave të pikës 2.2 të Udhëzimit nr. 1, datë 04.11.2016.

B/1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 nëPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit në 15 shkronja (b)-Të drejtat e KLSH- së, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 nëKodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë, nënenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 nëPër vetëqeverisjen vendore dhe pikën 93, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 nëPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, nga Titullari i njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e vlerës. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim arkëtimin e **vlerës 20,125,153 lekë**, nga e cila dëm ekonomik në vlerën **5,316,690 lekë** dhe të ardhura të munguara me dëm ekonomik në vlerën **14,808,463 lekë**

Në mënyrë të detajuar masat shpërblim dëmi paraqiten si më poshtë:

1.Gjetje nga auditimi:Nga verifikimi i saktësisë së pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për lejet e ndërtimit të dhëna për 2 vitet 2016-2017, rezulton se për 9 subjekte janë përlllogaritur më pak duke shkaktuar buxhetit të Bashkisë mungesë të ardhurash me dëm ekonomik në vlerën 1,339,750 lekë. Në kundërshtim me çmimet e përcaktuara në dy Udhëzimet e KM nr.4, datë 30.09.2015, nëPër entin Kombëtar të Banesave për vitin 2015 dhe Udhëzimin e KM nr.3, datë 28.12.2016, nëPër entin Kombëtar të Banesave për vitin 2016,

nenin 46-Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, të ligjit nr. 107/2014 datë 01.10.2014 i ndryshuar dhe nenin 27, të ligjit nr. 142/2015, për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 nëPër sistemimin e taksave dhe tarifave vendore.

1.1 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Kuçovë, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të merren masa për arkëtimin e vlerës taksës së ndikimit në infrastrukturë të paguar më pak për 9 subjekte në vlerën 1,339,750 lekë respektivisht:

Altin Avdyl Hysenbelliu në vlerën 1,181,059 lekë, nëS. M.ò në vlerën 19,311 lekë, nëG. A.ò në vlerën 24,640 lekë, nëI. M.ò në vlerën 9,262 lekë, nëL.S.ò në vlerën 12,516 lekë, nëA. M.ò në vlerën 16,985 lekë, nëB. D.ò në vlerën 51,995 lekë, nëM.T.ò në vlerën 8,773 lekë dhe Shogëria nëAò shpk në vlerën 15,209 lekë.

1.2 Nga verifikimi rezultoi se: të gjitha subjektet janë njoftuar : Deri më dt. 31.01.2019 kanë arkëtuar vlerën e plotë të detyrimit dy subjekteve vlerën 60,768 lekë, respektivisht: nëB. D.ò në vlerën 51,995 lekë dhe nëM.T.ò në vlerën 8,773 lekë (Mandat pagesat bashkëlidhur). *Në proces zbatimi*

3. Gjetje nga auditimi: Nga ana e ish kryetarit të komunës Lumas z. Z. S. nëpërmjet procedurës për blerje të vogla është marrë me qira mjeti tip Tip Benz me targë AA184AY për nevoja të administratës së komunës Lumas, duke lidhur kontratë me një person të palicencuar më organet tatimore në vlerën 115,000 lekë, respektivisht për vitin 2013 në vlerën 60,000 lekë/vit dhe vitin 2014 në vlerën 55,000 lekë/vit. Në fakt është paguar vlera prej 70,000 lekë, për vitin 2013 vlera 30,000 lekë dhe vitin 2014 për 40,000 lekë. Në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 nëPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar, neni 1, nëObjekti dhe qëllimiò, pika 2, germa (a, b, d, dh), neni 2 nëParimet e përzgjedhjesò dhe pikës 12 të nenit 3 të ligjit nësipërm, ku përcaktohet që: 12. Kontraktuesò, nëfurnizuesò dhe nësipërmarrës i shërbimitò është çdo person fizik,juridik apo ent publik ose grup personash dhe/ose organesh të tilla, që ofrojnë në treg si për marrjen e një ose disa punëve, furnizimin me mallra ose shërbime.

3.1 Rekomandim: Bashkia Kuçovë të nxjerrë urdhër ekzekutimin dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës 70,000 lekë nga z. Z. S. ish kryetari i komunës Lumas si urdhërues për kryerjen e 2 procedurave të prokurimit në blerje të vogla për marrjen me qira për nevoja të komunës të mjetit tip Tip Benz me targë AA184AY për vitet 2013-2014 duke lidhur kontratë me një person të palicencuar më organet tatimore.

3.2 Nga verifikimi rezultoi se: Ka dalë Urdhri i Brendshëm nr. 199, dt. 11.07.2018 dhe është dërguar njoftim detyrimi me shkresë nr. 2437 dt. 13.07.2018. Nuk ka arkëtuar brenda afatit të caktuar, pas kësaj materiali ka kaluar pranë Drejtorisë Juridike për ndjekje me shkresë nr. 3549 Prot. datë 17.10.2018. *Në proces zbatimi*

4. Gjetje nga auditimi: Përveç shkeljes së procedurës së prokurimit për marrjen me qira të mjetit tip Tip Benz me targë AA184AY, për 2 vitet 2013-2014 janë tërhequr nga magazina 3800 litra naftë në vlerën 676,840 lekë, ndërkohë magazinieri z. F. S. i cili ka qenë edhe drejtuesi i mjetit, në fletëdaljen e karburantit ka firmosur edhe si marës i karburantit (pra ja ka bërë dalje vetes vet). Fletëdaljet nuk janë pajisur me urdhër dorëzimi nga ish kryetari i komunës dhe nuk janë prerë dhe mbyllur në fund të muajit por sipas hyrjes së mallrave. Gjithashtu nuk janë administruar tollonat e karburantit si letra me vlerë. Veprime në kundërshtim me pikat 36 dhe 38 të Udhëzimit Ministrit Financave nr. 30, dt. 27.12.2011 nëPër Menaxhimin e Aktiveve të Njësive të Sektorit Publikò i ndryshuar me Udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014 dhe udhëzimin nr.11, datë 06.05.2016, kreu III nëRegjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyreò.

4.1 Rekomandim: Bashkia Kuçovë të nxjerrë urdhër ekzekutimin dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës 676,840 lekë nga z. F.S. ish magazinier i ish komunës Lumas, i cili njëherazi ka qenë edhe drejtuesi i mjetit,Tip Benz me targë AA184AY, pasi pa u pajisur me

autorizim për furnizim me karburant nga ish kryetari i Komunës, në fletëdaljen e karburantit ka firmosur edhe si marrës i karburantit (pra ja ka bërë dalje karburantit vetes vet).

4.2 Nga verifikimi rezultoi se: Ka dalë Urdhri i Brendshëm nr.202, dt. 11.07.2018 dhe është dërguar njoftim detyrimi me shkresë nr. 2435 dt. 13.07.2018. Nuk ka arkëtuar brenda afatit të caktuar, pas kësaj materiali ka kaluar pranë Drejtorisë Juridike për ndjekje me shkresë nr. 3549 Prot. datë 17.10.2018. **Në proces zbatimi**

5. Gjetje nga auditimi: Janë kryer pagesa për bonus transporti padrejtësisht për 12 muaj të periudhës dhjetor 2012-2013-shkurt 2014 nga 15,000 lekë/muaj për z. Z. S. ish kryetar i komunës Lumas, në kundërshtim me ligjin nr. 169/2013, datë 7.11.2013 nëPër disa ndryshime në ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 "Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë",i ndryshuar me ligjin nr. 169/2013 miratuar më datë 07.11.2013, me pasojë dëmin ekonomik në shumën 189,000 lekë (konstatohet se z. Z. S. ish kryetar i komunës Lumas, bonusin e transportit prej 15,000 lekë, për muajin tetor 2013 e ka marrë gabimisht 2 here, njëherë me urdhër shpenzimin nr. 121, datë 11.11.2013 për vlerën 15,000 lekë dhe përsëri me urdhër shpenzimin nr. 11, datë 05.02.2014 për vlerën 15,000 lekë.

5.1 Rekomandim: Bashkia Kuçovë të nxjerrë urdhër ekzekutimin dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës 189,000 lekë nga z. Z. S. ish kryetari i komunës Lumas për përfitimin padrejtësisht bonus transporti për 12 muaj të periudhës dhjetor 2012 -2013-shkurt 2014 nga 15,000 lekë/muaj.

5.2 Nga verifikimi rezultoi se: Ka dalë Urdhri i Brendshëm nr.28, dt. 04.02.2019 dhe është dërguar njoftim detyrimi me shkresë nr. 441/1 dt. 05.02.2019. **Në proces zbatimi**

6. Gjetje nga auditimi: Janë kryer pagesa për bonus transporti padrejtësisht për 12 muaj të periudhës dhjetor 2012 -2013 nga 15,000 lekë/muaj për z. M.H., ish kryetar i komunës Kozare, në kundërshtim me ligjin nr. 169/2013, datë 7.11.2013 nëPër disa ndryshime në ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 "Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë",i ndryshuar me ligjin nr. 169/2013 miratuar më datë 07.11.2013, me pasojë dëmin ekonomik në shumën 180,000 lekë.

6.1 Rekomandim: Bashkia Kuçovë të nxjerrë urdhër ekzekutimin dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës 180,000 lekë nga z. M. H., ish kryetar i komunës Kozar për përfitimin padrejtësisht bonus transporti për 12 muaj të periudhës dhjetor 2012 -2013-shkurt 2014 nga 15,000 lekë/muaj.

6.2 Nga verifikimi rezultoi se: Ka dalë Urdhri i Brendshëm nr.348, dt. 23.11.2018 dhe është dërguar njoftim detyrimi me shkresë nr. 2435 dt. 13.07.2018. Nuk ka arkëtuar brenda afatit të caktuar. **Në proces zbatimi**

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt nga operator ekonomik nëPò, dëm ekonomik në vlerën 1,189,730 lekë pa TVSH, në 3 objektet si më poshtë:

a. Vlerën 762,481 lekë pa TVSH, në objektin nëRikonstruksion i banesave të komunitet Rom në fshatin Vodës, Lumasò, Kuçovë, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 48, prot. datë 20.03.2013 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kuçovë dhe OE nëPòsh.p.k.

b. Vlerën 320,284 lekë pa TVSH, në objektin nëRikonstruksion i institucioneve arsimoreò, Kuçovë, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3549, prot datë 28.10.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kuçovë dhe OE nëPòsh.p.k.

c. Vlerën 106,965 lekë pa TVSH, në objektin në Mirëmbajtjen e Varrezave Publike, Bashkia Kuçovë, për sa janë situacionuar më shumë se sa janë preventivuar 3 zëra punimesh, parashikuar në nenin 8.2 të Kontratës sipërmarrjes të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Kuçovë dhe operatorit ekonomik në sh.p.k, sipas kontratës nr. 1516, prot, datë 11.05.2016 me afat 5 vite deri në 11.05.2021.

7.1. Rekomandim: Nga Bashkia Kuçovë të merren masa për arkëtimin nga operatori ekonomik në sh.p.k për vlerën 1,189,730 lekë pa TVSH, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit, në 3 objektet si më poshtë: a. për arkëtimin e vlerës 762,481 lekë pa TVSH, nga operatori ekonomik në sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 48 prot datë 20.03.2013 me objekt Rikonstruksion i banesave të komunitet Rom në fshatin Vodës, Lumasë, Kuçovë.

b. për arkëtimin e vlerës 320,284 lekë pa TVSH, nga operatori ekonomik në sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 3549, datë 28.10.2016 me objekt Rikonstruksion i institucioneve arsimore, Kuçovë.

c. për arkëtimin e vlerës 106,965 lekë, apo kryerjen e ndalesës, ndaj operatori ekonomik në sh.p.k, sipas kontratës me nr.1516, datë 11.05.2016 me afat 5 vite deri në 11.05.2021 (shumë e cila ende deri më datën 30.03.2017 nuk është likuiduar).

7.2 Nga verifikimi rezultoi se: Nga vlera e rekomanura prej 1,189,730 lekë, është arkëtuar vlera prej 106,965 lekë, kurse vlera prej 1,082,765 lekë është kërkuar bllokimi i garancisë punimeve, dhe konkretisht:

a. për arkëtimin e vlerës 762,481 lekë pa TVSH, është vendosur sekuestro për garancinë e objektit në vlerën 577,749 lekë shkresë nr.316/1 prot., dt 25.01.2019.

b. për arkëtimin e vlerës 320,284 lekë pa TVSH, është vendosur sekuestro për garancinë e objektit në vlerën 374,675 lekë shkresë nr.316/2 prot., dt 25.01.2019.

c. është arkëtuar vlera 106,965 lekë, sipas urdhër shpenzimeve 245, dt 20.03.2018 dhe 564, dt 06.07.2018 dhe është njoftuar subjekti me shkresë nr. 2317, dt 06.07.2018. *Në proces zbatimi*

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt nga operator ekonomik në dëm ekonomik në vlerën 365,885 lekë pa TVSH, në 2 objektet si më poshtë:

a. Vlerën 157,710 lekë pa TVSH, në objektin Rikonstruksioni i Rugës Kongresi i Lushnjës, Kuçovë, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3105, prot datë 21.09.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kuçovë dhe OE në sh.p.k.

b. Vlerën 208,175 lekë pa TVSH, në objektin Rehabilitim i pjesshëm Skema e Ujitjes Perondi, Kuçovë, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2015 prot datë 22.06.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kuçovë dhe OE në sh.p.k.

8.1. Rekomandim: Nga Bashkia Kuçovë të merren masa për arkëtimin nga operatori ekonomik në sh.p.k për vlerën 365,885 lekë pa TVSH, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit në 2 objektet si më poshtë:

a. Vlerën 157,710 lekë pa TVSH, nga OE në sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 3105, datë 21.09.2016 me objekt Rikonstruksioni i Rugës Kongresi i Lushnjës, Kuçovë.

b.Vlerën 208,175 lekë pa TVSH, nga OE ñZò sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2015, datë 22.06.2016, në objektin ñRehabilitim i pjesshëm Skema e Ujitjes Perondiò, Kuçovë.

8.2 Nga verifikimi rezultoi se:

a.Vlerën 157,710 lekë pa TVSH, nga OE ñZò sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 3105, datë 21.09.2016 me objekt ñRikonstruksioni i Rrugës Kongresi i Lushnjësò, Kuçovë. Për këtë objekt është vendosur sekuestro për garancinë e objektit në vlerën 189,252 lekë shkresë nr. 316/1 prot., dt. 25.01.2019. ***Në proces zbatimi***

b.Vlerën 208,175 lekë pa TVSH, nga OE ñZò sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2015, datë 22.06.2016, në objektin ñRehabilitim i pjesshëm Skema e Ujitjes Perondiò, Kuçovë.

Ka dalë Urdhri i Brendshëm nr.203, dt. 11.07.2018 dhe është dërguar njoftim detyrimi me shkresë nr. 2435 dt. 13.07.2018. Nuk ka arkëtuar brenda afatit të caktuar, pas kësaj materiali ka kaluar pranë Drejtorisë Juridike për ndjekje me shkresë nr. 3549 Prot. datë 17.10.2018. ***Në proces zbatimi***

9. Gjetje nga auditimi: Në objektin ñRikonstruksioni i shkallëve të pikës turistikeò, Kuçovë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën 363,920 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2557, prot datë 02.08.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kuçovë dhe BOE ñA.ò sh.p.k dhe ñSòsh.p.k.

9.1. Rekomandim: Nga Bashkia Kuçovë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 363,920 lekë pa TVSH nga BOE ñAò sh.p.k dhe ñSò sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2557 Prot., datë 02.08.2016 me objekt ñRikonstruksioni i shkallëve të pikës turistikeò, Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

9.2 Nga verifikimi rezultoi se: Është vendosur sekuestro për garancinë e objektit në vlerën 386,279 lekë shkresë nr. 316/3 prot., dt.25.01.2019. Rezulton se punimet janë kryer por nuk është reflektuar ndryshimi i zërit të punimit të kryer i miratuar. ***Në proces zbatimi***

10.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të bankës së ish Komunën Lumas, rezulton se sipas situacionit përfundimtar vjetor urdhër shpenzimin nr. 137,dt.03.12.2013 Fatura tatimore nr .09835273 datë 02.12.2013 urdhër shpenzimin nr. 74, dt.28.05.2015, në vleftën e situacionit përfundimtar është shtuar dhe financuar zëri i punimeve Hartim projekti+ preventiv zbatimi + projekt ide 2.5 është, pa u mbështetur në dispozitë ligjore apo nënligjore duke i likuiduar padrejtësisht më tepër edhe vlerën 872,565 dëm ekonomik pa TVSH. Akt kolaudimi datë 10.02.2015 objekti është realizuar më dt. 24.01.2015. Sipërmarrësi T dhe B shpk, mbikëqyrës i punimeve ZENIT-06 shpk Ing. Rexhep Tarba me NUIS K 61731002D dhe kolaudatore Ing.Leonora Pacili. Akt dorëzimi dt. 18.02.2015 nënshkruar nga ish kryetari i komunës Lumas z. Z. S. dhe marësve në dorëzim: ñB. C.ò, ñK. M.ò dhe ñA. Q.ò.

Në hartimin e Preventivit dhe Situacionit Përfundimtar të punimeve për objektin: Sistemim-Asfaltimi i Rrugës Fshatit Shqez-Vodez-Koritez Faza e parë Komuna Lumas nuk është mbajtur parasysh Modelit TIP i hartimit (Preventivit dhe Situacionit), përcaktuar në pikat 3. 3.1-Preventivat... dhe 3.3-Situacionet, të Udhëzimit KM nr. 01, datë16.06.2011 ñPër disa ndryshime në Udhëzimin e KM nr. 03, datë 15.02.2011 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò.

10.1.Rekomandim: Bashkia Kuçovë të nxjerrë urdhër ekzekutimin dhe të merren masa për arkëtimin e vlerës 872,565 lekë pa TVSH , nga Shoqëria ñTòdhe ñBò Sh.p.k, pasi kjo vlerë

është shtuar në preventivin e punimeve, të objektit: Sistemim-Asfaltimi i Rrugës Fshatit Sheqez-Vodez-Koritez Faza e I-rë, pa u mbështetur në dispozitë ligjore apo nënligjore dhe financuar padrejtësisht zëri i punimeve Hartim projekti+ preventiv zbatimi + projekt ide në masën 2.5 % mbi vlerën e preventivit 34,902,600 lekë.

10.2 Nga verifikimi rezultoi se: Ka dalë Urdhri i Brendshëm nr. 200, dt. 11.07.2018 dhe është dërguar njoftim detyrimi me shkresë nr. 2435 dt. 13.07.2018. Nuk ka arkëtuar brenda afatit të caktuar, pas kësaj materiali ka kaluar pranë Drejtorisë Juridike për ndjekje me shkresë nr. 3549 Prot. datë 17.10.2018. ***Në proces zbatimi***

11 Gjetje nga auditimi: Nga 2-ish Komunat Lumas dhe Perondi për periudhën 2009-2013 u janë dhënë me qira 433 qiramarësve toka bujqësore shtetërore të pandara për sipërfaqen prej 390 ha, me afat nga 10 deri 99 vjet, respektivisht: Njësia Administrative Lumas 187 ha për 181 kontrata dhe Perondi me 203 ha për 252 kontrata. Me kërkesën e grupit të auditimit të KLSH-së, gjatë periudhës së auditimit, u nxorën dhe rakorduan të dhënat për periudhën nga viti 2012 deri më datën 31.12.2017 për qiranë e tokave të pandara, respektivisht për 2 ish-komunat, aktualisht Njësitë Administrative, Lumas dhe Perondi, dhe rezultoi se 277 qiramarrës nuk kanë paguar vlerën e qerasë për të cilën u kërkuar llogaritja e kamat vonesave si e ardhur e munguar me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Kuçovë në vlerën prej 12,387,911 lekë sipas Anekset nga numri 1 deri 4.

Nga 2 ish-Komunat Lumas dhe Perondi pas reformës territoriale dhe bashkimit me Bashkinë Kuçovë, në asnjë rast për dhënien me qira për tokat shtetërore të pandara (pavarësisht se pjesa me e madhe sipërfaqes janë mbjelle me ullinj), nuk është bërë kontrolli i respektimit të kushteve të kontratës, në kundërshtim me pikën 5, shkronja (d) të Udhëzimit KM nr. 1, datë 18.07.2012 për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara.

11.1 Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Drejtoria e Financës Bashkia Kuçovë të marrin masa për njoftimin e 277 Fermerëve të cilat nuk kanë paguar vlerën e qirasë dhe kamat-vonesave në masën 1% në ditë të cilat janë parashikuar në kontratat e lidhura ndërmjet palëve gjatë periudhës 2009-2013 për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara për vlerën 12,387,911 lekë.

-Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të ngrejë një grup pune me pjesëmarrjen Drejtorisë së Taksave, Drejtorisë së Financës, Drejtorisë së Bujqësisë, Drejtorisë Juridike, Topografë, Njësi Administrative, etj., me qëllim verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në 433 kontratat e lidhura për dhënien me qira në vite të tokave bujqësore shtetërore të pandara, për sipërfaqen prej 390 ha. Krahas kësaj të kryhet edhe kontrolli i statusit juridik të tokave bujqësore të dhëna me qira (Pajisja me Certificate regjistrimi në Hipotekë, etj, në 3 Njësitë Administrative të Bashkisë Kuçovë Lumas, Perondi dhe Kozare). Përveç sipërfaqes tokës së dhënë me qira, të verifikohen edhe rastet e zaptimit të tokës, mbi sasinë e përcaktuar në kontratat dy paleshe apo zaptime toke pa asnjë lloj dokumentacioni.

11.2 Nga verifikimi rezultoi se: a-Nga vlera prej 12,387,911 lekë për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara deri momentin e verifikimit janë paguar 1,026,559 lekë nga 135 qeramarrës, duke mbetur në proces arkëtimi edhe 11,361,172 lekë.

b-Ka dalë vendimi i Kryetarit të Bashkisë me nr. 89 datë 19.12.2018 për krijimin e strukturës së ZAMT me qëllim verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në 433 kontratat e lidhura për dhënien me qira në vite të tokave bujqësore shtetërore të pandara. ***Në proces zbatimi***

12.Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Financës rezulton se nga IMTV Kuçovë nga vitet e mëparshme janë vendosur 8 gjoba vlere të cilave janë pasqyruar në kontabilitet në shumën prej 2,401,052 lekë, (pa vlerën e kamat vonesave), por edhe pse kanë kaluar mbi 2 vjet nga data e vendosjes tyre, nuk kanë filluar procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e tyre, në kundërshtim me nenin 46, të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010

òPër kundravajtjet administrative. Nga shuma e 8 vendimeve të gjobave të vendosura në vite dhe të pa arkëtuara deri më datën 16.03.2018 në vlerën 2,401,052 lekë, analizohen si më poshtë:

a-Për 2 vendime gjobash në vlerën 367,348 lekë pretendohet se janë kthyer në tituj ekzekutiv nga gjykata, në vitin 2012 (por nuk gjenden vendimet e gjykatës), pra deri më datën 30.03.2018 edhe pse kanë kaluar 7.5 vjet ende nuk janë ekzekutuar.

b-Për 2 vendime gjobash në vlerën 600,000 lekë janë kthyer në tituj ekzekutiv nga gjykata në vitin 2012 por deri më datën 30.03.2018 edhe pse kanë kaluar 7.5 vjet ende nuk janë ekzekutuar.

c-Për 4 vendime gjobash në vlerën 1,400,000 lekë, nga gjykata në vitin 2014 janë kthyer në tituj ekzekutiv, por deri më datën 30.03.2018 edhe pse kanë kaluar 5 vjet ende nuk janë ekzekutuar. Në kundërshtim me ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996,òKodi i Procedurës Civile në RSH ñ i ndryshuar, nenet 17 dhe 55- Vënia në ekzekutim, shkronja (ç) ku përcaktohet se: Vënia në ekzekutim e urdhrit të ekzekutimi bëhet brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të kreditorit.

12.1 Rekomandimi: Bashkia Kuçovë Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike,bazuar në nenet 151 dhe 152, të ñKodit Procedurës Civile në RSHò, të marin masat dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për vendimet me gjobë për ndërtimet e kundërligjshme,të vendosura për periudhën 2009-2015 në vlerën 2,401,052 lekë, (duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 òPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeveò i ndryshuar) Njëherazi të marrin masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv në zbatim të nenit 24-Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò (Sipas Pasqyrës që administron IMTV Bashkia Kuçovë).

12.2 Nga verifikimi rezultoi se: Me shkresat nr. prot. 277-287, dt.24.01.2019 është kërkuar rivendosja në afat e këtyre gjobave. *Në proces zbatimi*

13 Gjetje nga auditimi: Në 5 raste është paguar qytetari ñB. A.ò nëpërmjet xhirimit në numrin e llogarisë për shpenzime për qiranë e shkollës Bardhaj sipas kontratës nr. prot ska datë 13.02.2013 me vlerë 40,000 lekë. Urdhëruesi ish kryetari i Komunës Lumas z. Z. S. dhe kontabilistja Përgjegjës e Degës financës znj. B. D. Për këtë pagesë nuk është ndalur tatimi në burim në masën 15 %, në kundërshtim me nenin 33, pika 1, shkronja ñfò, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998òPër tatimin mbi të ardhuratò, i ndryshuar, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 19,500 lekë.

13.1 Rekomandim: Bashkia Kuçovë të nxjerrë urdhër ekzekutimin dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës 19,500 lekë nga qytetari ñB. A.ò, sa nuk ka paguar tatimin në burim për qiranë e shkollës Bardhaj sipas kontratës nr. prot ska datë 13.02.2013.

13.2 Nga verifikimi rezultoi se: Ka dalë Urdhri i Brendshëm nr. 204, dt. 11.07.2018 dhe është dërguar njoftim detyrimi me shkresë nr. 2435 dt. 13.07.2018. Nuk ka arkëtuar brenda afatit të caktuar, pas kësaj materiali ka kaluar pranë Drejtorisë Juridike për ndjekje me shkresë nr. 3549 Prot. datë 17.10.2018. *Në proces zbatimi*

C. MASAT DISIPLINORE:

C. 2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës:

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 ñKodi i Punës në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, neni 14-Masat disiplinore shkronja (b), KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Kuçovë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore

a. “Vërejtje me paralajmërim”, për 16 punonjësit e mëposhtëm.

Nga verifikimi rezultoi se deri më datën e verifikimit nga kryetari i Bashksië z. S.K. nuk është marë asnjë masë disiplinore, për të cilët KLSH rikërkon marrjen e masës në Vërejtje me paralajmërim për 16 punonjësit e mëposhtëm:

1. znj. E. G., Specialiste kontabiliteti.
2. z.L.Z., Inspektor i kontrollit borxhit e koordinimit.
3. z.D. S., Inspektore e regjistrimit dhe procedurave.
- 4.z.S. L.,Pergjegjes i agjencisë, inspektor i taksapaguesve Njesia administrative Kuçove.
5. z.T. P., Agjent tatimor.
6. z.Th. B., Agjent tatimor Njesia Kuçove.
7. z. K. M., Administrator i Njesisë Administrative Lumas.
8. znj.E. D., Mbikqyrse (Inspektore taksapaguesve) në Njësine Administrative Lumas.
9. z.F. B. Administrator i Njesisë administrative Kozare.
- 10.z.B. S. Inspektor i tatimpaguesve në Njesisë administrative Kozare. =
11. z.A. D., Administrator i Njesisë Administrative Perondi.
12. z.L. Sh., Inspektor i taksapaguesve i Njesisë Administrative Perondi.
13. z.A. D., Kryeinspektor i Inspektoratit Mbrojtjes Territorit (IMTV).
- 14.z. R. B., Inspektor (IMTV).
- 15.F. P., me detyrë Drejtor i Planifikim Zhvillim Territorit.
- 16.J.L., inspektor në IMTV Kuçovë. **Pa zbatuar**

D. MASA ADMINISTRATIVE;

d.1. Mbi gjobat e rekomanduara Agjencisë prokurimit Publik.

KLSH i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin e Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), ndaj 14 punonjësve, për procedurat e prokurimit.

Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 94, datë 19.09.2018, percjellë për në Bashkinë Kuçovë dhe KLSH-në me shkresën nr. 6312/3, datë 19.09.2018, e cila është protokolluar në Bashkinë Kuçovë me shkresën nr. 3174 prot., datë 21.09.2018 duke vendosur masa dënim me gjobë për 22 persona në vlerën në total prej 2,110,000 lekë. Deri më datën e verifikimit kanë dalë urdhrat e brendshëm për vendosje gjobe dhe janë arkëtuar gjithsej 1,510,000; lekë dhe kanë mbëtur pa arkëtuar vlera 600,000 lekë për të cilën **KLSH rikërkon arkëtimin e plotë të vlerës si vijon:**

I.Bashkia Kuçovë, për 1 punonjës si më poshtë:

1. J. L., anëtar KVO , me detyrë specialist i IMT. Me vendimin e APP nr.94, datë 19.09.2018 është gjobitur në shumën 150,000 lekë. Njoftimi i detyrimit është dërguar me shkresë me nr. 2436, dt. 17.07.2019. Pa arkëtuar.

II. Ish-komuna Lumas z. B. C., ish teknik ndërtimi, anëtar i KVO. Me vendimin e APP nr. 94, datë 19.09.2018 është gjobitur në shumën 100.000 lekë. Njoftimi i detyrimit është dërguar me shkresë me nr. 2436, dt. 17.07.2019. Pa arkëtuar.

2 znj. B. D.,ish Përgjegjëse e zyrës financës, anëtare KVO. Me vendimin e APP nr. 94, datë 19.09.2018 është gjobitur në shumën 100.000 lekë. Njoftimi i detyrimit është dërguar me shkresë me nr. 2436, dt. 17.07.2019. Pa arkëtuar.

3 z. F. K., specialist i bujqësisë, anëtar i KVO. Me vendimin e APP nr. 94, datë 19.09.2018 është gjobitur në shumën 100.000 lekë. Njoftimi i detyrimit është dërguar me shkresë me nr. 2436, dt. 17.07.2019. Pa arkëtuar.

III. Ish-komuna Kozare

1 znj. V. L. kryetar, specialiste bujqësie anëtare KVO. Me vendimin e APP nr. 94, datë 19.09.2018 është rekomanduar masë disiplinore AK.

2.z. S. M., ish specialist anëtare KVO Me vendimin e APP nr. 94, datë 19.09.2018 është rekomanduar masë disiplinore AK.

3.z. E. Gj., ish specialist, anëtare KVO Me vendimin e APP nr.94, datë 19.09.2018 është rekomanduar masë disiplinore AK.

4 J. L., me vendimin e APP nr. 108, datë 07.11.2018 është gjobitur në shumën 150.000 lekë. Njoftimi i detyrimit është dërguar me shkresë me nr. 2436, dt. 17.07.2019. Pa arkëtuar.

D.2. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit (IMTV) Bashkia Kuçovë.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenet 7 dhe 12 , Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 nëPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar dhe Udhëzimi e KM nr. 3 datë 15.02.2001 nëPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe shpjegimet dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr.183/2014 datë 01.04.2013 nëPër inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshmeò, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, nëPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, **KLSH i ka rikërkon Kryetarin të Bashkisë Kuçovë t'i kërkojë** Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë për 3 mbikëqyrës dhe 1 kolaudator punimesh, si më poshtë:

1. V. T. nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve. Nuk është bërë vendim për të gjobitur subjektin.

2. E. M. përfaqësues ligjor i subjektit nëA AMò sh.p.k. Nuk është bërë vendim për të gjobitur subjektin.

3. F. B., përfaqësues ligjor i subjektit nëH.E. & S.K.ò sh.p.k. Nuk është bërë vendim për të gjobitur subjektin.

4. L.V. nën cilësinë e kolaudatores së punimeve. Nuk është bërë vendim për të gjobitur subjektin.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga ana e IMT-së Bashkisë Kuçovë nuk ka ardhur asnjë rekomandim apo kërkesë nga ana e kryetarit të Bashkisë për vendosjen e masave administrative (gjobë) për mbikqyres dhe kolaudator punimesh.

Aktualisht nga ana e bashkisë Kuçovë është vendosur punonjës nga Drejtoria e Urbanistikës për cdo procedure prokurimi, si person përgjegjës që administron kontratën përkatëse si dhe për ndjekjen e punimeve dhe zbatimin e tyre sipas kontrates

Kriteri: Veprimet e mësipërme janë në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 nëPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetitò dhe shkresën nr. nr. 1106/8, datë 28.03.2019 nëPër zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Kuçovëò.

Impakti: Mos ndjekje të procedurave në arkëtimin e detyrimeve për masa shpërblim dëmi dhe mungesë të ardhurash në shumën **68,113 mijë lekë, nga e cila shpërblim dëmi në vlerën 16,140 mijë lekë.**

Shkaku: Përgjegjësi e strukturave drejtues, si: z. K. H., Kryetari i Bashkisë, z. S. K., ish Kryetar i Bashkisë, znj. H. Sh., Drejtore e Finance, z.G. Q., Drejtore Juridike dhe Burimeve Njerëzore, z. A.Ç., Drejtor i tatim- taksave, z. A. D. Kryeinspektor i IMTV dhe z. F. P., Drejtor i Plan. të Territorit

Rëndësia: I lartë

Për këtë rekomandojmë: Kryetari i Bashkisë Kuçovë të marrë masa dhe të analizojnë në

Bashki dhe Këshillin Bashkiak, mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 54/13, datë 18.06.2018 në *Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Kuçovë*, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e plotë të tyre, respektivisht:

a-Për **5 masa** organizative, në vlerë 51,973 mijë lekë konkretisht rekomandimet **(nr.1, 6, 8, 10, 11)**;

b-Për **12 masa shpërblim** dëmi në vlerën **16,140 mijë lekë**, për të gjitha pikat e rekomanduara;

c- Vendosjen e masës disiplinore **“Vërejtje me paralajmërim”**, për 16 punonjës që rregullojnë mardhëniet sipas nëKodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.

d- I rikërkojmë Kryetarit të Bashkisë Kuçovë t^{ai} kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrotjtjes së Territorit Vendor **të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e** masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara për **4 persona**, konkretisht:

1. **V. T.** nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

2. **E. M.** përfaqësues ligjor i subjektit **“A AM” sh.p.k.**

3. **F. B.**, përfaqësues ligjor i subjektit **“HE & SK” sh.p.k.**

4. **L. V.** nën cilësinë e kolaudatores së punimeve.

Në mënyrë tabelore të dhënat paraqiten në pasqyrën Aneks E/1, bashkëlidhur Projektraport Auditimit

8. TË NDRYSHME.

Gjatë procesit të auditimit në subjektin Bashkia Kuçovë sipas programit të auditimit nr. 98/1, datë 19.01.2021, ndryshuar me nr. 98/2 prot, datë 02.03.2021; ndryshuar me nr. 98/3 prot, datë 25.03.2021 të miratuar nga Kryetari i KLSH, nuk u konstatuan problematika specifike për t^u trajtuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile për kontratat e audituara dhe konkretisht: (Rikonstruksioni i ish-godinës së riparimit të mjeteve të rënda dhe magazinës së rikuperove pranë parkut të naftës; Ndërtim shtesë kati Biblioteka Kuçovë; Rikonstruksion i sheshit shkollës 9-vjeçare 18 Tetori; Rikonstruksion i kopshtit nr. 1; Rikonstruksion i rrugës në E. B.0 Fshati Rreth Tapi Njësia Administrative Perondi, në Bashkinë Kuçovë; Ndërtim i shkollës 9 vjeçare 18 Tetori, Bashkia Kuçovë. (Ndryshimi i projektit nga AK); Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara; Rikonstruksioni i objekteve të komunitetit Rom dhe Egjiptian Kuçovë dhe banues në zona rurale; Rikualifikimi urban i lagjes 1 Maj; Rikonstruksion i shkollës së mesme 5 Tetori), rezultoi se projekt zbatimi dhe preventivi është hartuar nga administrata e Bashkisë Kuçovë, nga inxhinierë të profileve të ndryshme të pa pajisur me licencën e projektimit. Ky veprim, është në kundërshtim me neni 5 të Ligjit Nr. 8402, datë 10.9.1998 për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën III.6/4 faqe 86-101 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë të merren masa që projekt preventivat e objekteve të planifikuar për tu zbatuar, të hartohen nga persona të pajisur me licencën përkatëse dhe nëse në administratën e bashkisë nuk gjenden persona të licencuar, shërbimi i projektimit të prokurorët në zbatim të legjislacionit të prokurimeve, me qëllim përfitimin e projekteve sa më cilësorë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2.1 Gjetje nga auditimi: Në auditimin e 12 procedurave prokurimi me vlerë kontrate 429,789 mijë lekë me TVSH, janë konstatuar shkelje në aplikimin e kriterëve jo në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP, ku kriteret nuk janë në përputhje me zërat e preventivit, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në pjesëmarrjen e ulët të OE (Më hollësisht trajtuar në pikën III.6. faqe 46-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Kuçovë, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknik dhe kriterëve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter dhe të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, duke vendosur kriterë sipas llojit të procedurës dhe dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me kriterin për përvojë të mëparshme, NJP ka bërë formulim të gabuar, ku në të gjitha rastet për punë të ngjashme për një objekt të vetëm, është kërkuar **sa 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës**, në kundërshtim me nenin 26, pika 6, germa (a) të VKM-së me nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën III.6. faqe 46-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Njësia e Prokurimit e Autoritetit Kontraktor Bashkia Kuçovë, të marrë masa për procedurat që do prokurojë në vijim, të hartojë kriterin për punë të ngjashme në

përputhje me rregullat e prokurimit publik, ku vlera e kërkuar për një objekt të vetëm duhet të jetë jo më e madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, janë konstatuar copëzime të fondeve, praktikë kjo në kundërshtim me kuadrin rregullator. Për vitin 2018 janë 11 urdhra prokurimi të së njëjtës natyrë me objekt “*Materiale për funksionimin e zyrës*”, me vlerë 1,650 mijë lekë, si dhe 15 urdhra prokurimi me objekt “*Blerje pjesë këmbimi bateri etj*” me vlerë 1,711 mijë lekë. Për vitin 2019 janë 5 urdhra prokurimi të së njëjtës natyrë me objekt “*Materiale për funksionimin e zyrës*”, me vlerë 1,203 mijë lekë, si dhe 8 urdhra prokurimi me objekt “*Blerje pjesë këmbimi bateri etj*” me vlerë 1,308 mijë lekë. Për vitin 2020 janë 6 urdhra prokurimi të së njëjtës natyrë me objekt “*Materiale për funksionimin e zyrës*”, me vlerë 1,125 mijë lekë, si dhe 4 urdhra prokurimi me objekt “*Blerje pjesë këmbimi bateri etj*” me vlerë 1,144 mijë lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.6. faqe 46-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 Rekomandimi: Titullari i AK, të ngrejë grupe pune me specialistë të fushës për hartimin e fondit limit mbi bazën e kërkesave të Drejtorive/Sektorëve, duke bërë grumbullimin e tyre sipas grup mallrave, dhe përcaktimin e saktë të nevojave të institucionit dhe procedurës që do zhvillohet, duke respektuar kufijtë monetarë dhe llojin e procedurës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, nga objektet inventari të pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 819,522,655 lekë, objektet nuk janë pajisur me titull pronësie, konkretisht sipas llogarive paraqiten si më poshtë:

-llog. 211 nëPyje plantacione, paraqiten në vlerën 0 lekë, ku në fakt janë 412 njësi të transferuara sipas vkm nr. 433 datë 08.06.2016 nëPër transferimin e në pronësi të pyjeve dhe kullotave.

-llog. 212 nëNdërtesa e konstruksione, 54 objekte me kosto historike 307,983,562 lekë.

-llog. 213 nëRrugë, rrjete, vepra ujore, 20 objekte në vlerën 517,753,292 lekë.

Për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor). Pavarësisht evidentimit të tyre në inventarin e aktiveve, dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë (*Trajtuar më hollësisht në pikën III.5. faqen 37-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1 Rekomandimi: Bashkia Kuçovë duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në AZHK dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit shoqërues në urdhër shpenzimet në ditarët e bankës, u verifikua se sipas kontratës së lidhur ndërmjet AK dhe nëBò SHPK për investimin me objekt nëRikualifikim urban i lagjes 1 Majò nënshkruar në datën 16.01.2019 me nr. 149, për vlerën 105,619,032 lekë, edhe pse janë bërë punimet dhe është marrë në dorëzim aset nëpërmjet aktit të marrjes në dorëzim në datën 10.12.2019, **ky aset nuk është kontabilizuar. Kjo ka bërë të mundur nënvlerësimin e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete,**

vepra ujore” me 105,619,032 lekë (Trajtuar më hollësisht në pikën III.5. faqe 37-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë, Drejtoria e financës dhe Buxhetit, të bëhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë 213 Rrugë, rrjete, vepra ujore për shumën **105,619,032 lekë** për vitin 2019, me mbylljen e bilancit kontabël të vitit të ardhshëm, nëse kjo vlerë vazhdon të jetë e pa kapitalizuar edhe gjatë këtij vitit ushtrimor.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi: Llogaria 215 ñMjete transporti, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Kuçovë, në fund të vitit 2018 rezulton për vlerën historike prej 21,355,928 lekë dhe në fund të vitit 2019 për vlerën historike prej 18,217,928 lekë ose me uljen në vlerën neto 3,138,000 lekë. Kjo ulje ka ardhur si rezultat i transferimit të dy makinave Automjet Benz nga Bashkia Kuçovë në kontabilitetin e Ndërmarrjes Komunale, e cila do të zotëroj asetet në vitin 2020 e në vazhdim.

Nga auditimi mbi administrimin e dokumentimi llogaria 215 ñMjete transporti" konstatohet se, 2 automjete transporti dhe 1 eskavtor me zinxhirë në vlerë historike totale prej **13.639.196 lekë** janë administruar gabimisht në llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" të trashëguara dhe të mbartura nga periudha raportuese paraardhëse 2017. (Trajtuar më hollësisht në pikën III.5. faqe 40-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë, Drejtoria e financës dhe Buxhetit, të bëhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë 215 ñMjete transporti dhe llogarisë 214 ñInstalime teknike, makineri e pajisje për vlerën **13.639.196 lekë** për vitin 2019, me mbylljen e bilancit kontabël të vitit të ardhshëm.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimi: Bashkia Kuçovë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të Klubit të Futbollit ñN.ò Sh.A. me NUIS L27509102R e cila është shoqëri aksionere me objekt ñOrganizimi i aktiviteteve sportive në fushën e futbollit... Aderimi dhe regjistrimi si klub në Federatën Shqiptare të Futbollit dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve të futbollit kombëtar dhe ndërkombëtar. Numri i aksioneve është 3,500 me vlerë nominale 1000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 3.500.000 lekë.

Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Kuçovë në ñKF N ñ Sh.A. në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2019, më konkretisht në llogarinë 26 ñPjesëmarrje në kapitalet e veta në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 ñPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 ñAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 ñTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje.

Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) 3,500,000 lekë dhe investitori është Bashkia Kuçovë.

Kjo procedurë mos pasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël **3,500,000 lekë** përbën shtrembërim të informacionit financiar (Trajtuar më hollësisht në pikën III.5. faqe 40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100 % në kapitalin aksionar të Klubit të Futbollit Naftëtari me vlerë kontabël 3,500,000 lekë në debi të llogarisë 26 ñPjesëmarrje në kapitalin e vetë dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Kuçovë nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likuiduara në 2020 por të paregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2019. Në mënyrë analitike këto fatura me kompetencë vitin 2019 dhe 2018 por të paregjistruara në dhe të likuiduara në 2020, paraqiten si më poshtë;

	Nr.Fat.	Dt. fature	Sh.Totalë	G.Punimi	Sh.Operatori	Nr.U.Shp	dt. Likuid
Besta shpk	46396177	11.04.2019	28,084,440	1,404,222	26,680,218	297	30.03.2020
Besta shpk	46396177	30.06.2019	43,196,880	2,159,844	41,037,036	989	26.10.2020
Besta shpk	46396193	06.12.2019	34,337,712	1,716,886	32,620,826	1,033	13.11.2020
Ed konstruk	217	25.10.2019	2,011,394	100,570	1,910,824	207	14.03.2020
Fled shpk	44	09.12.2019	2,594,000	129,700	2,464,300	404	29.04.2020
Fled shpk	44	09.12.2019	2,595,265	129,763	2,465,502	493	26.05.2020
Fled shpk	44	09.12.2019	497,200	24,860	472,340	596	19.06.2020
Fled shpk	44	09.12.2019	596,000	29,800	566,200	603	25.06.2020
Fled shpk	44	09.12.2019	1,698,239	84,912	566,200	704	23.07.2020
Dhjonis shpk	20	30.11.2018	2,851,602	142,580	2,709,022	201	26.02.2020
						658	13.07.2020
						1046	18.11.2020
						204	18.12.2021
Dhjonis shpk	22	28.12.2018	3,449,208	172,460	3,276,748	205	18.12.2021
						288	11.03.2021
	Totali		121,911,940	6,095,597	114,769,216		

Mosparaqitja e tyre në kontabilitet, edhe pse janë kompetencë e vitit ushtrimor 2018 dhe 2019, ka nënvlerësuar llogarinë 467 ñKreditorë të ndryshëm me **121,911,940 lekë**. Kjo procedurë mospasqyrimi në llogarinë 467 ñKreditorë të ndryshëm të detyrimeve për faturat e likuiduara në 2020 por me kompetencë vitin 2019 dhe 2018, përbën shtrembërim të informacionit financiar, duke qenë se detyrimet e prapambetura për vitin 2019 të përcjella në Ministrinë e Financave **janë nënvlerësuar me 121,911,940 lekë dhe 6,300,810 lekë për vitin 2018** (Trajtuar më hollësisht në pikën III.5. faqe 42 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, të bëhen sistemimet në kontabilitet të llogarisë 467 ñKreditorë të ndryshëm” e cila është nënvlerësuar me 121,911,940 për vitin 2019 dhe 6,300,810 lekë për vitin 2018.

Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

10. Gjetje nga auditimi: Në momentin e fillimit të inventarizimit në objekt, anëtarët e komisionit të inventarizimit në asnjë rast nuk kanë përpiluar deklarata për konflikt të interesit, nuk kanë në dispozicion listën e aktiveve për tu inventarizuar e hartuar nga nëpunësi zbatues, si dhe nuk kanë hartuar aktrakordim për të përcaktuar e fiksuar numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes së fundit e kontabilizuar. Ky komision në përfundim të procesit komisioni nuk ka bërë vlerësim mbi gjendjen cilësore dhe evidentim të secilit artikull si dhe raport për ato aktive që janë vlerësuar gjatë procesit me evidentim (jashtë përdorimi) me qellim për t'u nxjerrë jashtë përdorimi dhe më pas të ndiqej procedurat e asgjësimit të tyre. Në asnjë çast komisioni inventarizimit fizik nuk ka nxjerr rezultat me diferenca që kanë rezultuar në procesin e inventarizimit fizik për vlerat e aktiveve, aseteve, pasurisë dhe vlerave materiale, megjithëse në objektin e inventarizuar Njësia administrative Perondi nga inventarizimi fizik kanë rezultuar gjendje në mungesë me 213 artikuj libra ne vlerë 350.150 leke, si dhe gjendje ne tepricë me 6 artikuj ne vlere 10.620 leke. Këto diferenca në (mungesë dhe tepricë) të rezultuara gjatë procesit të inventarizimit fizik në periudhën ushtrimore raportuese 2019, komisioni në përfundim të procesit nuk i ka analizuar dhe sistemuar me kontabilizim në llogarinë 468 "Debitor te ndryshëm". Për vitin 2019 komisioni inventarizimit ka paraqitur

fletë inventarët me gjendje fizike e krahasuar kjo me gjendjen kontabile (vlera historike) në objektet e inventarizuara sipas llogarive kontabile të evidentuara në përmbledhëse me rezultate të evidentuara edhe në pasqyrat financiare (bilanci kontabël) për periudhën raportuese e mbyllur në datë 31.12.2019 për 9 llogari me analizë për secilin AAGJM dhe AAGJJM dhe qarkullues. Të dhënat në tabelë evidentojnë, diferencat në administrimin e aktiveve, ndërmjet gjendjes fizike të inventarit dhe gjendjes kontabile vlera historike e deklaruar në pasqyrat financiare, me diferenca në (mungese) në gjendjen fizike sipas flete inventarit ku; llog. (214) shuma 448.559 leke; llog (215) shuma 5,228,001 lekë; lloga (218) shuma 13,878 lekë llog (32) shuma 339.960 leke. Komisioni inventarizimit në përfundim të procesit në asnjë rast nuk ka sistemuar asnjë diferencë në mungesë të rezultuara ndërmjet gjendjes fizike e gjendjes kontabile (vlera historike) të evidentuara në pasqyrat financiare *(Trajtuar më hollësisht në pikën III.5. faqe 45 të Raporti Përfundimtar të Auditimit)*.

10.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, të bëhen sistemimet në kontabilitet të diferencave në llogaritë 214 në instalime teknike, makineri e pajisje për vlerën 448,559 lekë, 215 në Mjete Transporti për vlerën 5,228,001 lekë dhe 218 në Inventar ekonomik për vlerën 13,878 lekë. Të merren masa që procedura e inventarizimit të ndiqet sipas çdo hapi të përcaktuar në udhëzimin nr.30 për të cilat ka pasur problematika sipas 6 pikave të mësipërme.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

11. Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes nga auditimi i fundit të kryer në Bashkinë Kuçovë, KLSH ka njoftuar Bashkinë Kuçovë me shkresën nr. 54/13, datë 18.06.2018. Bashkia Kuçovë për zbatim e rekomandimeve të KLSH, ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 202/83 datë 09.07.2018, brenda afatit 20 ditore nga data e shkresës për zbatimin e rekomandimeve. Gjithashtu është kthyer përgjigje dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda 6 muajve, veprime këto në përputhje të shkronjës (j) e nenit 15 dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Nga verifikimi i zbatimit të detyrave të lënë nga auditimi i fundit, u konstatua se:

a. Nga 11 masa organizative: janë zbatuar plotësisht **6** masa organizative dhe janë në proces zbatimi **3** masa me vlerë 63,335 mijë lekë, nga e cila arkëtuar vlera 11,362 mijë lekë dhe mbetet për arkëtim vlera 51,973 mijë lekë dhe nuk janë zbatuar **2** masa organizative respektivisht: (rekomandimi nr. 10 dhe 11).

b. Nga 13 masa shpërblym dëmi me vlerë **20,125 mijë lekë**, nga të cilat nuk është pranuar 1 masë në vlerën 2,401 mijë lekë, si dhe janë pranuar 12 masa në vlerën **17,328 mijë lekë**. Nga masat e pranuar është zbatuar **1** masa me vlerë **1,888 mijë lekë** dhe nuk janë zbatuar 11 masa me vlerë **16,140 mijë lekë**.

c. Janë rekomanduar Kryetari të Bashkisë Kuçovë t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë), për 3 mbikëqyrës punimesh 1 kolaudator, konkretisht:

- **V. T.** nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.
- **E. M.** përfaqësues ligjor i subjektit “A AM” sh.p.k.
- **F. B.**, përfaqësues ligjor i subjektit “H.E. & S.K.” sh.p.k.
- **L.V.** nën cilësinë e kolaudatores së punimeve.

Deri në datën e verifikimit datën 16.04.2021 nga nëpunësi autorizues nuk është kryerë asnjë llojë procedure ligjore në vendosjen e masës administrative me gjobë sa më sipër *(Trajtuar më hollësisht në pikën III.7. faqe 105-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

11.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë të marrë masa dhe të analizojnë në Bashki dhe Këshillin Bashkiak, mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me

shkresën nr. 54/13, datë 18.06.2018.. *Është zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Kuçovë, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të bëjë kontabilizimin dhe të nxjerrë urdhër-zhdëmtimeve për shumët e pakontabilizuar, respektivisht:*

a-Për **5 masa** organizative, në vlerë 51,973 mijë lekë konkretisht rekomandimet **(nr.1,6,8,10,11);**

b-Për **12 masa shpërblim** dëmi në vlerën **16,140 mijë lekë**, për të gjitha pikat e rekomanduara;

c- Vendosjen e masës disiplinore **“Vërejtje me paralajmërim”**, për 16 punonjës që rregullojnë marrëdhëniet sipas *Është zbatuar në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë.*

d- I rikërkohet Kryetarit të Bashkisë Kuçovë të kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrotjtjes së Territorit Vendor **të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara për 4 persona,** konkretisht:

1. V. T., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.
2. E. M., përfaqësues ligjor i subjektit *“A AM” sh.p.k.*
3. F. B., përfaqësues ligjor i subjektit *“H.E. & S.K.” sh.p.k.*
4. L. V., në cilësinë e kolaudatores së punimeve.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konstatohet se nga Bashkia Kuçovë nuk ka njohje dhe nuk është zbatuar ligji 10296, datë 08.07.2010 *Është zbatuar në menaxhimin financiar dhe kontrollin, konkretisht:*

- Në Bashkinë Kuçovë nuk është ngritur një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si dhe ka mangësi të plotë të rregullave të shkruara për funksionimin e institucionit.
- Institucioni për vitet 2018-2020 ka operuar pa *Është rregulluar* për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë së Kuçovë.
- Bashkia Kuçovë për vitet 2018-2020 ka vepruar pa patur të hartuar dhe miratuar Kodin e Etikës Profesionale.
- Për vitin 2020 në Bashkia Kuçovë nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik edhe pse në Ministrinë e Financave në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit është raportuar nëpërmjet pyetësorit të plotësuar, ekzistenca e një GMS të ngritur me urdhër nga titullari.
- Për periudhën 2018-2020 GSM i Bashkisë Kuçovë nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjikë institucionale me afat jo më pak se sa 5 vjet.
- Nga ana e titullarit nuk është hartuar *Është hartuar* Strategjia e menaxhimit të riskut për vitin 2018, 2019 dhe 2020, manuali dhe harta e proceseve të punës, gjurma e auditimit e cila duhet të përfshinte të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë.
- Gjatë vitit 2018, 2019 dhe 2020, ndryshimet në strukturën organizative, dorëzimi i detyrës si dhe marrja e saj nga persona të tjerë, nuk është bërë me akte dorëzimi dhe inventarizim përkatës.
- Për periudhën 2018-2020 Bashkia Kuçovë në funksion të kontrollit dhe menaxhimit të veprimtarisë financiare si dhe vjeljes së të ardhurave për tatim taksat lokale, nuk ka aplikuar asnjë program elektronik.
- Bashkia Kuçovë përveç periudhë 23.04-01.08.2019, për periudhën objekt auditimi 2018-2020 nuk ka emëruar koordinatoren e riskut, megjithëse janë hartuar regjistrat e riskut përkatës.

- Nga ana e nëpunësit autorizues, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut dhe dokumentimin e tij, Ndërkohë për minimizimin e riskut, mashtrimin dhe parregullsi, nga nëpunësi autorizues nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e këtyre fenomeneve.
- Nga ana e nëpunësit autorizues nuk janë përcaktuar rregulla me shkrim mbi veprimtaritë e kontrollit dhe ndarja e detyrave në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin *(Trajtuar më hollësisht në pikën III.3. faqe 21-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues dhe Kryetarit të GMS-së, si dhe Sekretari i Përgjithshëm duhet të marrin masa të menjëhershme në funksion:

- Të hartojë një kuadër të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshkrimin të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësi dhe të drejtave të punonjësve të njësisë.
- Të merren masa për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik, emërimin e koordinorit të riskut, të hartohet Strategjia e menaxhimit të riskut, regjistri i riskut, planet e zhvillimit strategjik institucional si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.
- Bashkia Kuçovë, të hartojë Rregulloren për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë së Kuçovës dhe Kodin e Etikës Profesionale.

Brenda 3(tre) muajve nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit

13. Gjetje nga auditimi: Mbi krijimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm Publik në Bashkinë Kuçovë konstatohet se :

- Për periudhën e auditimit 2018-2020 Drejtuesit e njësisë së Auditit të Brendshëm nuk kanë hartuar Kartën e Auditimit.
- Planifikimi vjetor i auditimeve për vitin 2019, është dërguar jashtë afatit në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.
- Raportimi vjetor për vitin 2018 nuk është përgatitur dhe dërguar në DHAB.
- Përgjegjësit dhe specialistët e NJAB në Bashkinë Kuçovë janë emëruar duke qenë të pa pajisur me certifikatën e audituesit.
- Në Bashkinë Kuçovë për periudhën 2018-2020 nuk janë çelur as manualisht as elektronikisht dosjet e përhershme të auditimit.
- NJAB në Bashkinë Kuçovë nuk ka planifikuar auditim të prokurimeve publike që janë zhvilluar në Bashkinë Kuçovë referuar nivelit të riskut dhe materialitetit *(Trajtuar më hollësisht në pikën III.3. faqe 21-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë në cilësinë e NA, si dhe struktura e NJAB

- Të marrë masa për organizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, në një nga format e përshtatshme që përcakton kuadri ligjor.
- Drejtuesi i Njesisë së Auditit të Brendshëm, të marrë masa për hartimin e Kartës së Auditit.
- NJAB, të marrë masa për hartimin në kohë të Planifikimi vjetor dhe Raportimin vjetor të auditimeve dh dërgimin në afat në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.
- NJAB në Bashkinë Kuçovë të planifikoj auditimet të prokurimeve publike që janë zhvilluar në Bashkinë Kuçovë, referuar nivelit të riskut dhe materialitetit.

- Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të marri masa për të emëruar në NJAB punonjës të certifikuar në AB si dhe të filloj proceduat për certifikimin e punonjësve aktuale të NJAB.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se treguesit buxhetor të planifikuar dhe miratuar për periudhën objekt auditimi, paraqiten në nivele të ulëta realizimi. Kështu, është evidentuar nivel i ulët i realizimit të planit të të ardhurave, ku për vitin 2018, paraqiten me realizim në masën 72 % kundrejt planit dhe për vitin 2019, paraqiten me realizim në masën 64 % kundrejt planit dhe për vitin 2020, paraqiten me realizim në masën 53% kundrejt planit.

Viti	Të ardhura të veta-000/lekë				Shpenzimet buxhetore-000/lekë			
	Plan	Fakt	Diferenca	%	Plan	Fakt	Diferenca	%
2018	174,305	127,088	47,217	72	894,887	782,568	112,319	87
2019	213,183	136,512	77,018	64	804,115	689,082	115,033	86
2020	212,297	112,751	99,546	53	865,164	722,571	142,593	84

Referuar të dhënave të mësipërme, rezulton se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, për sa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre, gjë e cila ka ndikuar në mosrealizim të shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të Bashkisë (*Trajtuar më hollësisht në pikën III.4. faqe 24-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, në cilësinë e Titullarit dhe të Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, duhet të marrin masa, që gjatë procesit të planifikimit të PBA-ve dhe buxheteve vjetore, të mbështeten në analiza të hollësishme mbi kapacitetet ekonomike, financiare dhe resurset e territorit nën administrim, për një planifikim sa më objektiv dhe real të të ardhurave, me qëllim mos krijimin e diferencave të dukshme midis planifikimit dhe realizimit të buxhetit, gjë e cila shoqërohet me marrje angazhimesh për kryerje shpenzimesh, si dhe mos likuidim të tyre për shkak të mungesës së likuiditetit.

Në vijimësi.

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është evidentuar realizim i ulët i të ardhurave dhe shpenzimeve nga ana e Bashkisë Kuçovë, gjë e cila flet për punën e pamjaftueshme të kësaj administrate në planifikimin e të ardhurave dhe më kryesorja në arkëtimin e tyre, ku si rezultat i mos arkëtimeve, sjell si pasojë që një pjesë e investimeve të parashikuara në buxhetin e vitit 2018, 2019 dhe në buxhetin e vitit 2020, të mbeten pa burim financimi, duke rritur në fund të periudhave ushtrimore gjendjen e faturave të pa likuiduara dhe borxhin. Konkretisht:

- Për vitin 2018, të ardhurat nga taksat e tarifat vendore gjithsej, nga 155,679 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 129,231 mijë lekë ose 83 %, me një mosrealizim në vlerën 26,448 mijë lekë.
- Për vitin 2019, të ardhurat nga taksat e tarifat vendore gjithsej, nga 201,072 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 135,514 mijë lekë ose 67 %, me një mosrealizim në vlerën 66,058 mijë lekë.
- Për vitin 2020, të ardhurat nga taksat e tarifat vendore gjithsej, nga 212,417 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 115,747 mijë lekë ose 57.46 %, e ardhura e trashëguar është 13,875 lekë për vitin 2021, me një mosrealizim në vlerën 71,795 mijë lekë.

- Niveli i arkëtimeve për taksat vendore nga njëra periudhë në tjetër vjen në ulje, kjo tregon punë pamjaftueshme të administratës së tatim taksave të Bashkisë Kuçovë në menaxhimin e të ardhurave si në fazën e planifikimit po ashtu dhe të realizimit të tyre.
- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për arkëtimin e taksave të popullatës është mjaftuar vetëm duke detyruar familjet që marrin shërbim (vërtetime etj.) në Bashkinë Kuçovë, të paguajnë tarifën familjare, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të njoftimit Vlerësimit, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak *(Trajtuar më hollësisht në pikën III.4. faqe 26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

15.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kuçovë në bashkëpunim me strukturën e të ardhurave lokale, duhet të marrë masa të menjëhershme, për koordinimin e punës midis sektorëve dhe bashkëpunimin me struktura të tjera si: QKB, Drejtoria e Tatimeve Rajonale, Zyrat e Gjendjes Civile, DRSHTRR, etj me qëllim:

1. Marrjen e masave për evidentimin e resurseve, analizimin dhe planifikimin e të ardhurave nga taksat kombëtare;
2. Marrjen e masave për kryerjen e rakordimeve me Zyrën e Gjendjes Civile nga ana e Sektorit të Tatim Taksave Vendore, për të nxjerrë numrin real të familjeve në Bashkinë Kuçovë, si dhe marrjen e masave për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të njoftimit Vlerësimit, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Menjëherë pas marrjes së Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi : Nga auditimi u konstatua se detyrimet për fatura dhe vendime gjyqate më datë 31.12.2020, për Bashkinë Kuçovë dhe dy njësitë shpenzuese Qendra Ekonomike e Arsimit dhe Ndërmarrja Komunale janë gjithsej në vlerën 163,934,913 lekë (nga të cilat vlera 110,064,497 lekë i përket detyrimeve të viti 2019 dhe vlera 53,870,416 lekë i përket vitit 2020).

- Bashkia Kuçovë me dy njësitë shpenzuese deri më datë 31.12.2020, nuk kanë likuiduar detyrime në vlerën gjithsej 163,934,913 lekë, për fatura dhe vendime gjyqate të cilët i përkasin shpenzimeve për mallra e shërbime, etj. në vlerën 163,461,599 lekë dhe shpenzime për Vendime Gjyqate në vlerën 473,314 lekë *(Trajtuar më hollësisht në pikën III.4. faqe 26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

16.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, në cilësinë e Titullarit të Institucionit dhe Nëpunësit Autorizues, si dhe Nëpunësi Zbatues, duhet të marrin masa që gjatë procesit të planifikimit të buxheteve vjetore, të planifikojë mbulimin me buxhet, së pari për detyrimet e papaguara dhe detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore. Gjatë zbatimit të buxheteve vjetore, për investimet që financohen nga të ardhurat e veta të merret paraprakisht miratimi në Këshillin Bashkiak, të zbatohen të gjitha procedurat ligjore bazuar në udhëzimet vjetore dhe standarde të planifikimit dhe zbatimit të buxheteve vjetore.

Me marrjen e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit nën 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30/4/2015 për Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 për vetëqeverisjen vendore, dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e

aktiveve në njësitë e sektorit publik, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Kuçovë), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 1,272,428 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *ñRikonstruksioni i ish-godinës së riparimit të mjeteve të rënda dhe magazinës së rikuperove pranë parkut të naftës* Bashkia Kuçovë, me vlerë 19,104,270 lekë me TVSH, fituar nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive ñAò SHPK, & ñBò SHPK përfaqësuar nga ñAò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera dhe konkretisht: *“Transport mbeturinash 5 km”; “Hekur shiriti tokëzimit”, “Elektroda tokëzimi” dhe “Lyrje me bojë sip metalike*ò, në vlerën **132,297 lekë** pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1807 prot datë 23.05.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kuçovë dhe Kontraktorit BOE ñAò SHPK & ñBò SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.6.4/4. faqe 86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **132,297 lekë** pa TVSH nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive ñAò SHPK, & ñBò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1807 prot, datë 23.05.2018 me objekt *ñRikonstruksioni i ish-godinës së riparimit të mjeteve të rënda dhe magazinës së rikuperove pranë parkut të naftës*ò, Bashkia Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.12.2021

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *ñNdërtim shtesë kati Biblioteka Kuçovë*ò Bashkia Kuçovë, me vlerë 7,181,786.76 lekë me TVSH, fituar nga sipërmarrësit të punimeve ñZò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve të kryera dhe konkretisht: *ñStruktura monolite betoni C 20/25 (kollona + soletë)”, “Kasetë shkarkimi bakri për ullukun t=1 mm”, “Ulluk shkarkimi vertikal bakri Ø120 mm*ò, në vlerën **450,358 lekë** pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3871 prot datë 14.11.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kuçovë dhe shoqërisë ñZò SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.6.4/4. faqe 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **450,358 lekë** pa TVSH nga sipërmarrësit të punimeve ñZò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3871 prot, datë 14.11.2018 me objekt *ñNdërtim shtesë kati Biblioteka Kuçovë*ò, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.12.2021

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *ñRikonstruksion i sheshit shkollës 9-vjeçare 18 Tetori*ò Bashkia Kuçovë, me vlerë 1,241,832 lekë me TVSH, fituar nga sipërmarrësit të punimeve ñFò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërit të punimeve ñThemel e xokol betoni C 12/15ò, në vlerën **26,940 lekë** pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2649 prot datë 10.08.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor

Bashkisë Kuçovë dhe shoqërisë në SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën III.6.4/4 faqe 91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **26,960** lekë pa TVSH nga sipërmarrësit të punimeve në SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2649 prot, datë 10.08.2020 me objekt Rikonstruksion i sheshit shkollës 9-vjeçare 18 Tetori, Bashkia Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.12.2021

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt Rikonstruksion i kopshtit nr. 1 Bashkia Kuçovë, me vlerë 8,003,586 lekë me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve, bashkimi i përkohshëm i shoqërive në SHPK & në SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve: Termozolim solete me polisterol t=25 cm; Kasetë shkarkimi bakri për ullukun t=1 mm; Ulluk shkarkimi vertikal bakri Ø120 mm; F.V Dyer të brendshme druri importi cilësi e I-rë, në vlerën **128,120 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3040 prot datë 12.09.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kuçovë dhe JV në SHPK & në SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën III.6.4/4. faqe 92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **128,120** lekë pa TVSH nga sipërmarrësit të punimeve JV në SHPK & në SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3040 prot, datë 12.09.2018 me objekt Rikonstruksion i kopshtit nr. 1, Bashkia Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.12.2021

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt Rikonstruksion i rrugës në B. Fshati Rreth Tapi Njësia Administrative Perondi, në Bashkinë Kuçovë me vlerë 8,003,586 lekë me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve, bashkimi i përkohshëm i shoqërive në SHPK & në SH-07 SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve: Shtresë rëre t=10 cm nën tub; Pllaka betoni gri t=6 cm për trotuar; Shtresë stabilizanti t=5 cm nën pllakë në vlerën **157,669 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 297 prot datë 24.01.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kuçovë dhe JV në SHPK & në SH-07 SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën III.6.4/4. faqe 94-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **157,669** lekë pa TVSH nga sipërmarrësit të punimeve JV në SHPK & në SH-07 SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3040 prot, datë 12.09.2018 me objekt Rikonstruksion i rrugës në B. Fshati Rreth Tapi Njësia Administrative Perondi, në Bashkinë Kuçovë, Bashkia Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.12.2021

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt Ndërtim i shkollës 9 vjeçare 18 Tetori Bashkia Kuçovë, me vlerë 74,580,437 lekë me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve, Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive në K.

SHPK & ñAò SHPK, rezultuan në objekt diferenca në volume pune të zërave të punimeve: ñPrishje mur tulle pa pastrimò; ñShtresë betoni C 7/10, t = 10 cm, nën themeleò, në vlerën **377,044 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2286 prot datë 04.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Kuçovë dhe JV ñEd K.ò SHPK & ñAò SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.6.4. faqe 95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kuçovë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **377,044 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësit të punimeve JV ñEd K.ò SHPK & ñAò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2286 prot, datë 04.07.2019 me objekt ñNdërtimi i shkollës 9-vjeçare ñ18 Tetoriò, Bashkia Kuçovë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera sipas volumeve të situacionuara.

Deri me datë 31.12.2021

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 15 procedurave me vlerë 546,376 mijë lekë pa SHPK, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP 9 procedura me vlerë kontrate 358,448 lekë ose 72.8 % e fondit të prokuruar, në të cilat ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **358,448 mijë lekë** pa SHPK, respektivisht:

1.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ñRikonstruksioni i Rrugës “E. B.”, fshati Rreth Tapi, Njësia Administrative Perondiò, me fond limit 30,688 mijë lekë, me fitues BOE ñFò SHPK & ñSh-07ò SHPK me vlerë të ofertës 29,461,240 lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **29,461,240 lekë**.

1.2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ñRikonstruksion i shkollës së mesme 5 Tetoriò, me fond limit 43,528 mijë lekë, me fitues BOE ñAò SHPK & ñBò SHPK me ofertë 42,664,066 lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **42,664,066 lekë**.

1.3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ñRikonstruksioni i objekteve të komunitetit Rom dhe Egjiptiane Kuçovë dhe banues në zona ruraleò, me fond limit 12,319 mijë lekë, me fitues OE ñZò SHPK me ofertë 12,145,527 lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **12,145,527 lekë**.

1.4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Rikualifikim i lagjes 1 Maj”, me fond limit 90,747 mijë lekë, me fitues BOE ñAò SHPK & ñBò SHPK me ofertë 88,015 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **88,015,860 lekë**.

1.5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Shërbim i dekorit në Bashkinë Kuçovë”, me fond limit 7,870 mijë lekë, me fitues OE ñA. D.ò p.f me

ofertë 7,869,615 lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **7,869,615 lekë**.

1.6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *“Ndërtim i shkollës 9 vjeçare 18 Tetori”*, me fond limit 64,093 mijë lekë, me fitues BOE *“Ed K. SHPK & A SHPK”* me ofertë 62,150,364 lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **62,150,364 lekë**.

1.7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *“Devijim i përroit Gegë për zgjerimin e varrezave publike”*, me fond limit 15,182 mijë lekë, me fitues OE *“F SHPK”* me ofertë 14,899 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **14,899,900 lekë**.

1.8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *“Rikonstruksion i rrugës Murat Daulle”*, me fond limit 37,650 mijë lekë, me fitues BOE *“F SHPK & Sh-07 SHPK & Coloseo SHPK”* me ofertë 36,936 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **36,936,700 lekë**.

1.9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *“Rikualifikim urban i lagjes Llukan Prifti”*, me fond limit 65,621 mijë lekë, me fitues BOE *“F SHPK & Sh-07 SHPK”* me ofertë 64,303,900 lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **64,303,900 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në pikën III.6. faqe 54-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.(1-9) Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Kuçovë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimi me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **358,448 mijë lekë** pa SHPK. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e të Ardhurave, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej debitorë 338 subjekte për vlerën **12,391,597 lekë** dhe debitorë për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa shërbimi, 4431 familje për vlerën gjithsej **63,032,000 lekë**. Nga Drejtoria e të Ardhurave për subjektet debitorë përveç se janë dërguar bankave urdhër bllokime dhe barrë siguruese në drejtorinë e transporteve dhe hipotekë, në asnjë rast nuk kemi ndjekje të plotë të procedurave të arkëtimit të debitorëve, deri në nxjerrjen e Urdhër sekuestrimit, konfiskimit të pasurisë apo kallëzim penal të subjekteve për mos shlyerje të detyrimeve (*Trajtuar më hollësisht në pikën III.4. faqe 33-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandimi: Bashkia Kuçovë, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kuçovë të marrë masat e duhura, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuar të subjekteve fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura për vlerën gjithsej 75,423,597 lekë, gjithsej 338 subjekte në vlerën

12,391,597 lekë dhe 4431 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej **63,032,000 lekë** konkretisht:

- Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë, urdhër bllokime të llogarive bankare të subjekteve;
- Ti dërgohet Drejtorisë Rajonale të Transportit kërkesa për vendosje barrë siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme);
- Në funksion mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhojë strukturat e tij, për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar;

Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet e krijuara në vite, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Sektori Juridik, të marrë masa administrative, apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të RSH, neni 181 në Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimit: Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Kuçovë për periudhën objekt auditimi nuk ka arkëtuar detyrimet e kontratave dhe kamatëvonesat nga 155 fermerë në vlerën **13,527,645 lekë**, që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kuçovë, (detyrim kontrate viti 2017 e para në vlerën 642,188 lekë, viti 2018 në vlerën 960,488 lekë dhe viti 2019 në vlerën 981,906 lekë dhe kamatëvonesa në vlerën 10,943,063 lekë) *(Trajtuar më hollësisht në pikën III.4. faqe 29-30 të Raporti Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandim: Bashkia Kuçovë duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore, sipas të dhënave të Sektorit të Bujqësisë, për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore, në shumën prej **13,527,645 lekë**, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Kuçovë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT

S.M., Përgjegjës i grupit të auditimit

M.B., auditues

Sh.H., auditues

E.C., auditues

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

M.LI

V. LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT

Pjesë përbërëse e Raporti Përfundimtar të Auditimit është dhe dokumentacioni i mbajtur si më poshtë:

a. Akt konstatime:

1. Akt Konstatimi nr.1, datë 16.04.2021 në Mbi vlerësimin e raportimit financiar dhe dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare të mbyllura të vitit 2019 në Bashkinë Kuçovë.
2. Akt Konstatimi nr.2, datë 16.04.2021 në Për testimin e funksionimit të kontrolleve kryesore të entitetit, përfshi zbatimin e kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin, në Bashkinë Kuçovë për periudhën 2018-2020.
3. Akt Konstatimi nr.3, datë 16.04.2021 në Për organizimin dhe funksionimin e Njësisë të Auditit të Brendshëm si dhe zbatimin e rekomandimeve të tyre në Bashkinë Kuçovë për periudhën 2018-2020.
4. Akt Konstatimi nr.4, datë 16.04.2021 në Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në llogjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 në Për menaxhimin e sistemit buxhetor në R.SH të ndryshuar.
